

Identifikimi i nismave lokale për Gratë, Paqen dhe Sigurinë në Kosovë **1999-2012**

Projekti:

Avancimi i pjesëmarrjes së gruas në ndërtim të paqes
dhe planifikim pas konfliktit nga partneriteti UN Women - UNDP - BE

Raporti i Misionit

Identifikimi i nismave lokale për Gratë, Paqen dhe Sigurinë në Kosovë 1999-2012

Projekti: Avancimi i pjesëmarrjes së gruas në ndërtim të paqes dhe planifikim pas konfliktit nga partneriteti UN Women - UNDP - BE

Përgatitur për: UNDP
Nga: Linda Hoxha and Ada Shima



Shkurtesat

ABGJ	Agjencia për Barazi Gjinore
ZKQM	Zyra Këshillëdhënëse për Qeverisje të Mirë
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit nda Grave
ZNKE	Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian
BE	Bashkimi Evropian
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë
EUSR	Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian në Kosovë
ICO	Zyra Civile Ndërkombëtare
QKSPEZH	Qendra Kosovare për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim
SHKK	Shërbimi Korrektues i Kosovës
QKSGJ	Qendra Kosovare për Studime Gjinore
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
IGJK	Instituti Gjyqësor i Kosovës
SHJK	Shoqata e Juristëve të Kosovës
KOSSAC	Nisma Kosovare për Kontroll të Armëve të Vogla
KtK	Kvinna till Kvinna
KPC	Trupat Mbrotjëse të Kosovës
RRGGK	Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës
NATO	Organizata e Traktatit Veri-Atlantik
NCA	Norwegian Church Aid
OHCHR	Zyra e Komisionarit të Lartë për të Drejta të Njeriut
IAP	Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
LRG	Lobi Rajonal i Grave për Paqe, Siguri dhe Drejtësi në Evropën Juglindore
GKSGJ	Grupi Koordinues për Siguri dhe Çështje Gjinore
UN Women ¹	Subjekti i Kombeve të Bashkuara për Barazi Gjinore dhe Fuqizim të Gruas
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNFPA	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsi
UNIFEM	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Gratë
UN-HABITAT	Programi i Kombeve të Bashkuara për Vendbanim Njerëzor
UNHCR	Zyra e Komisionarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
UNMIK	Misioni i Administratës së Përkohshme së Kombeve të Bashkuara në Kosovë
UNOPS	Zyra e Kombeve për Shërbimet e Projekteve
RKSOKB	Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara
QSHBA	Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës
DANV	Divizioni për Avokim dhe Ndihmën e Viktimave
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
ISG	Indeksi për Sigurinë e Gruas
WSSI	Nisma për Sigurinë e Gruas

¹ UN Women është themeluar si subjekt i përbërë i OKB-së në janar 2011, pas bashkimit të UNIFEM me Institutin Ndërkombëtar për Hulumtim dhe Trajnim për Avancimin e Gruas, Zyra e Këshilltarit Special për Çështje Gjinore, dhe Divizioni Avancimin e Gruas. UN Women ka funksionuar më parë në Kosovë si UNIFEM, megjithatë, për të mënjeluar ngatërresat, ky raport do të përdorë vetëm termin UN Women për t'iu referuar punës aktuale të kryer nga UN Women dhe punën e mëhershme të kryer nga UNIFEM.

Table of Contents

Shkurtesat	4
Kapitulli 1: Hyrje në Rezoluta për Gratë, Paqen dhe Sigurinë	6
Kapitulli 2: Metodologjia dhe kufizimet.....	10
Kapitulli 3: Identifikimi i kornizës institucionale dhe zbatimit të përgjithshëm të RKSOKB 1325.....	11
3.1. Institucionet kombëtare.....	11
3.2. Organizatat Ndërkombëtare.....	19
3.3. Shoqëria Civile	28
Kapitulli 4: Baza e të dhënave e nismave për gratë, paqen dhe sigurinë	30
Kapitulli 5: Gjetjet dhe konkluzat	50
Referencat	55
Shtojcat.....	56
Shtojca 1: RKSOKB 1325.....	56
Shtojca 2: RKSOKB 1820.....	61
Shtojca 3: RKSOKB 1888.....	67
Shtojca 4: RKSOKB 1889.....	78
Shtojca 5: RKSOKB 1960.....	85
Shtojca 6: Indikatorët Globalë të KS të OKB-së	92
Shtojca 7: Udhëzues për pyetjet për nismën e identifikimit e nismave për gratë, paqen dhe sigurinë	94
Shtojca 8: Lista e Institucioneve	102

Kapitulli 1: Hyrje në Rezolutën për Gratë, Paqen dhe Sigurinë

Rezoluta e KS të OKB-së për Gratë, paqen dhe sigurinë riafirmon rolin e gruas në parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve, negociata për paqe, ndërtim të paqes, reagim humanitar dhe rindërtim pas konfliktit, si dhe në rindërtimin pas konfliktit thekson rëndësinë e pjesëmarrjes së saj të barabartë dhe përfshirjes së plotë në të gjitha përpjekjet për mirëmbajtjen dhe promovimin e paqes dhe sigurisë. RKSOKB 1325 pranon ndikimin joproportional që lufta ka në gratë dhe fëmijët, si dhe nënvizon faktin se gratë historikisht janë lënë jashtë proceseve të paqes dhe përpjekjeve për stabilizim. Ajo thekson rëndësinë e pjesëmarrjes së barabartë dhe përfshirjes së plotë në operacionet paqeruajtëse dhe paqendërtuese, dhe që personeli i zbarkuar ushtarak dhe civil trajnohet në çështjet e mbrojtjes, të drejtave dhe nevojave të grave të Shteteve Anëtare. RKSOKB 1325 synon trajtimin e situatave dhe nevojave të cënueshme të grave pas konflikteve, posaçërisht në kohë të mungesës së zbatimit të ligjit, pranisë së armëve dhe trazirave ekonomike dhe sociale. Ajo gjithashtu i bën thirrje të gjitha palëve në një konflikt që të ndërmarrin masa speciale për t'i mbrojtur gratë dhe vajzat nga dhuna në baza gjinore, posaçërisht përdhunimi dhe format tjera të abuzimit seksual, në situata të konfliktit të armatosur. KS i OKB-së i

bën thirrje shteteve që të miratojnë Plane Kombëtare të Veprimit për zbatimin e RKSOKB 1325. OKB-ja¹, BE-ja² dhe NATO³ kanë miratuar PV të cilat kanë për qëllim zbatimin e RKSOKB 1325. RKSOKB 1325 mund të përdoret, dhe është përdorur, si mjet për avokim nga shoqëria civile për të lobuar ndaj autoriteteve vendore dhe ndërkombëtare që t'i trajtojnë këto shqetësime gjatë konflikteve të armatosura dhe në proceset e ndërtimit të paqes pas konfliktit.

RKSOKB 1325 është "Rezoluta e parë e Këshillit të Sigurimit që lidhë përvojat e grave në konflikt me mbajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, duke konfirmuar lidhësinë dhe rolin e gruas në zgjidhjen e konflikteve, bisedimet për paqe dhe rimëkëmbje, duke kërkuar ngritje të aftësive për reagim me perspektivë gjinore në misionet paqeruajtëse dhe trajnim gjinor për të gjithë ata që janë të përfshirë në mbajtjen e paqes dhe sigurisë".⁴ Gjersa RKSOKB 1325 paraqet një pasqyrë të përgjithshme të veprimeve që do të ndërmerren nga organizatat ndërkombëtare dhe institucionet vendore për gratë, paqen dhe sigurinë Rezolutat tjera të miratuara më vonë, gjegjësisht RKSOKB 1820 miratuar më 2008, 1888, 1889 të miratuara më 2009, dhe 1960 më 2010 (shih Shtojcat 1-5) plotësojnë RKSOKB 1325 duke përsëritur dhe fuqizuar zotimet e

¹ Plani i Veprimit i OKB-së prej shtatë pikësh për pjesëmarrjen e gruas në ndërtimin e paqes është miratuar më 2010: http://www.un.org/en/peacebuilding/pbso/pdf/seven_point_action_plan.pdf

² Qasja gjithëpërfshirëse e BE-së për zbatimin e Rezolutave të Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1325 dhe 1820 për grat, paqen dhe sigurinë është miratuar më 2008 nga Këshilli i Bashkimit Evropian.

³ Është hartuar me partnerët e NATO-s në Këshillin e Partneritetit Euro-Atlantik (EAPC) më 2007, dhe është reviduar më 2011.

⁴ http://www.unwomen.org/wp-content/uploads/2011/10/UNSC-resolutions-on-women-peace-dhe-security_Poster_English.pdf

shteteve dhe lehtësuar zbatimin e tyre. RKSOKB 1820 thekson rëndësinë e ndërgjegjësimit lidhur me përdorimin e dhunës seksuale në konflikte të armatosura dhe situatat pas konfliktit si taktikë e luftës, duke iu bërë thirrje shteteve që të parandalojnë dhe reagojnë ndaj akteve të dhunës seksuale, si dhe të miratojnë hapat e duhur për të trajtuar përhapjen e përdorimit të dhunës seksuale. Ajo gjithashtu kërkon që të krijohen trajnime adekuate të cilat do të ofrohen për stafin, trupat dhe policinë paqeruajtëse dhe humanitare. Ajo është "Rezoluta e parë e Këshillit të Sigurimit që njeh dhunën seksuale të lidhur me konfliktin si taktikë e luftës dhe si çështje e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, që kërkon reagim në nivel të paqeruajtjes, drejtësisë, shërbimeve dhe neogicatave për paqe"⁵.

RKSOKB 1888 përqendrohet në themelimin e mekanizmave koordinues në institucionet kombëtare të drejtësisë me mbështetje të burimeve njerëzore ekzistuese ndërkombëtare për t'i mbrojtur gratë dhe vajzat në situatat pas konfliktit. Ajo nxitë shtetet që të rrisin qasjen në kujdesin shëndetësor, mbështetjen psikologjike, asistencën ligjore dhe integrimin socio-ekonomik për viktimat e dhunës seksuale të lidhur me konfliktin, me mbështetje të organizatave

ndërkombëtare. RKSOKB 1888 gjithashtu bën thirrje për integrim të perspektivës gjinore në të gjitha nivelet, si dhe sigurimin e buxheteve adekuate për institucionet përkatëse për të mbrojtur, promovuar dhe realizuar të drejtat e grave dhe vajzave. Gjithashtu, ajo bën thirrje për raportim adekuat të rasteve të dhunës seksuale tek agjencitë e zbatimit të ligjit dhe institucionet gjyqësore.

RKSOKB 1889 kryesisht përqendrohet në pjesëmarrjen e grave në operacionet e ndërtimit të paqes dhe në përfshirjen dhe prioritizimin e nevojave të tyre për të arritur siguri më të madhe fizike dhe kushte më të mira socio-ekonomike përmes aktiviteteve të gjenerimit të të ardhurave, qasjes në shërbime bazike, veçanërisht shërbime shëndetësore, duke përfshirë shëndetin riprodhues dhe mendor. Kjo rezolutë kërkon pjesëmarrje më të madhe të gruas në vendimmarrjen politike dhe ekonomike që në fazat më të hershme proceseve të rimëkëmbjes dhe ndërtimit të paqes. Gjithashtu, ajo bën thirrje për mjete për sigurimin e zbatimit të RKSOKB 1325, indikatorëve dhe mekanizmit për monitorim.

RKSOKB 1960 përqendrohet në dhënien fund pandëshkueshmërisë dhe sigurimit të llogaridhënies përmes identifikimit të kryerësve të

dhunës seksuale gjatë konflikteve të armatosura. Gjithashtu, ajo kërkon grumbullimin e më shumë të dhënave dhe informatave lidhur me strukturën së dhunës seksuale gjatë një konflikti të armatosur.

Për të monitoruar zbatimin e RKSOKB 1325, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së ka prezantuar 26 indikatorë globalë (shih Shtojcën 6) si mjet për raportim për zbatimin e RKSOKB 1325 në raportin e tij vjetor për gratë, paqen dhe sigurinë para Këshillit më 2010 dhe Këshilli i Sigurimit miratoi një Deklaratë Presidenciale që shpreh mbështetje për avancimin e indikatorëve. Në raportin e Këshillit të Sigurimit (S/2010/173), 26 indikatorët janë të organizuar në 4 Shtylla: Parandalimi, Pjesëmarrja, Mbrojtja dhe Ndihma dhe Rimëkëmbja. Këto Shtylla pasqyrojnë Planin e Veprimit të tërë Sistemit të OKB-së 2008-2009, që më 2010 është zëvendësuar me Kornizën Strategjike të Rezultateve për Gratë, Paqen dhe Sigurinë (2011-2020), e cila ofron udhëzime për zbatim për Agjencitë e OKB-së deri më 2020.

⁵http://www.unwomen.org/wp-content/uploads/2011/10/UNSC-resolutions-on-women-peace-and-security_Poster_English.pdf

- Parandalimi: "Ulja e dhunës së lidhur me konfliktin dhe të gjitha formave të dhunës strukturore dhe fizike ndaj gruas, posaçërisht dhunës seksuale dhe në baza gjinore"
- Pjesëmarrja: "Përfshirja e grave dhe interesave të grave në proceset vendimmarrëse që kanë të bëjnë me parandalimin, menaxhimin dhe zgjidhjen e konflikteve"
- Mbrojtja: "Afirmimi i sigurisë së grave, sigurisë fizike dhe shëndetit mendor dhe sigurisë ekonomike dhe respektimi i të drejtave të tyre të njeriut"
- Ndihma dhe rimëkëmbja: "Përmbushja e nevojave specifike të grave në situatat e konfliktit dhe pas konfliktit"

Më tutje, indikatorët ndahen në nënkategori të cilat pasqyrojnë se si mund të matet në kohë realizimi i obligimeve të RKSOKB 1325 dhe përpjekjet e duhura për të arritur përparim në zbatimin e tyre, si dhe në çfarë mënyre mund të grumbullohen informatat që vërtetojnë arritjet e procesit, meqë disa indikatorë kanë nevojë për grumbullim të konsiderueshëm të të dhënave. Përgjegjësia për zbatimin e RKSOKB 1325 dhe rezolutave plotësuese të saj qëndron tek akterët ndërkombëtarë, rajonalë dhe vendorë. Rrjedhimisht, indikatorët pasqyrojnë obligimet e OKB-së si dhe të akterëve të tjerë, siç janë shtetet anëtare, si dhe pasqyrojnë ndihmën dhe mbikëqyrjen e shoqërisë civile në zbatimin e RKSOKB 1325.

Më 2010, BE-ja ka zhvilluar 17 indikatorë (shih Shtojcën 6) për qasjen Gjithëpërfshirëse për zbatimin e RKSOKB 1325 dhe RKSOKB 1820 nga ana e BE-së, që synojnë fuqizimin e llogaridhënies së BE-së në zbatimin e zotimeve të saj për gratë, paqen dhe sigurinë, duke identifikuar përparimin dhe arritjet, boshllëqet dhe mangësitë në zbatim, si dhe duke lehtësuar politikëbërjen pasuese dhe prioritizimin e veprimeve, si dhe standardizimin e mundshëm. Qasja gjithëpërfshirëse e BE-së për zbatimin e RKSOKB 1325 dhe RKSOKB 1820 është miratuar më 2008 bashkë me dokumentin operacional për Zbatimin e RKSOKB 1325 të fuqizuar me RKSOKB 1820 në kontekst të Sigurisë Evropiane dhe Politikave të Mbrojtjes. Megjithatë, identifikimi dhe vlerësimi i nismave në këtë raport bazohet në Shtyllat e OKB-së.

Rreth 40 kanë hartuar Planet Kombëtare të Veprimit (PKV) për zbatimin efektiv të Rezolutës 1325 qëllimi i së cilave është fuqizimi i zotimit, llogaridhënies dhe sigurimi i monitorimit dhe raportimit për progresin në zbatim në nivel kombëtar. Çka është më me rëndësi, këto plan të veprimit gjithashtu mundësojnë që të merret parasysh konteksti i shtetit dhe specifikat tjera të rëndësishme, duke përfshirë përparimin dhe boshllëqet, për të siguruar zbatimin e RKSOKB 1325. Kosova ende nuk ka miratuar një plan të veprimit për zbatimin e RKSOKB 1325, por shumë organizata ndërkombëtare dhe vendore e kanë përdorur RKSOKB 1325 për ta udhëzuar punën e tyre në miratimin e ligjeve të reja për siguri, trajnimin e stafit të tyre dhe monitorimin e zbatimit të saj. Në muajin shkurt 2012, Zyra e Kryeministrit themeloi një Grup Punues për hartimin e Planit të Veprimit për Zbatimin e RKSOKB 1325 në Kosovë në të cilin Agjencia për Barazi Gjinore (AGJB) do të drejtonte procesin, mbështetur me ndihmë teknike dhe financiare nga UN Women dhe OHCHR. Grupi Punues përfshin akterë nga sektorë të ndryshëm: ministri të linjës, Policia e Kosovës, Forca e Sigurisë së Kosovës, shoqëria civile, gjykatat, prokuroria, etj. Institucionet e intervistuar kanë pohuar se plani i veprimit është duke u hartuar me pjesëmarrje të mirë, ku të gjitha institucionet janë të zotuar në realizimin e përgjegjësive

të tyre. Përveç kësaj, ky është plani i parë i veprimit në Kosovë në të cilin është bërë analizimi i kostove të aktiviteteve dhe hartimi i buxhetit përkatës. Buxheti është duke u shqyrtuar nga Ministria e Financave.

Ky Raport i Misionit paraqet identifikimin të nismave apo projekteve të identifikuara për gratë, paqen dhe sigurinë në Kosovë të ndërmarra nga strukturat vendore dhe ndërkombëtare, duke përfshirë donatorët bilateralë, nga 1999 deri 2012. Identifikimi është komponentë e projektit të Programit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) me titull Rritja e pjesëmarrjes së gruas në ndërtimin e paqes dhe planifikimin pas konfliktit, që është partneritet i Entitetit të OKB-së për Barazi Gjinore dhe Fuqizim të Gruas (UN Women), UNDP-së dhe BE-së, i cili financohet nga BE-ja.

Ky raport është i ndarë në tri pjesë kryesore. Pjesa e parë paraqet institucionet kryesore që kanë punuar drejtpërdrejt në trajtimin e gruas, paqes dhe sigurisë në Kosovë, pjesa e dytë paraqet të gjitha nismat e identifikuara gjatë hulumtimit të realizuara nga institucione vendore apo ndërkombëtare kategorizimi i të cilave vlerësohet bazuar në shtyllat specifike të RKSOKB 1325, d.m.th. parandalimi, pjesëmarrja, mbrojtja, ndihma dhe rimëkëmbja, si dhe kapitulli i fundit paraqet konkluzat dhe rekomandimet nga ky hulumtim.

Kapitulli 2: Metodologjia dhe kufizimet

Aktiviteti i identifikimit për nismat lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e gruas, paqes dhe sigurisë, ka filluar me shqyrtimin e të gjitha rezolutave të OKB-së që trajtojnë pozitën dhe rolin e gruas në situatat e pas konfliktit, d.m.th. RKSOKB 1325, 1820, 1888, 1889, 1960. Për të monitoruar dhe matur zbatimin e RKSOKB 1325 në veçanti, si dhe të tjerat më gjerësisht, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së (SPOKB) ka propozuar indikatorë të cilët grupohen në katër shtylla kryesore. Këto shtylla – mbrojtja, parandalimi, pjesëmarrja, ndihma dhe rimëkëmbja – përbëhen nga indikatorë specifikë që masin se në çfarë shkalle është zbatuar RKSOKB 1325. Këto shtylla janë përdorur si instrument për identifikimin dhe kategorizimin e nismave të ndërmarrë, të cilat kanë çuar në trajtimin e shtyllave të posaçme të RKSOKB 1325.

Ekipi ka filluar punën e tij me hulumtim nga zyra të publikimeve të mëhershme relevante. Përmes hulumtimit nga zyra janë identifikuar institucionet kryesore vendore e ndërkombëtare, që janë palët kryesore në zbatimin e RKSOKB 1325. Ky proces rezultoi në shqyrtimin e literaturës për përgjegjësitë e secilit institucion në fushën e përvijuar në Kapitullin 3. Ndonëse ka mungesë të

të dhënave sasiore për monitorimin e zbatimit të RKSOKB 1325, raportet e monitorimit të RRGK-së ofrojnë të dhëna të vlefshme cilësore për zbatimin e saj. Pas hulumtimit nga zyra janë organizuar takime me palët më të rëndësishme të interesit për të diskutuar me ta lidhur me projektet, nismat dhe programet e tyre që lidhen me zbatimin e RKSOKB 1325. Megjithatë, për shkak të kohës së kufizuar të ndarë për këtë detyrë dhe për qëllime të organizimit, është vendosur që me organizatat tjera të mbetura të komunikohet përmes postës elektronike, për të cilat janë përgatitur pyetjet specifike (Shtojca 7) lidhur me projektet e tyre të mëhershme në këtë fushë dhe të cilat janë dërguar tek zyrtarët përkatës gjinor apo pikat kontaktuese, varësisht nga struktura organizative e institucioneve (Shtojca 8). Këta persona kontaktues janë informuar lidhur me gjetjet për nismat e institucioneve të tyre dhe janë kërkuar që t'i vërtetojnë këto informata dhe të ofrojnë informata të tjera, sipas nevojës.

Ky proces ka çuar në identifikimin e nismave/projekteve më relevante të cilat këto institucione i kanë ndërmarrë/realizuar gjatë periudhës 1999-2012. Për t'i organizuar të dhënat është krijuar një bazë e të dhënave me kategorizim sipas

fushave në vijim: emri i institucionit, emri i nismës, rezultatet/outputt e synuara, fushat e ndikimit, periudha e zbatimit, shtylla e RKSOKB 1325, buxheti dhe statusi. Disa nga organizatat që më parë kanë vepruar në Kosovë kanë përfunduar misionet e tyre para vitit 2012 dhe nuk kanë përfaqësues/përfaqësi në Kosovë. Prandaj, informatat lidhur me aktivitetet e tyre janë nxjerrë nga të dhëna sekondare. Veç kësaj, afati i kufizuar kohor gjatë të cilit është përgatitur ky raport i misionit ka vështirësuar grumbullimin e informatave specifike lidhur me të gjithë akterët, nismat, buxhetet dhe donatorët specifikë. Prandaj, kërkojmë falje paraprakisht për çdo projekt a nismë që nuk është përfshirë në këtë raport.

Gjersa shumë projekte/nisma kanë trajtuar një apo më shumë shtylla specifike të RKSOKB 1325, disa nga këto projekte/nisma kanë pasur në fokus zbatimin e përgjithshëm të saj. Baza e të dhënave e paraqitur në Kapitullin 4 përfshin të gjitha nismat dhe projektet specifike të identifikuar. Të gjitha projektet tjera dhe institucionet përkatëse janë paraqitur përgjatë tabelave të shtyllës specifike të RKSOKB 1325 (shih Kapitulli 4: Baza e të dhënave për nismat për gratë, paqen dhe sigurinë).

Kapitulli 3: Identifikimi i kornizës institucionale dhe zbatimit të përgjithshëm të RKSOKB 1325

Për zbatimin e RKSOKB 1325 në Kosovë kanë punuar institucione lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare. Shumica e projekteve/nismave mund të kategorizohen si të tilla që trajtojnë më shumë se një shtyllë të RKSOKB 1325. Këto projekte janë përfshirë në të gjitha tabelat përkatëse sipas secilës shtyllë (Kapitulli 4). Kjo pjesë përshkruan në mënyrë të përgjithshme punën e institucioneve lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare të realizuar për gratë, paqen dhe sigurinë në Kosovë gjatë periudhës 1999-2012. Bazuar në rishikimin e literaturës dhe intervistat e kryera me institucionet relevante, ajo përshkruan institucionet kryesore me përgjegjësitë e tyre gjegjëse.

respektuar në tërësi diversitetin kulturor të vendit [...] Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet integritetit në shoqëri të pjesëtarëve të goditur nga varfëria, trafikimi i qenieve njerëzore etj. Dukuritë si vetëvrasjet, dhuna në shkollë dhe dhuna në familje do të trajtohet nëpërmjet masave parandaluese dhe politikave sociale integruar. Barazia gjinore duhet të sigurohet duke u integruar komponentët e saj në gjithë politikën zhvillimore dhe zhvillimin e konsolidimit të institucioneve.”⁶ Kjo pjesë përshkruan veprimet e ndërmarra nga institucionet e ndryshme kombëtare për trajtimin e grave, paqes dhe sigurisë.

3.1. Institucionet kombëtare

Qeveria e Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve, politikave dhe strategjive që kanë të bëjnë me respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut për të gjithë qytetarët. Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2001-2014 thekson se “[N]ë themelet e shtetit demokratik të Kosovës duhet të vendosen standardet më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut, pa asnjë lloj të diskriminimit, duke

Kuvendi i Kosovës

Kuvendi i Kosovës është organ ligjvënës përgjegjës për të siguruar qeverisje dhe buxhet demokratik përmes përcaktimit dhe mirëmbajtjes së një kuadri të shëndoshë legjislativ. Në kuadër të kuvendit veprojnë tri komisione të rëndësishme në fushën e hartimit, aprovimit dhe monitorimit të ligjeve që kanë të bëjnë me sigurinë njerëzore dhe sektorin e sigurisë; d.m.th. në fushën e sigurisë njerëzore është

⁶ http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Programi_i_Qeverise_eng_.pdf

Komisioni për të drejta të njeriut, barazi gjinore, persona të pagjetur dhe peticione dhe Komisioni për integritet evropian; dhe në fushën e sektorit të sigurisë është Komisioni për punë të brendshme, siguri dhe mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Komisioni për të drejta të njeriut, barazi gjinore, persona të pagjetur dhe peticione shqyrton projektligjet e hartuara dhe i përafrohet ato me legjislacionin e BE-së dhe legjislacionin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Ky Komision punon ngushtë me Agjencinë për Barazi Gjinore (ABGJ) për çështjet gjinore. Komisioni për të drejta të njeriut, barazi gjinore, persona të pagjetur dhe peticione është po ashtu organi përgjegjës për integritetin e perspektivës gjinore në mandatin, politikën dhe planet e punës të qeverisë së Kosovës.⁷

Krijimi i kornizës ligjore që siguron të drejtat e gruas dhe barazinë gjinore gjithashtu duke trajtuar pandëshkueshmërinë dhe parandalimin e dhunës në baza gjinore ishte një nga arritjet më të rëndësishme të dekadës së fundit për sa i përket ruajtjes së sigurisë njerëzore të gruas në pajtim me RKSOKB 1325. Në vijim janë disa nga ligjet dhe planet kombëtare të veprimit që lidhen me zbatimin e RKSOKB 1325 në Kosovë.

• Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 7.2 përcakton se "Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore."

Për më tepër, zbatimi i drejtpërdrejtë i Konventës për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas është i garantuar me Kushtetutë dhe në rast kundërtënieje, obligimet ndërkombëtare kanë përparësi mbi ligjet vendore.⁸

• Ligjet

Beside the Constitution, the 2004 Law on Gender Equality, the Kosovo Program for Gender Equality and the Agency for Gender Equality under the auspices of the Prime Minister's Office, both of which are established under the law, and the 2004 the Anti-Discrimination Law are the most significant gender equality and non-discrimination instruments in Kosovo applying both to public and private entities.

⁷UNIFEM: Pozita e grave në Kosovë e cekur në raportin e Van der Leest Kristin (2010) Gjinia dhe Siguria: Pasqyrë e aktorëve në sektorin e sigurisë në Kosovë dhe politikave, praktikës dhe strategjive gjinore, përgatitur për GKSGJ.

⁸ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]

- 1 Ligji nr. 2004/ 3 Kundër Diskriminimit⁹
- 2 Ligji nr.2004/2 për Barazinë gjinore në Kosovë¹⁰
- 3 Ligji nr. 03/L –182 për Mbrojtjen nga dhuna në familje^t

• Planet e Veprimit

- 1 Plani Kombëtar i Veprimit për Promovimin e Barazisë Gjinore - 2004
- 2 Plani i veprimit për zbatimin e Ligjit kundër diskriminimit –11. 10. 2005¹²
- 3 Plani i veprimit për luftimin e trafikimit me qenie njerëzore në Kosovë 2011-2014¹³
- 4 Strategjia dhe plani i veprimit kundër trafikimit me qenie njerëzore në Republikën e Kosovës, 2011-2014 – Data e aprovimit nga MPB 01.09. 2011¹⁴
- 5 Strategjia Kombëtare dhe Plani i veprimit kundër trafikimit me qenie njerëzore 2008-2011.¹⁵
- 6 Strategjia dhe Plani i veprimit për të drejtat e njeriut në Republikën e Kosovës - 2009-2011¹⁶
- 7 Plani i veprimit për Programin kundër dhunës në familje¹⁷
- 8 Programi i Kosovës për Barazi Gjinore¹⁸

• Ligjet dhe planet e veprimit në përgatitje e sipër

- 1 Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/2 për barazinë gjinore; 30.06.2013¹⁹
- 2 Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/3 kundër diskriminimit; 31.10.2013²⁰
- 3 Plani i veprimit për zbatimin e ligjit kundër diskriminimit (2013 – 2015)²¹
- 4 Plani i veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 për "Gratë, Paqen dhe Sigurinë".²²

• Rregulloret

- 1 Rregullorja nr. 2003/12 për Mbrojtjen nga dhuna në familje –Zëvendësuar me Ligjin për mbrojtjen nga dhuna familje²³
- 2 Rregullorja nr. 1/2006 për Themelimin, kompetencat dhe emërimet në Këshillin Ndërmnistror për Barazi Gjinore²⁴
- 3 Rregullorja nr. 2004/18 për Shpalljen e Ligjit për barazi gjinore në Kosovë, miratuar nga Kuvendi i Kosovës²⁵
- 4 UNMIK Rregullorja nr. 2004/18 për Shpalljen e Ligjit për barazi gjinore në Kosovë (Ligji nr. 2004/2)²⁶
- 5 Rregullorja nr. 2004/32 për Shpalljen e Ligjit kundër diskriminimit, miratuar nga Kuvendi i Kosovës²⁷

⁹ Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse në Kosovë/ Prishtinë: viti ii / nr. 14 / 1 korrik

¹⁰ Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse në Kosovë/ Prishtinë: viti ii / nr. 14 / 1 korrik

¹¹ Kuvendi i Republikës së Kosovës

¹² Zyra e Kryeministrit, qershor 2006

¹³ Ministria e Punëve të Brendshme, maj 2011

¹⁴ Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse në Kosovë/ Prishtinë: Viti II /Nr. 14 / 01 korrik. Lista e Strategjive dhe planeve të veprimit të Institucioneve të Qeverisë së Kosovës

¹⁵ Ministria e Punëve të Brendshme, maj 2011

¹⁶ Zyra e Kryeministrit, dhjetor 2008

¹⁷ Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës. Me çfarë çmimi? 2012

¹⁸ Republika e Kosovës. Zyra e Kryeministrit. Agjencia për Barazi Gjinore

¹⁹ Programi legjislativ 2013, Zyra e Kryeministrit

²⁰ Programi legjislativ 2013, Zyra e Kryeministrit

²¹ Zyra e Kryeministrit, Zyra e Planifikimit Strategjik

²² Zyra e Kryeministrit, Zyra e Planifikimit Strategjik

²³ UNMIK/REG/2003/12 9 maj 2003

²⁴ Regjistri i akteve nënligjore në fuqi të miratuar nga Qeveria dhe Ministritë: 02.05.2012

²⁵ UNMIK/REG/2004/18 7 qershor 2004

²⁶ Misioni i OSBE-së në Kosovë & UNMIK. Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe Njësia për Sundim të Ligjit. Zbatimi i Ligjeve të Kuvendit të Kosovës, Raporti II

²⁷ UNMIK/REG/2004/32 20 gusht 2004

• Ligjet tjera

1 Ligji për Zgjedhjet në Kosovë ka një kuotë prej së paku 30% pjesëmarrje të femrave në Kuvendin e Kosovës²⁸.

Futja e kuotës gjinore në ligjin për zgjedhjet që rezervon 30% të vendeve në listat e kandidatëve që garojnë për zgjedhje qendrore dhe lokale dhe në kuvendet qendrore dhe lokale për gjininë e nënfaqësuar ka kontribuar pozitivisht në rritjen e përfaqësimit të gruas në vendimmarrje.

Zyra e Kryeministrit

Ekzistojnë organe në kuadër të Zyrës së Kryeministrit që janë përgjegjëse për monitorimin e organeve qeveritare në zbatimin e mirëfilltë të të drejtave të njeriut, barazisë gjinore dhe qeverisjes së mirë. Zyra për Barazi Gjinore është themeluar më 2005 dhe më vonë është transformuar në Agjencinë për Barazi Gjinore (ABGJ), në kuadër të Zyrës së Kryeministrit më 2006. ABGJ punon në projekte dhe strategji të ndryshme që kanë të bëjnë me barazinë gjinore dhe dhunën në familje. ABGJ ka marrë pjesë dhe ka udhëhequr procesin e hartimit të strategjive për barazi gjinore, dhunën në familje dhe zbatimin e konventës CEDAW dhe në periudhën

2012-2013 në zbatimin e RKSOKB 1325. Më 2008, ABGJ ka përgatitur Raportin fillestar për zbatimin e Konventës CEDAW²⁹. ABGJ aktualisht është duke udhëhequr procesin e hartimeve të raporteve për zbatimin e RKSOKB 1325 dhe strategjive.

Zyra Këshillëdhënëse për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabartë dhe Çështje Gjinore (ZQM) është themeluar më 2002 dhe funksionon në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. ZQM monitoron dhe këshillon ministrat në fushën e qeverisjes së mirë, të drejtave të njeriut, mundësitë e barabarta dhe çështjet gjinore. Gjithashtu, ajo shërben si sekretariat për subjekte të ndryshme qeveritare dhe kryeson koordinimin e Njësive për të Drejta të Njeriut në të gjitha ministrat.³⁰ Veç kësaj, Njësia për Barazi Gjinore në Institucionin e Avokatit të Popullit, zyrtarët për barazi gjinore në ministri, dhe Këshilli Ndërmintor për Barazi Gjinore në nivel qendror dhe zyrtarët për barazi gjinore në komuna dhe këshillat komunalë për barazi gjinore në nivelin lokal kanë rol të rëndësishëm për të siguruar respektimin e barazisë gjinore.

²⁸ Ligji 03/L-073, neni 27.1

²⁹ Van der Leest Kristin (2010) Gjinia dhe siguria: Vlerësim i aktorëve të sektorit të sigurisë dhe politikave, praktikave dhe strategjive gjinore, të përgatitur për GKSGJ.

³⁰ Po aty.

Këshilli i Sigurisë së Kosovës

Këshilli i Sigurisë së Kosovës (KSK) është themeluar me nenin 127 të Kushtetutës dhe ka rolin e identifikimit dhe vlerësimit sistematik të kërcënimeve dhe rreziqeve të sigurisë, si dhe ka kompetenca ekzekutive shtesë në situata të emergjencës. Ky Këshill kryesohet nga Kryeministri dhe përbëhet nga anëtarët ekzekutivë: Zëvendëskryeministri, Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Ministri i Punëve të Brendshme, Ministri i Punëve të Jashtme, Ministri i Drejtësisë, Ministri i Ekonomisë dhe Financave dhe Ministri për Komunitete dhe Kthim; si dhe shtatë anëtarë këshillëdhënës. Ai ka rol këshillëdhënës në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë e Kosovës dhe kontributin e saj në stabilitetin rajonal, rekomandon politika dhe strategji për siguri dhe duhet të ofrojë informata dhe vlerësime të gjendjes së sigurisë në Kosovë, duke përfshirë identifikimin e rreziqeve dhe kërcënimeve në siguri, me qëllim që ta mundësojë Republikën e Kosovës që të marrë vendime të duhura për çështje të sigurisë. Asnjë grua deri më sot nuk ka qenë anëtare e Këshillit të Sigurisë si anëtare e përhershme, anëtare jo e përhershme këshillëdhënëse, apo vëzhguese.

Zyrtarët qendrorë dhe komunalë për barazi gjinore

Më 2003, në çdo komunë dhe më 2005 në çdo ministri janë emëruar zyrtarë për barazi gjinore (ZBGJ). ZBGJ-të veprojnë në kuadër të Zyrave për të Drejta të Njeriut në ministri dhe komuna. Gjersa njësitë janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të përgjithshëm të ligjeve brenda ministrive përkatëse në lidhje me të drejtat e njeriut, ZBGJ është përgjegjës për monitorimin dhe raportimin për zbatimin e legjislacionit, politikat dhe strategjitë për barazi gjinore në institucionin përkatës në nivelin qendror dhe atë lokal. ZBGJ-të koordinojnë aktivitetet e tyre dhe raportojnë në ABGJ çdo tre muaj dhe tek ministrinë tjera të linjës për rastet specifike. Në disa komuna zyrtarët për të drejta të njeriut kanë marrë përsipër edhe përgjegjësinë e ZBGJ.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) ka përgjegjësi për zbatimin e Ligjit për Familjen dhe Shërbimet Sociale.³¹ Qendrat për Punës Sociale (QPS) janë subjekte që janë përgjegjëse për të ofruar shërbime sociale në nivel lokal. Ndonëse ato janë në proces të decentralizimit, buxheti për shumicën e shërbimeve sociale mbetet në nivelin qendror. MPMS është përgjegjëse për mbrojtjen dhe lehtësimin e ndihmës dhe rimëkëmbjes së viktimave të dhunës në familje. Deri më tani, MPMS e ka realizuar këtë përmes mbështetjes së pjesshme financiare për strehimoret në Kosovë të cilat veprojnë si organizata joqeveritare. Në Kosovë ekziston vetëm një strehimore publike.

³¹ Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës. (2012) Me çfarë çmimi?

Policia e Kosovës

Misioni i OSBE-së në Kosovë fillimisht ka themeluar Shërbimin Policor të Kosovës (SHPK) më 1999. Në vitin 2008, me Ligjin nr. 03/I-035, SHPK është transformuar në Policinë e Kosovës (PK). Që atëherë PK ka pranuar trajnime të shumta të ofruara nga UN Women, UNDP dhe OSBE. Përmes mbështetjes së tyre, PK ka arritur që të:

- Përfshijë të drejtat e njeriut të gruas dhe barazinë gjinore si pjesë e trajnimeve të obligueshme për policinë;
- Themelojë një bord të bredhshim këshillëdhënës për barazi gjinore të udhëhequr nga zyrtarë të lartë vendorë të policisë dhe që përfaqëson shtyllat kryesore të Policisë së Kosovës duke përfshirë njësinë për burime njerëzore, njësinë kundër dhunës në familje, njësinë kundër trafikimit dhe njësinë e policisë në komunitet;
- Themelojë njësinë për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore në kuadër të Zyrës së Drejtorit të Përgjithshëm;
- Themelojë njësinë për hetime speciale për dhunë në familje dhe trafikim me njerëz në nivel të qendrës. Ato plotësohen nga njësitë në gjashtë rajonet në Kosovë dhe zyrtarët në secilin stacion policor në nivel lokal, duke përfshirë një mashkull dhe një femër;
- Krijojë salla të intervistimit me pajisjet e nevojshme;
- Themelojë bordin drejtues për barazi gjinore dhe të drejta të njeriut të gruas në përbërje të Njesisë për të Drejta të Njeriut dhe Barazi Gjinore në PK, ABGJ, UN Women, MPB, MD, MSH dhe RRGK, si dhe Koalicioni i Strehimoreve për Gratë;
- Themelojë Procedurat Standarde të Operimit (PSO) që përfshijnë parimet e barazisë gjinore dhe që njohin dhe fuqizojnë më tej mekanizmin e barazisë gjinore për PK, të aprovuara më 2006. Sipas PSO-ve, pjesëtarët e Bordit Këshillëdhënës Gjinor janë të obliguar që të raportojnë për çështjet që kanë të bëjnë me aspektet gjinore çdo tre muaj.

Ministria e Drejtësisë

Ministria e Drejtësisë (MD) ka përgjegjësi që të sigurojë realizim të pavarur dhe profesional të punës së sistemit gjyqësor dhe prokurorial. Ajo gjithashtu siguron se të gjithë ligjet janë në pajtim me standardet e BE-së. MD ka rol vendimtar për të siguruar qasje të barabartë në drejtësi dhe mbrojtje ligjore për viktimat e të drejtave të njeriut që janë shkelur³².

Divizioni për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave (DMNV) është themeluar në kuadër të Departamentit për Qasje në Drejtësi të Ministrisë së Drejtësisë. Ky departamenti mbështet qasjen në drejtësi për viktimat e krimeve të dhunës dhe promovimin e të drejtave të tyre. Aktivitetet e DMNV përfshijnë operimin e një linje telefonike ndihmëse 24-orëshe për viktimat, fushata të informimit dhe ofrimin e resurseve informative, si dhe këshilla ligjore. Veç kësaj, përfshihej një strehimore shtetërore për viktimat me rrezikshmëri të lartë. Më 2012, përmes një udhëzimi administrativ, përgjegjësia për menaxhimin e DMNV-së është transferuar tek Prokurori i Shtetit, gjersa strehimorja për viktimat me rrezikshmëri të lartë tani është nën MPMS. DMNV gjithashtu ka përfaqësim rajonal në nivel komunal.

Shërbimi Korrektues i Kosovës

I themeluar më 1999, Shërbimet Korrektuese të Kosovës (SHKK) funksionojnë në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë. SHKK ka themeluar 6 qendra të paraburgimit (Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjiilan, Mitrovicë dhe Lipjan), 1 burg në Dubravë dhe 1 qendër korrektuese në Lipjan. Gjatë vitit 2008, Rrjeti i Grupit të Grave në Kosovë ka ofruar shërbime të ndryshme për SHKK.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK)

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) ka përgjegjësi për monitorimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në rastet gjyqësore që kanë të bëjnë me aspekte gjinore, duke përfshirë raste të dhunës në familje, kujdestarisë mbi fëmijë, pronës dhe trashëgimisë, trafikimit, shkurorëzimit³³. Këshilli gjithashtu ka ofruar trajnime të ndryshme për gjyqtarë dhe prokurorë për ligjet që kanë të bëjnë me dhunën në familje, trafikimin dhe të tjera.

Instituti Gjyqësor i Kosovës

Më 2008, Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK) është themeluar si agjenci profesionale përgjegjëse për trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë në Kosovë. IGJK ka bashkëpunuar ngushtë me UNDP, UN Women dhe OSBE për zhvillimin dhe zbatimin e trajnimeve gjinore.

³² Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës. (2012) Me çfarë çmimi?

³³ Van der Leest Kristin (2010) Gjinia dhe siguria: Vlerësim i aktorëve të sektorit të sigurisë dhe politikave, praktikave dhe strategjive gjinore, të përgatitur për GKSGJ.

Komisioni për Ndhmë Juridike

Komisioni për Ndhmë Juridike (KNJ) është themeluar më 2006 si institucion i pavarur qeveritar që ofron qasje në ndihmë juridike për ata që kanë mungesë të mjeteve financiare. Ky është institucioni i parë në Ballkan që ofron ndihmë juridike pa pagesë me financim të qeverisë me fokus të veçantë në pjesëtarët që i takojnë grupeve të cenueshëm ekonomikisht dhe në aspekte tjera. Në kuadër të Komisionit, zyrat për ndihmë juridike veprojnë në pesë rajonet e Kosovës dhe ofron ndihmë juridike pa pagesë në raste penale, civile dhe administrative. Këto shërbime përfshijnë këshilla juridike dhe përfaqësime pa pagesë në gjykata dhe organe administrative, si dhe asistencë në hartimin e dokumenteve dhe ankesave.

Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë

I themeluar në vitin 2000, roli i Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP) të Kosovës është që të mbështesë dhe të mbrojë të drejtat dhe liritë e personave, sipas standardeve ndërkombëtare që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut. UN Women ka ofruar trajnime për stafin e IAP-së mbi atë se si t'i qasen dhe adresojnë çështjet e ndjeshme të të drejtave të njeriut që lidhen me gjininë. Në strukturën e tij ai ka një njësi të veçantë për çështje që lidhen me gjininë.

Instituti Kosovar për Administratë Publike

Instituti Kosovar për Administratë Publike (IKAP) është një agjenci në kuadër të Ministrisë së Shërbimeve Publike që organizon dhe ofron trajnime për nëpunësit civilë të Kosovës. IKAP është mbështetur nga UN Women në zhvillimin e trajnimeve për barazi gjinore dhe ofrimin e këtyre trajnimeve, posaçërisht për strategjitë dhe planet kombëtare të veprimit.

Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës është përgjegjëse për kontrollin civil të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe formulimin dhe zbatimin e kornizës së politikave që rregullojnë aktivitetet e FSK-së³⁴. Themeluar më 2009, dhe nën mbikëqyrjen e NATO KFOR, FSK kryen operacione të reagimit, operacione të mbrojtjes civile dhe mbështetë autoritetet në reagimin ndaj fatkeqësive natyrore dhe emergjencave tjera. Me mbështetje të UN Women, MFSK ka përfaquar barazinë gjinore si synim bazuar në marrëveshjet dhe zotimet ndërkombëtare dhe kombëtare. Më 2011, është miratuar Politika për të Drejtat e Njeriut dhe Barazinë Gjinore bashkë me Planin e Veprimit dhe është themeluar Grupi Punues për Çështje Gjinore, Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe pozita e Zyrtarit Gjnor.

³⁴ Po aty

3.2. Organizatat Ndërkombëtare

Bashkimi Evropian në Kosovë

Bashkimi Evropian ka qenë pjesë thelbësore e përpjekjeve ndërkombëtare për ndërtimin e një të ardhmeje të re për Kosovën që nga viti 1999, duke luajtur një rol të madh në rindërtimin dhe zhvillimin e Kosovës. BE-ja ka përsëritur se Kosova ka një perspektivë të qartë evropiane në pajtim me perspektivën evropiane të rajonit të Ballkanit Perëndimor³⁵. BE-ja rregullisht ka identifikuar boshllëqet në politika dhe ka kërkuar nga autoritetet që të marrin veprime përkatëse. Studimi i Fizibilitetit për Kosovën 2012 ka përshkruar prioritetet afatshkurte dhe afatgjate për Kosovën që janë pjesë e procesit për përmbylljen e mundshme të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit. Ky standard politik është shtytës i reformave në Kosovë.

Bashkimi Evropian është i pranishëm në Kosovë përmes Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë/Përfaqësuesit Special të Bashkimit Evropian, EULEX-it dhe përfaqësive të shteteve anëtare të BE-së (ambasadave dhe zyrave ndërlidhëse).

EULEX-i është themeluar nga Veprimi i Përbashkët i Këshillit 2008/124/CFSP datë 4 shkurt 2008. EULEX ka mekanizma përkatës të llogaridhënies siç është Kolegji Shqyrtues për të Drejtat e Njeriut.

Gjithashtu, EULEX ka dy Këshilltarë Gjinatorë (një ndërkombëtar dhe një vendor).

Sipas VP të Këshillit 2008/124/CFSP për EULEX Kosovë, EULEX duhet të sigurojë se të gjitha aktivitetet e tij respektojnë standardet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut dhe integrimin e perspektivës gjinore. Mandati i EULEX-it kërkon që çështjet gjinore zbatohen në pajtim me politikën e BE-së, bazuar në RKSOKB 1325. Dy këshilltarë të dedikuar gjinatorë ndërkombëtarë dhe një vendor janë sistemuar në Zyrën e Zëvendëshefit të Misionit.

EULEX është Mision i integruar i Sundimit të Ligjit i Bashkimit Evropian që vepron në fushën e drejtësisë, policisë dhe doganave. Misioni ndihmon autoritetet kosovare, autoritetet gjyqësore dhe agjencitë e sundimit të ligjit në progresin e tyre drejtë qëndrueshmërisë dhe llogaridhënies. Misioni është i ndarë në dy 'divizione'; 'Divizioni Ekzekutiv' dhe 'Divizioni i Fuqizimit'. Divizioni Ekzekutiv heton, ndjek dhe gjykon rastet e ndjeshme përmes kompetencave të tij ekzekutive. Divizioni i Fuqizimit monitoron, mentorin dhe këshillon homologët vendorë në polici, drejtësi dhe dogana.

³⁵ Korrespondencë me email me Zyrën e BE-së: 22 janar 2013.

Vitet e fundit, Bashkimi Evropian (BE) ka ndërmarrë masa të fuqishme për të kaluar nga politikat në praktikë duke përfshirë: miratimin e Qasjes GjithëpërfshirësetëBE-së në zbatimin e Rezolutave të Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1325 dhe 1820 për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, zhvillimin e udhëzimeve për operacionalizimin e këtyre zotimeve në kontekst të Fuqizimit të Gruas (2010-2015).³⁶ Zyra ka pika kontaktuese gjinore të cilat bashkë me Këshilltarët Gjinorë nga EULEX-i bashkërendojnë punën e BE-së në çështjet gjinore.

BE-ja vazhdon të përdorë politikat e saj për zhvillim për promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimit të gruas. Një mjet shumë konkret është Dialogu për Stabilizim dhe Asocim për Qeverisje të Mirë dhe të Drejta të Njeriut. Raporti i Fizibilitetit për Kosovën është publikuar në tetor të vitit të kaluar, dhe përmes dialogut të politikave dhe raporteve BE-ja do të monitorojë situatën dhe standardet e barazisë gjinore për të mbetur e zotuar në frymën dhe obligimet e Rezolutës së KS të OKB-së 1325 dhe për të punuar më tutje me partnerët ndërkombëtarë dhe vendorë për përmirësim të situatës.

Organizata Civile Ndërkombëtare (ICO)

Deri në shtator të vitit 2012, ICO ka vepruar si faktor i rëndësishëm në përcaktimin e kornizës së politikave dhe legjislativë dhe mekanizmave përkatës në lidhje me sektorin e sigurisë. ICO ka për qëllim të zhvillojë një mekanizëm të monitorimit për kontrollimin e pjesëmarrjes

në trajnime për çështjet gjinore dhe për të vlerësuar veprimet përcjellëse. Për më tepër, ICO ka punuar drejt sigurimit të integritetit të perspektivës gjinore në njësitë e Këshillëdhënëse të Politikave dhe Sigurisë në veçanti. Një tjetër synim thelbësor i ICO ishte që të themelojë një mekanizëm të kontrollit për monitorimit të pjesëmarrjes së stafit të ICO në trajnimet gjinore dhe vlerësimin e aktiviteteve përcjellëse.

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE)

Misioni i OSBE-së në Kosovë është themeluar nga Këshilli i Përhershëm i OSBE-së si komponentë e veçantë e UNMIK-ut në korrik 1999. OSBE-ja luan një rol të rëndësishëm në integrimin sistematik të perspektivës gjinore në trajnimet fillestare. Gjithashtu, ajo është e përqendruar në përfshirjen e një eksperti kosovar për trajnimet fillestare specifike për misionin, për të paraqitur një analizë të kontekstit lokal dhe nevojave për siguri njerëzore, duke përfshirë të grave dhe vajzave. Për më tepër, OSBE-ja synon zhvillimin e ekspertizës së brendshme në trajtimin e aspekteve gjinore të trafikimit dhe dhunës në familje si dhe dhunës në baza gjinore.

Bashkë me akterë të tjerë, OSBE-ja ka qenë aktive në aktivitetet mbështetëse për integrimin e perspektivës gjinore në njësitë e të drejtave të njeriut në nivelin lokal dhe qendror. OSBE-ja gjithashtu ka mbështetur ABGJ-në në hartimin e raportit të tyre për zbatimin e CEDAW.

³⁶ Po aty.

Grupi për Siguri dhe Çështje Gjinore

Më 2007 UN Women ka themeluar Grupin Koordinues për Siguri dhe Çështje Gjinore (GKSGJ), tani Grupi për Siguri dhe Çështje Gjinore (GSGJ). GSGJ kryesohet nga UN Women dhe përbëhet nga organizatat e grave (Kvinna til Kvinna, Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës, Qendra Kosovare për Studime Gjinore), Institucionet e Kosovës (Agjencia për Barazi Gjinore, Grupi i Grave Deputete, Policia e Kosovës, Forca e Sigurisë së Kosovës) dhe Organizatat Ndërkombëtare (UNMIK, UNDP, UNICEF, UN-HABITAT, OHCHR, UNFPA, OBSH, UNOPS, UNHCR, UN Women, Zyra e BE-së, EULEX, OSBE dhe KFOR). QSGJ synon avokimin dhe avancimin e barazisë gjinore dhe fuqizimit të gruas. Për më tepër, QSGJ identifikon se ku dhe në çfarë niveli është integruar perspektiva gjinore në politikat e sigurisë, procedurat operative, programet dhe aktivitetet.³⁷ Që nga themelimi i tij, QSGJ është angazhuar në aktivitete të ndryshme që kanë të bëjnë me rritjen e të kuptuarit të sigurisë së gruas dhe nevojave për siguri, ndarjen e informatave dhe rritjen e bashkëpunimit dhe koordinimit.

Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP)

Programi për Zhvillim i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (UNDP) ka qenë aktiv në Kosovë që nga viti 1999. Ai ka ndihmuar qeverinë e Kosovës në zhvillimin e institucioneve lokale dhe i është bashkuar përpjekjeve në rindërtimin e Kosovës. Në punën e tij, vëmendje të posaçme i kushtohet barazisë gjinore, qasje kjo që është integruar në të gjitha projektet dhe aktivitetet e tij. UNDP ka zhvilluar tri fusha praktike: Qeverisje demokratike, Rritje përfshirëse dhe hulumtim i politikave, Çështje gjinore dhe komunikim.

Me qëllim të udhëzimit të proceseve të integrimit gjinor në të gjitha politikat, programet dhe aktivitetet, UNDP Kosovë ka zhvilluar një strategji të brendshme për integrim të perspektivës gjinore. Pas emërimit të Pikës Kontaktuese për Çështje Gjinore dhe këshilltarëve gjinorë më 2008, në vitin 2009 është punësuar një Këshilltar i Lartë për Çështje Gjinore, si pjesë e nismës globale për përsheptimin e integrimit të perspektivës gjinore në situatat e konfliktit dhe pas konfliktit.

³⁷ Stickings.M., (2011). Rrjetëzimi dhe rrjeti –ndërtimi i mbështetjes për gratë, paqen dhe sigurinë. Përvojat e grave nga Ballkani Perëndimor. UN Women, Valeur, s.r.o.

Prandaj, UNDP Kosovë është fokusuar në krijimin e sistemeve të brendshme që do të mund të lehtësonin qëndrueshmërinë e ndryshimeve të realizuara, duke përfshirë llogaridhënien e brendshme, rritjen e kapacitetit të menaxherëve të programit, dhe punësimin dhe mentorimin e zyrtarit vendor për çështje gjinore. Zyrtari Vendor për Çështje Gjinore luan rol të rëndësishëm në dhënien e këshillave dhe sigurimin e zbatimit të Strategjisë së UNDP për Barazi Gjinore dhe Agjendës së UNDP prej 8 Pikash, pjesë e RKSOKB 1312 që nga emërimi më 2010.

Përveç kësaj, UNDP ka themeluar një ekip për politika, hulumtim, çështje gjinore dhe komunikime (PHGJK) synimi i të cilit është që t'i sjellë në një vend funksionet e ndryshme ndërsektoriale. Zyrtari Gjinor, si pjesë e ekipit të tij, është përgjegjës për monitorimin e çdo projekti të ri që përgatitet, projektet ekzistuese, si dhe të ndihmojë në zhvillimin e komponentëve gjinore.

Përmes mekanizmit të shënjesit gjinor, sigurohet se të gjithë projektet, programet dhe procedurat në UNDP

janë në përputhje me strategjinë për integrimin e perspektivës gjinore dhe zhvillimin e planeve të tyre në përputhje me të.

Përmes kësaj qasje të re ndaj barazisë gjinore, UNDP ka vënë theksin në ndërtimin e partneriteteve të reja dhe ofrimin e udhëzimeve dhe këshillave për partnerët vendorë, siç janë Grupi i Grave Deputete i Kuvendit të Kosovës, Shoqata Afariste e Gruas, dhe Lobi Rajonal i Gruas për Paqe, Siguri dhe Drejtësi në Evropën Juglindore. Kjo ka çuar në fuqizimin e reagimit programatik në pjesëmarrjen e gruas në politikë, sigurinë e gruas dhe fuqizimin ekonomik të gruas. Këto nisma kanë lehtësuar zhvillimi e gjerë të këtyre fushave dhe kanë shërbyer si pikënisje për të tjera. UNDP është duke punuar në fuqizimin e sistemit aktual të ndihmës juridike për t'i mbuluar komunitetet në pozitë të pafavorshme, posaçërisht gratë, duke përfshirë organizata dhe institucione të specializuara ligjore siç janë Oda e Avokatëve të Kosovës, për të ofruar shërbime që marrin parasysh aspektin gjinor dhe që janë gjithëpërfshirëse.



UNDP mbështetë qeverinë në hartimin e ligjeve, dokumenteve të politikave dhe strategjive me dimensione gjinore. Disa prej tyre përfshijnë: ligjin për dhunën në familje, futjen e analizës buxhetore për çështjet sociale, hartimin e strategjisë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme përfshirë të gjithë indikatorët për ndërmarrësinë e grave, kornizën për burrat dhe gratë me aftësi të kufizuara në formulimin e strategjisë kombëtare, angazhimin me sektorin privat në mbështetjen e rritjes ekonomike, bashkëpunimin me sektorin privat në programet e punës praktike dhe shoqatat afariste të grave në politikëbërje, avancimin e sundimin e ligjit dhe drejtësisë gjinore përmes vlerësimit të institucioneve gjyqësore dhe promovimin e grave në sistem, si dhe futjen e konceptit të ndihmës juridike dhe shërbimeve të tyre në zonat shumëtnike. Gjithashtu, UNDP ofron mbështetje për fuqizimin ligjor të grave dhe organizatave të shoqërisë civile, posaçërisht grupeve të grave. Strukturimi i zhvillimit të planeve kombëtare strategjike në Zvogëlimin e Rreziqeve nga Katastrofat (DRR), duke inkorporuar OJQ-të e grave dhe perspektivën gjinore në procesin e planifikimit të DRR. Futja në komunat e reja të mekanizmave për ofrim të shërbimeve të përgjegjshme gjinore si qasje e të drejtave të njeriut. Ofrimi i mbështetjes për buxhetim të përgjegjshëm gjinor në 3 komuna pilot për t'u përsëritur më vonë sipas procesit të decentralizimit. Bashkëpunimi me grupin e grave deputete për planin strategjik katërvjeçar dhe ruajtjen e kuotës së gruas duke ofruar mbështetje në komunikim dhe media sociale dhe duke krijuar lidhjen me politikën IKNOW. UNDP mbështetë autoritet në fushën e ndryshimit klimatik dhe mjedisit në Kosovë në strukturimin e planeve aktuale strategjike dhe në intervenime. Dimensionet gjinore të mjedisit realizohen përmes eko-planifikimit dhe turizmit në një komunë pilot në formë të planifikimit të integruar mjedisor të komunës.

Komisari i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR)

Në mesin e prioriteteve tjera të politikave të mbrojtjes, UNHCR është mjaft i angazhuar në nevojat specifike të grave dhe vajzave në të gjitha nivelet. Gratë/Barazia gjinore janë prioriteteve specifike të politikave mbrojtëse të UNHCR-së dhe vazhdimisht monitorohen nevojat për mbrojtje dhe cënueshmëria e tyre. Për më tepër, UNHCR vazhdimisht promovon aplikimin në praktikë të përfaqësimit të grave në vendimmarrje.

Fondi Ndërkombëtar për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara (UNICEF)

Fokusi kryesor i UNICEF është mbrojtja dhe zhvillimi i fëmijëve në Kosovë. Përmes projekteve të tij, UNICEF angazhohet në promovimin e qasjes së barabartë në shërbime zhvillimore, posaçërisht në shkollimin e djemve dhe vajzave. Mes tjerash, UNICEF bashkëpunon dhe mbështetë Ministrin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në zbatimin e programit bazik për trajtimin e analfabetizmit tek gratë rurale.

Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA)

Programi "Përmirësimi i Shëndetit të Gruas dhe Fëmijëve në Kosovë" është duke u realizuar nga UNFPA, UNICEF dhe OBSH, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët tjerë përkatës, për përmirësimin e sistemit shëndetësor të Kosovës dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve shëndetësore për gratë dhe fëmijët, si dhe vetëdijësimin e publik për çështjet e shëndetit riprodhues dhe demonstrimin e përfitimeve sociale të kujdesit më të mirë për gratë dhe fëmijët.

UN Women

UN Women ka qenë e pranishme në Kosovë që nga viti 1999 me mandat për nxitjen e barazisë gjinore, fuqizimin e gruas dhe integrimin e perspektivës gjinore në punën e agjencive tjera të OKB-së. Që nga viti 1999, UN Women ka qenë vendimtar duke promovuar dhe kontribuar në përpjekjet qeveritare dhe të shoqërisë civile për të siguruar integrim të perspektivës gjinore në proceset e përgjithshme paqësore dhe ndërtim institucional, përfshirë edhe në sektorin e sigurisë, si dhe në ligjet dhe strategjitë për

luftën kundër dhunës ndaj gruas dhe për të siguruar të drejta të barabarta të gruas dhe pjesëmarrje të saj në vendimmarrje. UN Women bashkëpunon ngushtë me shoqërinë civile, mekanizmat përgjegjës për çështje gjinore në institucionet qeveritare dhe me grupet e grave. Ajo vepron si lehtësues dhe shtytës i shumicës së projekteve që përfshinë barazi gjinore dhe fuqizim. Gjithashtu, ajo mbështetë organizata të tjera në aktivitete të ndryshme, siç është rasti i mbështetjes për ABGJ-në në zhvillimin e planit strategjik të punës dhe organizmin e trajnimeve gjinore për institucionet qeveritare. UN Women përfshin të gjitha aspektet që kanë ndikim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në barazinë gjinore, fuqizimin e gruas dhe integrimin e perspektivës gjinore, siç është siguria, mbrojtja, pjesëmarrja, legjislacioni, ndihma dhe rimëkëmbja.

UN Women, një akterët kryesorë në zbatimin e RKSOKB 1325, ka punuar për së afërmi me organizatat ekzistuese dhe të reja në themelimin dhe mbajtjen e partneriteteve që lehtësojnë një rrjet përfshirës dhe të qëndrueshëm që prodhon nisma në pronësi vendore. Më 2002, UN Women ka lehtësuar procesin e

prodhimit të Planit të parë Kombëtar të Veprimit për përbushjen e barazisë gjinore në Kosovë, gjatë së cilit kanë arritur të mbledhin gratë nga politika, qeveria, shoqëria civile dhe mediat. Ndonëse organizatat ndërkombëtare janë ftuar në këtë proces, ato nuk janë përfshirë, dhe grupet e grave të Kosovës kanë zhvilluar Planin e tyre Kombëtar të Veprimit. Pas zhvillimit të PKV-së, UN Women bashkë me gratë deputete dhe RRGK-në kanë avokuar për miratimin e tij nga qeveria më 2004, që ka çuar në ndërtimin e një strukture më të madhe të makinerisë gjinore në Kosovë. Ky proces ka përfshirë hartimin dhe miratimin e ligjit për barazinë gjinore, themelimin e Grupit Punues Ndërmintor për Çështje Gjinore, zyrtarët gjinorë në ministri, Njësinë për Çështje Gjinore në Avokatin e Popullit dhe themelimin e ABGJ-së.

UN Women ka mbështetur ABGJ-në që nga themelimi i saj duke ofruar mbështetje përmes konsulentëve ligjorë ndërkombëtarë dhe vendorë në baza ditore dhe përmes zhvillimit të kapaciteteve të stafit të ABGJ-së dhe zyrtarëve gjinorë ministrorë dhe komunalë. Kohëve të fundit, UN Women ka mbështetur ABGJ-në dhe qeveria ka emëruar Grupin Punues për hartimin e Planit të Veprimit për zbatimin e RKSOKB 1325.

Që nga viti 2003 UN Women ka ndërtuar partneritete me akterët kryesorë të sigurisë si Policia e Kosovës (PK), Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK), si dhe partnerë tjerë relevantë, që ka rezultuar në integrimin e perspektivës gjinore në strukturat dhe programet e PK-së dhe TMK-së. Janë themeluar borde gjinore dhe zyrtarë gjinor, dhe UN Women gjithashtu ka mbështetur ngritjen e kapaciteteve të PK-së dhe TMK-së në barazinë gjinore dhe të drejtat e njeriut të gruas (DNJG), krijimin e një grupi të trajnuesve policorë dhe hartimin e plan-programit të trajnimit. Mekanizmat gjinorë të TMK-së dhe njerëzit e trajnuar nga to vazhdojnë të kryejnë funksionet e tyre edhe në ditët e sotme dhe janë forcë shtytëse e integritit të perspektivës gjinore në Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK). UN Women gjithashtu ka ofruar mbështetje për Qendrën Kosovare për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim (QKSPEZH) në krijimin e dy moduleve për mësimnxënie apo trajnim për Barazi Gjinore dhe Siguri Njerëzore të Gruas për trajnim të obligueshëm pesëditor për stafin e PK-së. Sot, trajnimet pesëditore realizohen së paku dy herë në vit në QKSPEZH për Policinë dhe zyrtarët e sigurisë. Veç kësaj, UN Women ka lehtësuar themelimin e marrëdhënies ndërmjet organizatave të gruas dhe sektorit të sigurisë, duke përfshirë aktivitetet përbashkëta ndërmjet OSHC-ve dhe PK-së. Aktualisht,

UN Women është duke vazhduar mbështetjen e saj për PK-në duke përkrahur procesin e themelimit të Asociacionit të Grave Police.

Përveç kësaj, UN Women ka ofruar trajnime për ligjet dhe strategjitë që kanë të bëjnë me çështje gjinore për gjyqësorin dhe profesionistët ligjorë. Në këtë fushë, UN Women ka ofruar mbështetje për Asociacionin Gjyqësor të Kosovës (AGJK), dhe vazhdon të mbështesë Institutin Gjyqësor të Kosovës në institucionalizimin e Barazisë Gjinore dhe të Drejtave të Njeriut të Gruas brenda Gjyqësorit. Deri më sot, është krijuar një grup trajnuesish (gjyqtarë dhe prokurorë) të cilët ofrojnë trajnime për gjyqësorin në të gjitha rajonet e Kosovës, dhe modulet e trajnimit për DNJG, dhunë në familje, dhe të drejtat pronësore të gruas janë përfshirë në plan-programin e trajnimeve të IGJK-së.

Nga viti 1999, UN Women ka mbështetur një numër aktivitetsh për të bërë të mundur që avokuesit e barazisë gjinore të kenë ndikim në punën drejt paqes dhe sigurisë në shtetet dhe rajonet e tyre të cilat kanë trajtuar nxitjen e dialogut ndërkuftar, ndëretnik, gjendjen e të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë konfliktit (që nga viti 2006), promovimin e pjesëmarrjes së gruas në negociatat paqësore dhe vendimmarrje, trajtimin e nevojave të grave nga pakicat dhe mbështetjen e fuqishme

në monitorimin e RKSOKB 1325. UN Women gjithashtu punon ngushtë me shoqërinë civile. Ajo ka lehtësuar përfshirjen e grave aktiviste në takime të nivelit të lartë, duke i ftuar ose ndarë shembullin e tyre në këto takime, dhe duke mbështetur lidhjen midis grave dhe akterëve ndërkombëtarë si: Departamenti i Operacioneve Paqeruajtëse (DPKO), Këshilli i Sigurimit i OKB-së, dhe Selia e OKB-së në Nju Jork, SHBA, I dërguari i posaçëm i SP të OKB-së SG për Kosovën, Martti Ahtisaari, institucionet e Bashkimit Evropian në Bruksel, Belgjikë, dhe të tjerë. UN Women gjithashtu ka ofruar mbështetje të drejtpërdrejtë teknike dhe financiare për organizatat e shumta të shoqërisë civile që punojnë në fushën e paqes dhe sigurisë.

Nga viti 2005, UN Women ka përkrahur organizatat e grave në Kosovë dhe Bosnjë e Hercegovinë në monitorimin e zbatimit të RKSOKB 1325 dhe krijimin e partneriteteve për çështjen e grave, paqes dhe sigurisë në nivel rajonal dhe nën-rajonal. Mbështetja specifike është ofruar për RRGK, siç është cekur më sipër, për monitorimin e fushëveprimin e zbatimit të Rezolutës 1325 nga qeveria dhe organizatat ndërkombëtare. Bazuar në rekomandimet e raportit, RRGK ka zhvilluar një plan veprimi për zbatimin e rezolutës 1325 në bashkëpunim të ngushtë me gratë

aktiviste. UN Women gjithashtu ka mbështetur procesin e azhurnimit të strategjisë së RRGK-së, ndërtimin e kapaciteteve të organizatave anëtare për t'i përfshirë më mirë në procesin e politikëbërjes.

Brenda mbështetjes së ofruar në ndërtimin e paqes rajonale ishte edhe themelimi i Lobit Rajonal të Grave për Paqe, Siguri dhe Drejtësi në Evropën Juglindore (LRG) në vitin 2006. LRG mundëson gratë e shquara politike dhe aktiviste që të promovojnë ndërtimin e paqes dhe të kenë ndikim në agjendën e paqes dhe sigurisë në Ballkan. UN Women vazhdon të jetë një partner i rëndësishëm për funksionimin e LRG-së, gjersa në të njëjtën kohë mbështet zhvillimin dhe pavarësimin e organizatës. Gjithashtu, UN Women ka mbështetur zgjerimin e Koalicionit të Grave për Paqe, që është rrjet i organizatës së grave nga Kosova, përmes udhëheqjes së RRGK, dhe Serbisë, përmes udhëheqjes së organizatës 'Gratë në të Zeza', dhe LRG-së. Rrjeti i grave ka ekzistuar edhe para konfliktit në Kosovë dhe gratë ishin në gjendje t'i shfrytëzojnë lidhjet e tyre personale për avokim ndërkufitar.

Siç është cekur më lartë, UN Women ka themeluar dhe kryeson Grupin për Siguri dhe Çështje Gjinore (GSGJ).

3.3. Shoqëria Civile

Shoqëria civile në Kosovë ka luajtur një rol të rëndësishëm në ngritjen e rolit të gruas në paqe dhe siguri. Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës (RRGGK) dhe organizata tjera të shoqërisë civile të grave kanë kontribuar në zhvillimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Barazi Gjinore, Programit Kosovar për Barazi Gjinore, Ligjit për Barazi Gjinore, dhe Ligjit Kundër Diskriminimit³⁹.

RRGGK është një nga organizatat lidere në avokim dhe lobim për zbatimin e RKSOKB 1325. RRGK është themeluar dhe menaxhohet nga organizata të grave, shërben dhe mbron të drejtat e grave dhe vajzave në Kosovë, me 100 organizata anëtare. Kjo organizatë ka qenë aktive para, gjatë dhe pas konfliktit, ndonëse zyrtarisht është themeluar në vitin 2000. Përmes grumbullimit të informatave në terren dhe analizimit të tyre, RRGK ka krijuar programin e saj për sigurinë e gruas, të drejtat e njeriut dhe ndërtimin e paqes, në mënyrë të pavarur dhe pa ndihmë të jashtme. Duke mbajtur lidhje të forta me organizata bazë në Kosovë, RRGK ka avokuar dhe lobuar deri të institucionet e nivelit më të lartë.

RRGGK aktivisht dhe vazhdimisht ka monitoruar zbatimin e RKSOKB 1325 përmes tre raporteve⁴⁰. Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ) gjithashtu ka realizuar hulumtime për çështjet gjinore dhe sigurinë, të titulluar "Monitorimi i sigurisë nga perspektiva gjinore". Me mbështetje të UN Women, QKSGJ ka përgatitur edhe raportin në hije të zbatimit të CEDAW për Komitetin e CEDAW.

Përveç kësaj, RRGK ka përdorur përvojën e saj për të mbështetur 15 organizata të grave serbe në krijimin e Rrjetit të Grave Serbe të Kosovës në kuadër të RRGK-së. UN Women dhe RRGK kanë punuar së bashku në fuqizimin dhe përfshirjen e grave serbe në zbatimin e RKSOKB 1325.

RRGGK ka organizuar dhe drejtuar tetë takime me vendimmarrës ndërkombëtarë dhe vendorë si përfaqësues të ICO-së, Raportuesi Special i BE-së për Kosovën, Grupi i Grave Deputete në Kuvendin e Kosovës dhe Udhëheqësja e ABGJ për të diskutuar se si të avokohet për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit, ligjet përkatëse dhe RKSOKB 1325.⁴¹

³⁹Van der Leest Kristin (2010) Gjinia dhe siguria: Vlerësim i aktorëve të sektorit të sigurisë dhe politikave, praktikave dhe strategjive gjinore, të përgatitur për GKSGJ.

⁴⁰Dy raportet e para janë mbështetur nga UN Women, dhe i treti nga Agjencia Austriake për Zhvillim. Të gjithë këto raporte ofrojnë informata të shumta për punën e të gjitha institucioneve përkatëse kombëtare, organizatave ndërkombëtare, OJQ-ve që kanë të bëjnë me zbatimin e RKSOKB 1325.

⁴¹Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës, Monitorimi i zbatimit të RKSOKB 1325 në Kosovë.

Shoqata e Juristëve NORMA ka qenë shumë aktive në lehtësimin e qasjes në drejtësi për viktimat e dhunës në baza gjinore, dhunës në familje dhe trafikimit, duke ofruar ndihmë juridike, mbështetje dhe përfaqësim ligjor. NORMA gjithashtu ka përdorur temën për dhunën në baza gjinore si platformë për t'i mbledhur gratë nga komunitete të ndryshme etnike në një vend duke kontribuar kështu në dialogun ndëretnik dhe ndërtimin e besimit, si dhe në pajtimin mes komuniteteve. MedicaKosova ka qenë shumë aktive që nga viti 1999 duke punuar me viktimat të dhunës në baza gjinore, duke përfshirë të mbijetuarit e dhunës seksuale të lidhur me konfliktin, duke ofruar shërbime të rehabilitimit, si dhe duke avokuar për më shumë qasje në shërbime që i përmbushin nevojat e këtyre grave në Kosovë.

Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT) ka punuar në fushën e shëndetit mendor duke ofruar këshilla psikologjike pa pagesë për individë dhe grupe. Në mesin e grupeve të tyre specifike të synuara janë edhe të mbijetuarit e dhunës seksuale nga konflikti. Rrjeti i organizatave të grave rome, ashkali dhe egjiptiane (NRAEWOK) është themeluar zyrtarisht më 2012, gjashtë pas funksionimit të saj, me mbështetje dhe mentorim të fuqishëm nga UN Women. NRAEWOK realizon aktivitete të shumta në avokimin për të drejtat, nevojat dhe shqetësimet e grave rome, ashkali dhe egjiptiane në Kosovë.

Kapitulli 4: Baza e të dhënave e nismave për gratë, paqen dhe sigurinë

Kjo pjesë përfshin të gjitha nismat/projektet e identifikuara gjatë hulumtimit të paraqitura në formë të një baze të të dhënave me informata për: emrin e institucionit, emrin e nismës, rezultatet/outputet e synuara, periudhën e zbatimit, shtyllat e RKSOKB 1325 (parandalimi, mbrojtja, pjesëmarrja, ndihma dhe rimëkëmbja), donatorin/mbështetësin, sidhe gjendjen aktuale të zbatimit. Nismat janë analizuar dhe kategorizuar në shtyllat përkatëse bazuar në synimet dhe outputet e tyre. Të dhënat që mungojnë janë paraqitur me simbolin '-'; që tregon se kjo informatë mungon apo nuk është mundur të grumbullohet nga institucionet. Shumica e të dhënave që mungojnë, të cilat nuk

kanë mundur të grumbullohen nga institucionet përkatëse, mungojnë ose për shkak të mungesës së stafit në institucionin përkatës apo moskujtesës institucionale.

Ky ushtrim i identifikimit ka arritur t'i identifikojë 88 nisma të cilat kanë pasur për qëllim trajtimin e rolit të gruas në paqe dhe siguri. Shumica e nismave janë financuar nga organizata ndërkombëtare, të cilat kanë mbështetur institucionet lokale në trajtimin e pabarazisë gjinore dhe mungesës së pjesëmarrjes së grave në politikë, siguri dhe politika ekonomike. Baza e të dhënave më poshtë nuk përfshin të gjitha, por shumicën e nismave kryesore të realizuara në këtë fushë.

Baza e të dhënave për nismat/projektet për gratë, paqen dhe sigurinë 1999-2012

Nr	Emri i institucionit	Emri i nismës	Rezultatet/outputt e synuar	Periudha e zbatimit	Parandalimi	Mbrojtja	Pjesëmarrja	Ndihma dhe rimëkëmbim	Donatori/mbështetësi	Statusi
1	Qendra e Trajnimeve dhe Buri-meve për Avokim (ATRC)	Diskutime publike për çështjen e pjesëmarrjes së grave në negociatat për statusin final të Kosovës	Diskutime të organizuara publike me Lobin e Grave të Kosovës për avokim për përfshirjen e grave në negociatat për paqe	2006			✓		-	I përfunduar
2	Agjencia për Barazi Gjinore (AGE)	Inicimi i hartimit të planit kombëtar të veprimit për zbatimin e 1325	Hartimi i Strategjisë Kombëtare për zbatimin e RKSOKB 1325, me kontribut të shoqërisë civile, institucioneve publike dhe organizatave ndërkombëtare	2012	✓	✓	✓	✓	UNWomen&OHCHR	Në zbatim e sipër
3	Amnesty International	Kosovë (Serbi dhe Mal i Zi): "A do të thotë se i kemi të drejtat?", Mbrojtja e të drejtave të njeriut të gruas dhe vajzave të trafikuar për prostitucion të detyruar në Kosovë.	Gjetjet e raportit kanë identifikuar abuzime të kryera ndaj grave dhe vajzave në Kosovë, përfshirë kidnapime, privim të lirisë dhe mohim të lirisë së lëvizjes, shpeshherë në kombinim me kufizime të tjera, duke përfshirë marrjen e dokumenteve të udhëtimit dhe identifikimit.	2004	✓	✓			-	I përfunduar
4	CIVIPOL dhe KPC	Trajnim me fokus në çështjet gjinore	Këto trajnime janë përgatitur nga këshilltari i lartë gjinor në CIVIPOL me qëllim të rritjes së llogaridhënies në të gjitha aspektet dhe nivelet e vendimmarrjes që prekin gratë dhe çështjet gjinore brenda mandatit të UNMIK-ut	2005	✓		✓		CIVIPOL dhe KPC	I përfunduar
5	Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNJ)	Organizimi i tryezës së rumbullakët për rolin e mediave dhe shoqërisë civile në avancimin e pozitës së gruas	KMDLNJ ka organizuar një tryezë të rumbullakët me përfaqësues të parlamentit, OJQ-të, ministrinë dhe mediat për të diskutuar për rolin e mediave dhe shoqërisë civile në avancimin e pozitës së gruas në shoqëri, ku më së shumti është diskutuar për RKSOKB 1325	2007	✓		✓		KMDLNJ	I përfunduar
6	Zyra Ndërlidhëse e BE-së në Kosovë	Hulumtim dhe monitorim i zbatimit të ligjit për barazi gjinore	Hulumtim dhe monitorim i zbatimit të ligjit për barazi gjinore. Në procesin e monitorimit ky projekt synon ngritjen e vetëdijes në lidhje me pozitën e dobët të gruas në shtresa të ndryshme të shoqërisë	2010 - 2012	✓	✓	✓		Ambasada e Holandës BE&EIDHR	I përfunduar

7	EIDHR	Parandalimi për grupet e cenushe të rinisë dhe grave në Kosovë	Objektivi i përgjithshëm i veprimit është luftimi dhe parandalimi i trafikimit me qenie njerëzore duke ngritur vetëdijen lidhur me rreziqet ndaj grupeve më të cenushe	2010	✓				BE	I përfunduar
8	EIDHR	Hulumtim dhe monitorim i zbatimit të ligjit për barazi gjinore	Projekti ka për qëllim avancimin e respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore përmes promovimit të të drejtave të gruas.	2009 - 2011	✓	✓			BE	I përfunduar
9	EIDHR	Fuqizimi i rolit të grave në moshë më të shtyrë në promovimin e barazisë gjinore	Fuqizimi i grave të cenushe të moshuara në viset rurale për të ndikuar në arritjen e barazisë gjinore në shoqërinë e Kosovës. Rezoluta: - themelimi i qendrës ditore që ofron shërbime ditore dhe aktiviteteve të fuqizimit të gruas	2011-2013		✓	✓	✓	BE	Në zbatim e sipër
10	EIDHR	Vetëdijesimi gjinor si pjesë e kulturës popullore	Futja e përmbajtjes së ndjeshme gjinore në kulturën popullore/të përgjithshme përmes këngëtarëve të zhanrit pop dhe hip-hop; Vetëdijesimi i të rinjve për pasojat negative të dhunës në baza gjinore dhe inkuadrimi i barazisë gjinore në shumicën e formave popullore të ngjarjeve artistike dhe socio-kulturore. Rezultatet: - Grumbullimi dhe shpërndarja e të dhënave për dominimin e dhunës tek të rinjtë	2012 - 2014		✓	✓		BE	Në zbatim e sipër
11	EIDHR	Gratë së bashku për të drejtat e njeriut	Gratë nga Mitrovica punojnë së bashku për të drejtat e tyre të njeriut dhe të drejtat e tyre në komunën e Mitrovicë pavarësisht gjinisë, etnisë apo fesë së tyre. Rezultatet: - 5 grupe ndëretnike të grave, një në secilin lokacion	2012-2014			✓	✓	BE	Në zbatim e sipër
12	Qeveria e Kosovës	Njësitë për të Drejtat e Njeriut	Themelimi i njësisë për të drejtat e njeriut në nivel lokal dhe qendror, sipas Vendimit nr. 055. Mandati i NJDNJ është që të mbrojë, promovojë dhe raportojë për të drejtat e njeriut	2005	✓	✓	✓	✓	Zyra e Kryeministrit të Kosovës	I përfunduar

13	Qeveria e Kosovës	Komisioni për Ndhimë Juridike	Komisioni është themeluar nga Qeveria e Kosovës për ofrimin e ndihmës juridike pa pagesë për grupet e marginalizuara përfshirë viktimat e dhunës në familje dhe trafikimit			✓		✓	Qeveria e Kosovës	I përfunduar
14	IOM/Koalicioni i Strehimoreve	Shtëpitë e Sigurta të KSC	Synimi i këtij projekti është që të financohen 6 strehimore ku gratë që përballen me dhunë në familje mund të gjejnë vendstrehim të sigurt. Këto shtëpi janë të vendosura në tërë Kosovën (Prishtinë, Mitrovicë, Gjakovë, Pejë, Prizren dhe Gjiilan).	2010 - 2012		✓		✓	Ambasada e Holandës	Në zbatim e sipër
15	Policia e Kosovës, Ministria e Punë dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Drejtësisë, Strehimoret, Divizioni për avokimin dhe ndihmën për viktimat	PSO-të për trafikimin	Krijimi i procedurave standarde të operimit për përgjegjësitë e deleguara te institucionet si Policia e Kosovës, Ministria e Punë dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Drejtësisë, Strehimoret, Divizioni për avokimin dhe ndihmën për viktimat për menaxhimin e rasteve të femrave dhe fëmijëve të trafikuar.	2010		✓		✓	OSBE dhe IOM	I përfunduar
16	Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës (RRGGK)	Protestë për pjesëmarrje të grave në ekipin negociator	RRGGK ka organizuar një protestë për përfshirjen e grave në ekipin e negociimit, duke bazuar argumentet e tyre në zbatimin e RK-SOKB 1325	2006	✓	✓	✓	✓	-	I përfunduar
17	Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës (RRGGK)	Rritja e vetëdijesimit për RKSOKB 1325 brenda KFOR	RRGGK ka organizuar një varg takimesh dhe bisedimesh me përfaqësues të KFOR-it për të dhënë informata dhe ngritur vetëdijen për RKSOKB 1325	2007	✓	✓			UN Women	I përfunduar
18	Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës (RRGGK)	"Raporti "Siguria fillon në shtëpi"	RRGGK ka kryer një anketë për perceptimin e dhunës në familje, që dokumenton praninë dhe format e dhunës në familje në Kosovë, si dhe reagimet institucionale për mbrojtjen e viktimave, ndjekjen penale të kryerësve dhe parandalimin e dhunës	2008	✓	✓		✓	Agjencia për Barazi Gjinore	I përfunduar

19	Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës (RRGGK)	Monitorimi i zbatimit të 1325: Fakte dhe fabula	RRGGK monitoron zbatimin e Rezolutës 1325 për herë të tretë, duke përdorur faktet e gjendjes në Kosovë, si dhe fabulat e nxjerra nga përvoja e akterëve kyç të intervistuar në Kosovë	2011	✓	✓	✓		Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim	I përfunduar
20	Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës (RRGGK)	Protestë për drejtësi për gratë e përdhunuara	RRGGK ka organizuar një protestë për të kërkuar drejtësi për gratë e përdhunuara gjatë luftës.	2012		✓	✓	✓	RRGGK	I përfunduar
21	Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës (RRGGK)	Mbështetje për Rrjetin e Grupit të Grave të Kosovës	Krijimi dhe mbajtja e një rrjeti të organizatave të grave që ka për qëllim mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të grave dhe vajzave në Kosovë	2000-2012	✓	✓	✓		Kvinna til Kvinna	Në zbatim e sipër
22	Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës (RRGGK)	Mbështetje për njësitë gjinore në TMK dhe SHKP	SHP, TMK, UN Women, KFOR, Policia e UNMIK-ut, dhe RRGGK kanë bashkëpunuar për përmirësimin e zbatimit të RKSOKB 1325. Ata kanë mbështetur njësitë gjinore në SHKP dhe TMK duke iu ofruar trajnime, informata dhe bashkëpunim për aktivitetet që adresojnë rolin e grave në vendimmarrje, trafikim dhe dhunë në familje.		✓	✓	✓		UN Women dhe RRGGK	I përfunduar
23	Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës (RRGGK) dhe Gratë në të Zeza	Nënshkrimi i Memorandumit ndërmjet RRGK dhe Grave në të Zeza	RRGGK dhe Gratë në të Zeza kanë nënshkruar një memorandum që ka shënuar fillimin e monitorimit të përbashkët të negociatave ndërmjet Kosovës dhe Serbisë për të siguruar se merret parasysh zëri i grave.	2007	✓		✓		UN Women	I përfunduar
24	Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës dhe Lobi i Grave të Kosovës	Ngritja e vetëdijes për RKSOKB 1325	Më 8 mars RRGGK ka organizuar paraqitje të ndryshme publike që kishin në fokus ofrimin e informatave që kanë të bëjnë me RKSOKB 1325, dhe rëndësinë e pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje dhe posaçërisht gjatë negociatave dhe ka organizuar një protestë para teatrit kombëtar në Prishtinë	2007	✓		✓		UN Women	I përfunduar

25	Qendra Kosovare për Siguri Publike dhe Zhvillim (QKSPEZH)	Themelimi i Qendrës për Barazi Gjinore	Me mbështetje të EULEX, QKSPEZH ka themeluar një sektor brenda qendrës që ka të bëjë me barazinë gjinore	2009	✓				EULEX	I përfunduar
26	Shërbimi Korrektues i Kosovës (SHKK)	Trajnim për barazi gjinore	SHKK ka iniciuar dhe organizuar trajnime për stafin për barazi gjinore si pjesë e kontributit të tyre në zbatimin RKSOKB 1325.		✓				UN Women	I përfunduar
27	Qendra Kosovare për Studime Gjinore	Politikë kundër ngacmimit seksual	QKSGJ ka përgatitur një politikë kundër ngacmimit seksual që do të zbatohet në Universitetin e Prishtinës.	2004-2005	✓	✓			QKSGJ	I përfunduar
28	Qendra Kosovare për Studime Gjinore	Raporti në hije	Përgatitja e "Raportit në Hijë" për zbatimin e CEDAW në Kosovë.		✓				UN Women	I përfunduar
29	Qeveria e Kosovës	Rritja e pjesëmarrjes së gruas në vendimmarrje	Caktimi i kuotës gjinore prej 30% në kuvendet lokale dhe qendrore	2001			✓		-	I përfunduar
30	Qeveria e Kosovës	Agjencia për Barazi Gjinore	Themelimi i Zyrës për Barazi Gjinore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, që më 2008 është transformuar në Agjencinë për Barazi Gjinore.	2004	✓	✓	✓	✓	Zyra e Kryeministrit	I përfunduar
31	Policia e Kosovës	Krijimi i sallave për marrje në pyetje	Policia e Kosovës ka krijuar 12 salla private të marrjes në pyetje në stacione policore në tërë Kosovën për të siguruar privatësi për gratë që raportojnë rastet e dhunës			✓		✓	UN Women	I përfunduar
32	Fondacioni Kosovar i Popullsisë	Trajtimi i trafikimit me qenie njerëzore për qëllime seksuale dhe prostitucioni në Kosovë.	Synimi i këtij projekti ishte të hulumtohet fenomeni i trafikimit me njerëz dhe prostitucionit në Kosovë dhe të shpërndahen konkluzat e këtij hulumtimi me akterët relevantë, duke nxitur një reagim efektiv në trafikimin për qëllime seksuale dhe prostitucion.	2011 - 2012	✓	✓			Ambasada e Holandës	Në zbatim e sipër

33	Organizata e grave RAE të Kosovës	Avancimi i pjesëmarrjes së grave RAE	Pjesëmarrja dhe diskutimi i çështjeve që kanë të bëjnë me zbatimin e RKSOKB 1325 përmes përfshirjes së tyre në grupe punuese qeveritare të cilat janë themeluar nga KFOS dhe OSBE për trajtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me gratë RAE.		✓		✓		OSBE dhe KFOS	I përfunduar
34	Kvinna till Kvinna	Promovimi dhe lobimi për zbatimin e RKSOKB 1325	KtK ka qenë aktive në lobimin për zbatimin e RKSOKB 1325. Ata kanë dërguar dy letra tek Ministri i Jashtëm Suedez më 2006, dhe PSSP në Kosovë më 2005	2005-2006	✓				KtK	I përfunduar
35	Kvinna till Kvinna	Mbështetje për Kvinna till Kvinna	Kvinna till Kvinna përmes mbështetjes për OJQ-të do të synojë këto fusha: gratë në procesin paqësor, organizatat e grave, pjesëmarrja e gruas në proceset vendimmarrëse, të drejtat e njeriut të gruas, aktivitetet e gruas kundër dhunës dhe abuzimit seksual dhe shëndeti fizik dhe mendor i gruas.	2007 - 2012		✓	✓	✓	Ambasada e Suedisë	Në zbatim e sipër
36	Kvinna till Kvinna	Mbështetje për programin e Kvinna till Kvinna në Kosovë gjatë 2012-2014	KtK ka tri fusha të programeve: 1) kontributi për një lëvizje të qëndrueshme të gruas në Kosovë përmes mbështetjes së një spektri të gjerë organizatash; 2) Përmirësimi i sigurisë njerëzore për gratë në Kosovës përmes punës së organizatave partnere kundër dhunës direkte dhe strukturore; 3) organizatat partnere në Kosovë kanë kontribuar në rritje të pjesëmarrjes dhe vendimmarrjes nga gratë.	2012 - 2014		✓	✓	✓	Ambasada e Suedisë	Në zbatim e sipër
37	OJQ Të drejtat e gruas	Fushatë kundër dhunës në familje, realizuar nga OJQ Të drejtat e gruas \	Synimi afatgjatë i projektit është zbatimi efektiv i ligjit kundër dhunës në familje	2012	✓	✓			Ambasada e Holandës	Në zbatim e sipër

38	Shoqata e Juristëve Norma dhe UN Women	Lobi Rajonal i Grave për Paqe, Siguri dhe Drejtësi në Evropën Juglindore	Mbështetje e dialogut ndëretnik ndërmjet OJQ-ve serbe dhe shqiptare të gruas	2005			✓		UN Women	I përfunduar
39	OSBE	Plani i Veprimit Gjinor	Plani i Veprimit synon parandalimin e diskriminimit gjinor në fushën politike, ushtarake, ekonomike, mjedisore dhe njerëzore të qeverisjes, themelimin e kornizës për organizimin dhe vlerësimin e programeve dhe projekteve	2004	✓		✓		UN Women	I përfunduar
40	OSBE	Këshilli Ndërmëtor për Barazi Gjinore	Këshilli lidhë barazinë gjinore dhe sigurinë sipas RKSOKB 1325 dhe priorizon pjesëmarrjen e gruas në parandalimin e konfliktit, menaxhimin e krizave dhe rehabilitimin pas konfliktit	2005			✓		OSBE	I përfunduar
41	PVPT	Qendra për mbrojtjen e viktimave dhe parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore	Programi ka filluar në korrik 2008. Qëllimi është që të ofrohet strehim dhe rehabilitim për viktimat dhe viktimat potenciale të trafikimit me qenie njerëzore në nevojë të këtij shërbimi, në mbarë Kosovën. Organizimi gjithashtu ka aktivitete ndërgjegjësimi.	2008 - 2011		✓		✓	Ambasada e Finlandës	I përfunduar
42	Lobi Rajonal i Grave për Paqe, Siguri dhe Drejtësi (LRG)		Anëtarët e LRG-së janë takuar me të Deleguarin Special të Sekretarit të Përgjithshëm në Kosovë, anëtarë të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, që kanë të bëjnë me Rezolutën 1325 dhe statusin e ardhshëm të Kosovës	2008	✓	✓	✓	✓	UN Women	I përfunduar
43	Lobi Rajonal i Grave për Paqe, Siguri dhe Drejtësi (LRG)	Dialog ndërmjet deputeteve nga Serbia dhe Kosova	Lobi Rajonal i Grave për Paqe, Siguri dhe Drejtësi (LRG) është organizatë rajonale që grumbullon gra politike, eksperte dhe aktiviste nga Ballkani perëndimor, të zotuar në synimet e thellimit të sigurisë njerëzore, duke promovuar të drejtat e gruas dhe pjesëmarrjen në proceset vendim-marrëse dhe thyerjen e pengesave të politikave etnocentrike.	2012 - 2013	✓	✓	✓	✓	Ambasada e Finlandës	Në zbatim e sipër

44	RTK (Jeta në Kosovë) & RTV 21	Ndërgjegjësim për RKSOKB 1325	RTV 21 ka prodhuar një film dokumentar që avokon dhe shpjegon RKSOKB 1325, Jeta në Kosovë	2007	✓	✓	✓	✓	Media	I përfunduar
45	Koalicioni i Strehimoreve	Fuqizimi i Koalicionit të Strehimoreve	Objektivi i përgjithshëm i projekt-propozimit është që të forcohet koalicioni/ rrjeti i strehimoreve të Kosovës si akterë i fuqishëm i shoqërisë civile, që mund të evokojë dhe monitorojë zbatimin e legjislacionit të fundit për dhunën në familje dhe promovimin e ofrimit adekuat të shërbimeve të qasshme dhe cilësore, fuqizimin ekonomik të grave në rrezik, identifikimin dhe referimin e viktimave të trafikimit, si dhe koordinimin rajonal me ofrues të tjerë të shërbimeve.	2011 - 2012		✓		✓	Ambasada e Holandës	Në zbatim e sipër
46	Strehimorja Gjilan	Qendra për Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Grave dhe Fëmijëve në Gjilan, Faza II	Përveç qendrës së grave në Gjilan që është e vetmja në Kosovën Lindore, ekzistojnë katër strehimore tjera për viktimat e dhunës në familje në Kosovën perëndimore. Krahas komunës së Gjilanit, kontaktet me komunat fqinje, nga ku edhe janë akomoduar gratë në Qendër janë intensifikuar me qëllim të mbulimit të qëndrueshëm të kostove të Qendrës në të ardhmen.	2003 - 2005		✓		✓	Agjencia Zhvillimore Austriake, Caritas Austria dhe Organizata e Grave Liria	I përfunduar

47	UN Women	Avancimi i zbatimit të RKSOKB 1325 për Gratë, Paqen dhe Sigurinë	Projekti rajonal për <i>Avancimin e zbatimit të RKSOKB 1325 për Gratë, Paqen dhe Sigurinë</i> . Në rajonin e Ballkanit Perëndimor ka filluar më 1999 në Kosovë si projekt pilot dhe është bërë projekt rajonal më 2005. Në kuadër të këtij projekti, UN Women ka punuar me partnerët qeveritarë dhe organizatat e gruas dhe rrjetet e tyre duke përfshirë Rrjetin e Grupit të Grave të Kosovës, Rrjetin e organizatave rome, ashkallike dhe egjiptiane në Kosovë dhe the Lobi Rajonal i Grave për Paqe, Siguri dhe Drejtësi në Evropën Juglindore në promovimin dhe zbatimin e obligimeve në fushën e gjinisë dhe sigurisë që dalin nga RKSOKB 1325 dhe rezolutat e saj plotësuese duke përfshirë mbështetjen për rritjen e ndjeshmërisë gjinore të sektorit të sigurisë dhe zhvillimin e Planeve të Veprimit	1999-2013	✓	✓	✓	✓	Austria, Islanda, Norvegjia dhe Suedia	Në zbatim e sipër
48	UN Women dhe OSBE	Themelimi i komiteteve për barazi gjinore në Kuvendet Komunale	Integrimi i çështjeve gjinore në strategjitë dhe praktikat komunale që kanë rezultuar me themelimin e komiteteve të barazisë gjinore në Kuvendet Komunale, përmes nismave të Kryetarëve të Komunave	2001-2003	✓	✓	✓	✓	UN Women	I përfunduar
49	UN Women	Avancimi i barazisë gjinore dhe të drejtave të gruas në Kosovë	Mbështetje për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për arritjen e Barazisë Gjinore në Kosovës përmes UN Women	2008 - 2009	✓	✓	✓		Ambasada e Suedisë	I përfunduar

50	UN Women, UNDP & BE	Avancimi i Pjesëmarrjes së Gruas në ndërtimin e paqes dhe planifikimit të pas konfliktit	Programi dyvjeçar synon sigurimin e pjesëmarrjes më të madhe të gruas në ndërtim të paqes dhe planifikim pas konfliktit. Kjo do të bëhet përmes fuqizimit të kapacitetit dhe koordinimit të institucioneve dhe akterëve relevantë të BE-së dhe OKB-së, themelimit të hapësirave të rregullta për dialog me shoqërinë civile të gruas, shtjellimit dhe miratimit të Planit Kombëtar të Veprimit RKSOKB 1325, përmes dhënies së organizatave të shoqërisë civile qasje në financim vendimtar fillestar, përmes mbështetjes së lidereve gra në pjesëmarrje në proceset e planifikimit të ndërtimit të paqes dhe pas konfliktit dhe për drejtimin e nismës avokuese me dukshmëri të lartë, përmes ndërgjegjësimit të opinionit publik për WPS.	2012 - 2014			✓			Instrumenti i Komisionit Evropian për Stabilitet	Në zbatim e sipër
51	UNDP	Avancimi i drejtësisë gjinore	Projekti mbështetë fuqizimin ligjor, anti-diskriminimin e komuniteteve në pozitë të pafavorshme, posaçërisht grave, mbështetjen e drejtësisë tranzicionale, qasjen në organet e të drejtave të njeriut	2012		✓				Ambasada e Holandës	Në zbatim e sipër
52	UNDP	UNDP WSSI (Nisma për siguri të gruas)	Faza e parë e WSSI të UNDP-së kishte për synim krijimin e institucioneve efektive gjyqësore dhe policore dhe kontributin për rritje të sigurisë personale. Për ta arritur këtë qëllim, UNDP WSSI është fokusuar në rritjen e kapacitetit të institucioneve publike në luftimin e dhunës ndaj gruas.	2007-2010	✓	✓		✓		Zyra e Jashtme e Komouelthit (FCO)	I përfunduar

53	UNDP	Programi i Kosovës Kundër Trafikimit (OKT)	Objektivat kryesore të këtij programi trevjeçar ishin mbështetja e shërbimeve të riintegritit për viktimat e trafikimit dhe rritja e pjesëmarrjes së komunitetit në parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore në Kosovë.	2008 - 2012	✓	✓	✓	✓	UNKT	Në zbatim e sipër
54	UNDP	Programi Global për Barazi Gjinore	UNDP Kosovë ka zhvilluar një strategji për integrimin e brendshëm të perspektivës gjinore. Pas emërimit të Pikës Kontaktuese Gjinore më 2008 dhe emërimit të këshilltarëve gjinorë, më 2009 është punësuar një Këshilltar i Lartë Gjinor, si pjesë e nismës globale për përshtetimin e integritit të perspektivës gjinore në situatat e konfliktit dhe pas konfliktit. Zyrtari Vendor Gjinor luan rol të rëndësishëm në ofrimin e këshillave dhe sigurimin e cilësisë në zbatimin e Strategjisë së UNDP-së për Barazi Gjinore dhe Agjendës 8-pikëshe të UNDP, si pjesë e RKSOKB 1312.	2009 - 2012	✓	✓	✓		UNDP	Në zbatim e sipër
55	UNDP	UNDP WSSI (Nisma për siguri të gruas)	Janë rritur kapacitetet e ofrimit të qeverisë, sigurisë dhe drejtësisë për zbatimin e Ligjit për dhunën në familje; Është hartuar, zbatuar dhe monitoruar Strategjia Kombëtare dhe Planit i Veprimit kundër Dhunës në Familje, është ofruar mbështetje e konsiderueshme teknike për Ministrinë e Punëve të Brendshme për rishikimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Trafikimin me qenie njerëzore; fuqizimi i aftësisë së shoqërisë civile për monitorimin dhe verifikimin e zbatimit të ligjit për dhunën në familje dhe planit kombëtar të veprimit;	2010 - 2013	✓	✓		✓	Ambasada e Holandës	Në zbatim e sipër

56	UNDP dhe UN Women	Pjesëmarrja e gruas në formimin e Kosovës së re	Dy komponentë të projektit përfshijnë faktorë si rritja e vetëdijes së politikaneve dhe kandidateve për zgjedhje, mobilizimi dhe avokimi për çështjet gjinore, si dhe rritja e komunikimit ndërmjet grave serbe dhe shqiptare për paqe dhe siguri.	2008			✓	✓	Fondi i Mirëbesimit Gjinor Tematik	I përfunduar
57	UNHCR	Lokalizimi i mbrojtjes së pakicave dhe programi i kthimit	KN (NCA) është Agjencia kryesore për mbrojtjen për UNHCR në Mitrovicë. Mbështetë kthimin dhe riintegrimin e qëndrueshëm të të kthyerve pakicë, promovon mbrojtjen dhe mbështetë përmbushjen e zgjidhjeve afatgjate për burrat dhe gratë e zhvendosura brenda Kosovës	2008		✓		✓	Ambasada e Norvegjisë	I përfunduar
58	UNHCR	Trajnim për Dhunën seksuale dhe në baza gjinore	Dy objektiva të këtij trajnimi ishin: fuqizimi i kapaciteteve të përgjithshme të stafit dhe organizatave partnere dhe të kontribuojë në Prioritetet Strategjike Globale të UNHCR që trajtojnë "Sigurinë nga dhuna dhe eksploatimi".	2012	✓	✓			UNHCR	Në zbatim e sipër
59	UNHCR	Trajnim vjetor për DHSBGJ për Programin e të Drejtave Civile / Kosovë (CRP/K)	Ofrimi i trajnimeve specifike për DHSBGJ për Programin e të Drejtave Civile/Kosovë (CRP/K), që ofron ndihmë juridike pa pagesë për personat në shqetësim të UNHCR. Si pasojë e këtyre trajnimeve, nga viti 2009, zyra kryesore e CRP/K në Prishtinë si dhe pesë zyrat e saj në terren ka caktuar stafin përgjegjës për çështje të AGDM dhe DHSBGJ ndonëse i tërë stafi, përfshirë IP-të janë ngarkuar me integrimin e këtyre aktiviteteve gjatë punës së tyre ditore.		✓	✓			UNHCR	Në zbatim e sipër
60	UNHCR	Qendra e Grave në Kampin Osterode në veri të Mitrovicë	Ofrimi i mbështetjes për Norwegian Church Aid dhe Agjencisë Kosovare për Avokim dhe Zhvillim për mirëmbajtjen e Qendrës së Gruas në Kampin Osterode në veri të Mitrovicës					✓	UNHCR	-

61	UNICEF	Hulumtim i dhunës ndaj fëmijëve në shkolla në Kosovë	Hetimi i natyrës dhe shtrirjes së dhunës ndaj fëmijëve në shkolla në Kosovë për të kuptuar më mirë problemin për parandalim dhe reagim efektiv	2005	✓				UNICEF	I përfunduar
62	UNICEF	Edukim Jetësor i Bazuar në Shkathtësi në Kosovë	Synimi i këtij projekti është t'i pajisë të rinjtë me aftësi të nevojshme jetësore që do t'u mundësojnë atyre: bëjnë zgjedhje të informuara; t'i aplikojnë në praktikë shkathtësitë personale dhe sociale, të fitojnë dhe aplikojnë shkathtësi të menduarit kritik dhe kreativ; të promovojnë përgjegjësi sociale dhe të kontrollojnë më mirë emocionet e tyre; të promovojnë tolerancë, ndërtim të paqes, pajtim ndëretnik dhe barazi gjinore.	2001-2011	✓	✓			UNICEF	I përfunduar
63	UNICEF dhe MASHT	Programi për alfabetizimin e grave –Dritare Jete	Ky program kishte për qëllim që t'i inkurajojë fëmijët, në veçanti vajzat, dhe komunitetin RAE për t'u kthyer në shkollë pas ndërprerjes së hershme të shkollimit të tyre.	2001-2005			✓	✓	Banka Botërore dhe UNICEF	I përfunduar
64	Komisionari i Lartë i OKB-së për Refugjatë (UNHCR)	Nisma e grave të Kosovës	Lehtësim i mobilizimit të gruas në tërë Kosovën, me fokus të posaçëm në gratë e kthyer, të zhvendosura të prekura nga lufta duke iu ndihmuar atyre dhe familjeve të tyre që të rindërtojnë jetesën e tyre; Ndërgjegjësim i grave lidhur me atë se si të bëhen akterë relevantë të ndryshimit dhe nxitjen e zhvillimit të rrjeteve të gruas.	1999-2001			✓	✓	Byroja për Popullsi, Refugjatë dhe Migrim, Departamenti i Shtetit	I përfunduar

65	UNKT	Dhuna në baza gjinore (DHBGJ)	Programi i dhunës në baza gjinore (DHBGJ) në Kosovë është formuluar nga Task Forca UN KT për DHBGJ për të siguruar zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Kosovës dhe Planit të Veprimit kundër dhunës në familje (SKPVDHF) 2010-2013. Programi i përbashkët UNKT DHBGJ do të mbështesë zbatimin e SKPVDHF duke miratuar një qasje gjithëpërfshirëse dhe përfshirëse e realizuar në tri komuna pilot. Programi parasheh përbushjen e objektivave të saj përmes katër metodave kryesore të intervenimit: a) Parandalimi, b) Mbrojtja, c) Riintegrimi, d) Përkallëzimi	2011 - 2013	✓	✓		✓	Ambasada e Finlandës	Në zbatim e sipër
66	UNMIK	Zyra për Çështje Gjinore	ZÇGJ është themeluar për të monitoruar dispozitat e barazisë gjinore të UNMIK-ut, avancimin e kapacitete të IPVQ-ve për trajtimin e çështjeve gjinore dhe mbështetjen e organizatave të grave dhe gratë nga pakicat për qasje në nivele më të larta të qeverisë dhe autoritetet e UNMIK-ut	2000	✓	✓	✓		-	I përfunduar
67	UNMIK	Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut	Është themeluar me Rregullore të UNMIK nr. 2006/12, 132 si organ i përkohshëm për rishikimin e shkeljeve të pohuara të të drejtave të njeriut nga UNMIK-u dhe dërgimin e konkluzave të PSSP-së.	2006	✓	✓		✓	UNMIK	I përfunduar
68	USAID		QSHBA në koordinim me Ministrinë e Arsimit në kryerjen e vlerësimit gjinor në shkollimin bazik, pas së cilit është hartuar plani gjithëpërfshirës i zbatimit.		✓				QSHBA	-

69	USAID	Programi Hope Fellowship	Qeveria e SHBA-së përmes USAID mbështet gratë përmes rritjes së kapaciteteve të rreth 20 grave lidere të nivelit të lartë në qeverinë lokale, shoqërinë civile dhe sektorin privat përmes programeve të miqësisë dhe të trajnimit për ngritjen e kapaciteteve të tyre.			✓		QSHBA	Në zbatim e sipër
70	USAID	Mbështetje për Komisionet Parlamentare	Qeveria e SHBA-së (QSHBA) përmes USAID gjithashtu mbështetë gratë ligjvënëset duke ofruar asistencë për komisionet parlamentare dhe grupet tjera që punojnë në çështjet e grave në Kuvendin e Kosovës. Kjo ndihmë integron gratë në vendimmarrje dhe ndihmon kuvendin që të bëhet legjislaturë më moderne, demokratike. Në veçanti, asistenca fuqizon ligjvënëset për sajimin e strategjive për rritjen e përfaqësimit e grave në nivelin kombëtar.		✓		✓	QSHBA	-
71	USAID	Pjesëmarrje e grave nga pakicat	Aktivitetet gjithashtu punojnë në nxitjen e pjesëmarrjes së grave nga pakicat në proceset vendimmarrëse, mundësitë e punësimit për gratë dhe ofrimin e mbështetjes për bizneset në pronësi të grave nga pakicat për të rritur punësimin dhe produktivitetin në sektorin fuqisë punëtore publike dhe private.		✓		✓	QSHBA	-

72	USAID	Mbështetje për gratë këshilltare të kuvendeve komunale	Në nivele komunale aktivitete për të ndihmuar qeveritë lokale në Kosovë për rritjen e kapaciteteve të grave këshilltare të kuvendeve komunale dhe përmes ofrimit të mbështetjes për autoritetet lokale dhe gjinore. Mbështetja do të përfshijë 21 (nga 37 komunat e Kosovës) komunat partnere të programit.				✓		QSHBA	-
73	Grupi i Grave Deputete	Grupi i Grave Deputete	GGD mëton të mobilizojë gratë deputete nga të gjitha partitë politike në interesa të përbashkëta. Grupi ka hartuar dhe miratuar planin strategjik 2008.	2008	✓		✓		-	Në zbatim e sipër
74	Gratë në të Zeza dhe Rrjeti i Grupit të Grave Deputete	Koalicioni i Grave për Paqe	Koalicioni i Grave për Paqe është themeluar nga Gratë në të Zeza dhe Rrjeti i Grupit të Grave Deputete të Kosovës në mars 2006. Puna e tij udhëzohet nga parimet në vijim: Paqe e drejtë dhe e qëndrueshme dhe aktivitete për përfshirjen e grave në ndërtimin e paqes si partnere të barabarta duke theksuar faktin se gratë nuk janë viktima, por të mbijetuarat të luftës dhe aktere dinamike në lëvizjet paqësore	2006 -			✓	✓	UN Women	Në zbatim e sipër
75	Qendra e Grave	Shëndeti riprodhues në Kosovë	Projekti do të përfshijë: - Trajnime në zhvillimin dhe menaxhimin e OJQ-ve, të drejtat e njeriut, barazinë gjinore dhe paqe dhe pajtim – Kurse për punën ekipore dhe aktivitete organizative dhe civile, organizuar në bashkëpunim me institucionet lokale, OJQ-të tjera lokale dhe ndërkom-bëtare	2011-2012			✓	✓	Ambasada e Finlandës	Në zbatim e sipër

76	Organizatat	16 ditë të aktivizimit kundër dhunës	Fushatë e vazhdueshme globale e koordinuar nga SGG. Organizimi i fushatave për t'i nxitur njerëzit që të raportojnë dhunën në familje dhe të kërkojnë ndihmë, si dhe të parandalojnë dhunën e ardhshme duke përfshirë burrat. Pas fushatave, institucionet e sigurisë kanë qenë dëshmitare të një shkalle të rritur të dhunës në familje.	2000-2012	✓	✓		✓	UNDP-WSSI EU & UN WOMEN	Në zbatim e sipër
77		Gratë mund t'ia dalin	Projekti do të kontribuojë në pjesëmarrjen aktive në jetën publike dhe politike, përmes trajnimeve dhe fushatave avokuese. Projekti kontribuon më tej në fuqizimin e organizatave të grave dhe avancimin e fokusit për çështje të barazisë gjinore.	2008	✓		✓		Ambasada e Norvegjisë	I përfunduar
78		Ndërgjegjësim kundër trafikimit	Projekti ka për qëllim ngritjen e vetëdijes për trafikimin me njerëz, përmes debateve në radio, që synojnë vajzat dhe djemtë, autoritetet kosovare dhe qytetarët e Kosovës në përgjithësi	2009	✓	✓			Ambasada e Holandës	I përfunduar
79		Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave kushtetuese të grave në Kosovën perëndimore	Rritja e vetëdijesimit për të drejtat kushtetuese/ligjore të grave në Kosovën perëndimore duke përfshirë zonat rurale të Gjakovës, Deçanit, Junikut, Suharekës, dhe Rahovecit. Ky projekt gjithashtu ka monitoruar gjykatat në Kosovën perëndimore për sa i përket zbatimit të ligjit për trashëgiminë.	2011	✓	✓			Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar	I përfunduar

80		Fuqizimi i shtëpive të sig-urta dhe insti-tucioneve tjera që merren me dhunën në familje përmes ngritjes së kapaciteteve të Ndërmjetësimit	Synimi i këtij projekti është që të ngrihen kapacitetet e stafit të Shtëpive të sigurta, Policisë së Kosovës për Komunitetet dhe stafit lokale të Mirëqenies Sociale për mekanizmat e të drejtave të njeriut siç është ndërmjetësimi dhe lehtësimi për të ndihmuar në uljen e dhunës në familje ndaj gruas dhe lehtësimin e integritit të tyre në familje dhe shoqëri.	2012	✓	✓			Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar	Në zba-tim e sipër
81		Sa dimë për shëndetin tonë	Qëllimi i këtij projekti është të ngrihet vetëdija e vajzave dhe grave në komunën e Rahovecit, lidhur me të drejtat e tyre për të jetuar në mënyrë të shëndetshme, për të bërë kontrollime të rreg-ullta, rritjen e vetëdijes së nënave për rëndësinë e dërgimit të vajzave të tyre në rast të proble-meve tek gjinekologu.	2007-2012	✓	✓		✓	Zyra e Swiss Cooperation në Kosovë (SCO-K)	Në zba-tim e sipër
82		Luftimi i dhunës në familje, avok-imi i Qendrës së Integritetit për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve	Synimi i luftimit të dhunës në familje, avokimit të Qendrës së Integritetit për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve në Gjilan është që të "përmirësohet jeta e grave, posaçërisht vikti-mave rurale, aktuale dhe potenciale të dhunës në familje, përmes nxitjes së krijimit të një mjedisi pa dhunë."	2010 - 2011		✓		✓	Zyra e Swiss Cooperation në Kosovë (SCO-K)	I përfun-duar
83		Aufklärungsun-terricht Kosovo	Ky projekt ka për qëllim të ofrojë edukim seksual në zonat (posaçërisht rurale) në Kosovë. Në shumë zona edukimi seksual ende nuk është i pranueshëm; ky pro-jekt ka për qëllim që të hapë dialogun në këtë kuptim. Ky projekt do të ofrojë edukim në qendrat ekzistuese shëndetësore dhe shkollore	2010-2011	✓	✓			Ambasada e Holandës	I përfun-duar

84		Fuqizimi i pjesëmarrjes së gruas në politikë dhe vendimmarrje demokratike	Ky projekt ka për qëllim të trajtojë pabarazinë përmes zbatimit të 2 grupeve të reja të barazisë gjinore në komunën e Gjakovës dhe Pejës. Këto grupe përfshijnë politikane të zgjedhura, gra nga OJQ-të, gratë e cenueshme/të marginalizuara siç janë gratë RAE, gratë serbe dhe mbështetës burra.	2011 - 2012	✓		✓		Ambasada e Holandës	I përfunduar
85		Gratë e shëndosha – shoqëri e shëndoshë	Ky projekt ka për qëllim të ofrojë edukim seksual dhe ngritje të vetëdijes për rreziqet e kancerit në gji dhe mitër, planifikimin e familjes, përdorimin e saktë të kontraktivëve dhe kujdesin shëndetësor tek gjinekologu	2012-2013	✓			✓	Ambasada e Holandës	Në zbatim e sipër
86		Projekti për buxhet të ndjeshëm gjinor	Nxitja e qeverisjes së mirë, veprimeve në nivel komunal në çështje gjinore dhe fuqizimin e procesit të decentralizimit përmes një projekti për gratë për komunën me performancën më të mirë në trajnimin e OSBE/LOGOS (Swiss Development).	2012-2013	✓		✓		Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar	Në zbatim e sipër
87		Edukim bazik shëndetësor për gratë dhe vajzat – E ardhme e shëndetshme për shoqërinë tonë	Synimi i projektit është marrja e njohurisë për edukimin bazik shëndetësor për gratë dhe vajzat posaçërisht për gratë e veja (kryefamiljare), gratë e reja – të shtatzëna dhe vajzat që planifikojnë të martohen	2012-2013	✓	✓			Zyra e Swiss Cooperation në Kosovë (SCO-K)	Në zbatim e sipër
88		Fuqizimi i gruas përmes ndihmës psikologjike dhe ligjore	Ky projekt do të krijojë mundësi për të ofruar shërbime psikologjike dhe emocionale dhe ligjore për së paku 350 gra dhe vajza nga që janë viktima të dhunës në familje në Komunën e Deçanit	2012-2013		✓		✓	Zyra e Swiss Cooperation në Kosovë (SCO-K)	Në zbatim e sipër

Kapitulli 5: Gjetjet dhe konkluzat

Ky raport i misionit paraqet një pasqyrë të përgjithshme të përpjekjeve të organizatave vendore e ndërkombëtare për gratë, paqen dhe sigurinë, së pari duke paraqitur institucionet dhe pastaj listën e nismave të përpiluara në një bazë të të dhënave. Kjo bazë e të dhënave përmban informata për nismat për gratë, paqen dhe sigurinë të realizuara në Kosovë nga viti 1999 deri 2012. Për të bërë një vlerësim të nismave sipas fushës së ndikimit, shtyllat e RKSOKB kanë qenë indikative.

Procedura e grumbullimit të të dhënave përbëhej nga hulumtimi nga zyra, kryesisht me fokus në raportet e vlerësimit dhe monitorimit për zbatimin e RKSOKB 1325, raportet specifike të siguruara nga UN Women dhe raportet tjera që përmbanin informata relevante për aktivitetin e identifikimit. Pasi që janë identifikuar institucionet kryesore dhe përgjegjësia e tyre, institucionet relevante janë intervistuar apo kontaktuar përmes postës elektronike për informata të mëtejme.

Pas identifikimit të nismave për Gratë, Paqen dhe Sigurinë të realizuara në Kosovë nga 1999 deri 2012, është vlerësuar si e nevojshme të vazhdohet me disa analiza përshkruese të të dhënave të grumbulluara. Për të paraqitur një pasqyrë më të qartë të nismave të realizuara, janë kryer analizat në vijim. Fillimisht është analizuar shpërndarja e nismave gjatë viteve 1999 – 2013. Meqë një nga kategoritë kryesore në bazën e të dhënave është shtylla RKSOKB 1325, hapi i radhës i analizës ishte fokusi në shtyllat të cilat i kanë trajtuar nismat. Më pas, është përgatitur një prezantim vjetor në lidhje me numrin e nismave sipas shtyllës së RKSOKB gjatë periudhës 1999 – 2012. Pastaj është ofruar një prezantim i statusit të nismave.

Tabela e parë më poshtë tregon numrin e nismave të realizuara secilin vit, nga 1999-2012.

19 % e nismave të përgjithshme (shih Fig. 1) ose janë realizuar ose ishin duke u realizuar në vitin 2012.



Numri i nismave për çdo vit në periudhën 1999-2012




Figura 1. Numri i nismave sipas viteve.

Duke i vlerësuar nismat përmes shtyllave, është vërejtur se shumica e nismave që janë realizuar në periudhën 1999 – 2012 për zbatimin e RKSOKB 1325 në Kosovë janë përqendruar në shtyllën e parandalimit dhe mbrojtjes (shih Fig. 2).

Zbatimi i RKSOKB 1325 i ndarë sipas shtyllave 1999-2012




Figura 2. Përfaqësimi i përgjithshëm i numrit të nismave që kanë trajtuar shtyllat specifike të RKSOKB 1325

Në anën tjetër, ka më pak nisma që i takonin shtyllave të RKSOKB të pjesëmarrjes dhe ndihmës dhe rimëkëmbjes. Përveç kësaj, shtylla e mbrojtjes është trajtuar në një numër më të madh të nismave gjatë 4 viteve të fundit (shih Figurën 3)

Numri i nismave sipas shtyllës së RKSOKB 1325 gjatë periudhës 2000 - 2012




Figure 3. Përfaqësimi vjetor i nismave sipas shtyllës së RKSOKB 1325

Bazuar në të dhënat tona 62% e nismave janë veçse të përfunduara, gjersa 38% të nismave janë në vazhdim e sipër (shih Figurën 4).

Statusi i nismës




Figure 4. Statusi i nismës

Për të përmbyllur, duhet të bëhet më shumë punë në shtyllën e ndihmë dhe rimëkëmbjes në Kosovën e pas konfliktit, me fokus të veçantë në drejtësinë tranzicionale me ndjeshmëri gjinore dhe reparacion të të mbijetuarve të dhunës seksuale të lidhur me konfliktin në Kosovë me referencë në RKSOKB 1820, 1888 dhe 1889. Gjithashtu, duhet të bëhet më shumë punë në përmbushjen e obligimeve në kuadër të shtyllës së pjesëmarrjes që synon qëndrueshmërinë e pjesëmarrjes kuptimplotë dhe përfaqësimit që duhet të synojë krijim e mjedisit që mundëson për pjesëmarrje ekonomike, politike dhe sociale të grave. Nismat e organizatave vendore e ndërkombëtare duhet të synojnë krijimin e mjedisëve që synojnë

pjesëmarrjen e tyre ekonomike, politike dhe sociale. Rrjedhimisht, ekziston një nevojë e madhe për nisma të integritit ekonomik për gratë, si dhe gratë kryefamiljare.

Kjo bazë e të dhënave paraqet një listë gjithëpërfshirëse të nismave të identifikuara të kontaktuar. Ajo mund të përdoret për t'i koordinuar nismat e ardhshme për t'i shmangur duplikimet e aktiviteteve dhe për të specializuar fokusin e secilit aktivitet. Së fundi, baza e të dhënave mund të jetë më përfituese për të gjithë përdoruesit nëse azhurnohet rregullisht. Prandaj, kjo bazë e të dhënave duhet të merret në pronësi të një institucioni të caktuar që merr përgjegjësinë për shpërndarjen dhe azhurnimin e rregullt të saj.

Referencat

Zyra Civile Ndërkombëtare – shkurt 2008 - shtator 2012. Nxjerrë më 28.11.2012 nga: <http://www.ico-kos.org/index.php?id=8>

Raporti i brendshëm i UNIFEM për donatorë për Qeverinë Austriake lidhur me zbatimin e projektit “Gratë ndërtojnë paqe dhe siguri njerëzore në Ballkanin Perëndimor

Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës (2007). Monitorimi i zbatimit të Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1325 në Kosovë

Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës (2009). Monitorimi i zbatimit të Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1325 në Kosovë

Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës (2011). 1325 Fakte dhe fabula.

S. Maquire. (2008). Zbatimi i Rezolutës së Këshillit të Sigurimit 1325 në Kosovë – Mësimet e nxjerra për të informuar EULEX-in në Kosovë

Grupi koordinues për siguri dhe çështje gjinore “Së bashku drejt sigurisë së përgjegjshme gjinore”. UNIFEM: Pozita e gruas në Kosovë

Stickings. M., (2011). Rrjetëzimi dhe rrjeti – ndërtimi i mbështetjes për gratë, paqen dhe sigurinë. Përvojat e UN Women nga Ballkani Perëndimor. UN Women, Valeur, s.r.o.

Komisionari i Lartë i OKB-së për Refugjatë, Njësia për Vlerësimin dhe Analizën e Politikave. (2002). Nisma e Grave të Kosovës.

Konferenca e dytë vjetore e Koalicionit të Grave për Paqe (2007). Përmes solidaritetit të grave për një paqe të drejtë
Misioni i Administratës së Përkohshme të OKB-së në Kosovë. Gazeta zyrtare. Nxjerrë më 18 mars: http://www.unmikonline.org/regulations/index_reg_2004.htm

Misioni i OSBE-së në Kosovë & UNMIK-u. Departamenti për të Drejtat e Njeriut dhe Njësia për Sundim të Ligjit. Raport për zbatimin e ligjeve të Kuvendit të Kosovës

Kuvendi i Republikës së Kosovës. Nxjerrë më 21 mars: <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=2,1>

Van der Leest Kristin (2010) Gjinia dhe Siguria: Identifikimi i akterëve të sektorit të sigurisë në Kosovë dhe politikave, praktikave dhe strategjive që kanë të bëjnë me çështje gjinore, përgatitur për SGCG

Shtojcat

Shtojca 1: RKSOKB 1325

Rezoluta e Këshillit të Sigurimit 1325

Këshilli i Sigurimit,

Duke rikujtuar rezolutat e tij: 1261 (1999) e 25 gushtit 1999, 1265 (1999) e 17 shtatorit 1999, 1296 (2000) e 19 prillit 2000 dhe 1314 (2000) e 11 gushtit 2000, si dhe deklaratat përkatëse të Presidentit të tij; duke rikujtuar gjithashtu deklaratën për shtyp të Presidentit me rastin e Ditës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Grave dhe të Paqes Ndërkombëtare (Dita Ndërkombëtare e Grave) më 8 Mars 2000 (SC/6816),

Duke rikujtuar gjithashtu zotimet e deklaratës së Pekinit dhe të Platformës për Veprim (A/52/231), si edhe zotimet e përfshira në dokumentin përfundimtar të Sesionit të Veçantë të njëzet e tretë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, të titulluar "Gratë 2000: Barazia Gjinore, Zhvillimi dhe Paqja për Shekullin e Njëzetë e Një" (A/S-23/10/Rev.1), në veçanti ato që kanë të bëjnë me gratë dhe konfliktin e armatosur,

Duke marrë në konsideratë qëllimet dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe përgjegjësinë kryesore të Këshillit të Sigurimit, sipas Kartës, për mbështetjen e paqes ndërkombëtare dhe të sigurisë,

Duke shprehur shqetësimin se civilët, veçanërisht gratë dhe fëmijët, konsiderohen si shumica dërrmuese e të prekurve nga konflikti i armatosur, përfshirë këtu si refugjatët ashtu edhe të shpërngulurit brenda vendit,; dhe faktin që gjithnjë e më tepër ata janë nën shënjestrën e luftëtarëve dhe të elementëve të armatosur, si dhe duke marrë parasysh pasojën e këtij ndikimi për një paqe të qëndrueshme dhe për pajtim,

Duke ripohuar rolin e rëndësishëm të grave në parandalimin, zgjidhjen e konflikteve dhe ndërtimin e paqes, si dhe duke theksuar rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre të barabartë dhe përfshirjes së plotë në të gjitha përpjekjet për ruajtjen dhe çuarjen përpara të paqes dhe të sigurisë, si dhe nevojën për të rritur rolin e tyre në proceset vendimmarrëse, lidhur me parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve,

Duke ripohuar gjithashtu nevojën për të zbatuar plotësisht ligjet ndërkombëtare humanitare dhe ato të të drejtave të njeriut, të cilat mbrojnë të drejtat e grave dhe të vajzave gjatë dhe pas konflikteve,

Duke theksuar nevojën që të gjitha palët të bëjnë të mundur që programet për pastrimin nga minat dhe ato për ndërgjegjësimin për praninë e minave, të marrin parasysh nevojat e veçanta të grave,

Duke pasur parasysh nevojën urgjente për të futur perspektivën gjinore në veprimet paqeruajtëse, dhe duke vënë theksin lidhur me këtë në Deklaratën Windhoek dhe në Planin e Namibisë për Veprim në Futjen e Perspektivës Gjinore në Veprimet Shumëpërmasëshe për Mbështetjen e Paqes (S/2000/693), Duke njohur gjithashtu rëndësinë e këshillës së dhënë për shtyp nga Presidenti i tij më 8 mars 2000 për trajnimin e specializuar të të gjithë personelit paqeruajtës për mbrojtjen, nevojat e veçanta dhe të drejtat e grave dhe të fëmijëve në situatat e konfliktit,

Duke ditur se po të kuptohet ndikimi që konflikti i armatosur ka tek gratë dhe vajzat, atëherë kjo do të nxisë marrëveshjet institucionale që të sigurojnë mbrojtjen e grave dhe të vajzave si dhe pjesëmarrjen e tyre të plotë në procesin e paqes, të cilat

nga ana e tyre mund të kontribuojnë dukshëm në ruajtjen e paqes ndërkombëtare dhe të sigurimit,

Duke vënë re nevojën për të konsoliduar të dhënat për ndikimin e konfliktit të armatosur tek gratë dhe vajzat:

1. Nxit Shtetet Anëtare, që të sigurojnë një përfaqësim më të madh të grave në të gjitha nivelet vendimmarrëse në institucionet kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare dhe në mekanizmat për parandalimin, drejtimin dhe zgjidhjen e konfliktit;

2. Inkurajon Sekretarin e Përgjithshëm që të zbatojë planin e tij strategjik të veprimit (A/49/587), duke kërkuar një rritje të pjesëmarrjes së grave në nivelet vendimmarrëse për zgjidhjen e konfliktit dhe proceset e paqes;

3. Nxit Sekretarin e Përgjithshëm që të caktojë më shumë gra si përfaqësuese të posaçme dhe të kërkojë që të kryejnë punë të mira në emrin e tij, dhe lidhur me këtë u bën thirrje Shteteve Anëtare që të sigurojnë kandidatë për Sekretarin e Përgjithshëm, për përfshirje në një listë qendrore, e cila ripërtërihet rregullisht;

4. Nxit më tej Sekretarin e përgjithshëm, që të përpiqet që të zgjerojë rolin dhe kontributin e grave në veprimet e kryera në bazë dhe në mënyrë të veçantë mes vëzhguesve ushtarakë, policëve civilë personelit të të drejtave të njeriut dhe atyre humanitare;

5. Shpreh gatishmërinë e tij për të përfshirë perspektivën gjinore në veprimet paqeruajtëse dhe nxit Sekretarin e përgjithshëm që të sigurojë, që atje ku është e mundur, veprimet në bazë të përfshijnë edhe një element gjinor;

6. I kërkon Sekretarit të Përgjithshëm që t'u sigurojë Shteteve Anëtare udhëzues trajnimi dhe materiale për mbrojtjen, të drejtat dhe nevojat e veçanta të grave, si edhe për rëndësinë e përfshirjes së grave në të gjitha masat paqeruajtëse dhe paqendërtuese, fton Shtetet Anëtare që të përfshijnë të gjithë këto elemente si dhe trajnime për ndërgjegjësimin për HIV/AIDS, në programet e tyre kombëtare të trajnimit për personelin policor civil dhe ushtarak, në përgatitje

për t'u punësuar. Dhe i kërkon më tej Sekretarit të Përgjithshëm që të sigurojë që edhe personeli civil i veprimeve paqeruajtëse të marrë një trajnim të ngjashëm;

7. Nxit Shtetet Anëtare që të rrisin mbështetjen e tyre financiare vullnetare, teknike dhe logjistike për trajnime me karakter gjinor, përfshirë edhe ato të ndërmarra nga fondet dhe programet përkatëse, mes tjerash, Fondi i Kombeve të Bashkuara për Gratë dhe Fondi i Kombeve të Bashkuara për fëmijët, dhe nga Zyra e Komisionarit të Lartë për refugjatët dhe nga organizma të tjerë përkatës;

8. U bën thirrje të gjithë organizmave të përfshirë, që kur zhvillojnë bisedime dhe zbatojnë marrëveshjet për paqen, të miratojnë një perspektivë gjinore, duke përfshirë, mes tjerash:

(a) Nevojat e veçanta të grave dhe vajzave gjatë riatdhesimit dhe për riaftësimin, riintegrimin dhe rindërtimin pas konfliktit;

(b) masa që mbështesin nismat lokale të grave për paqen dhe proceset vendase për zgjidhjen e konfliktit, dhe që përfshin gratë në të gjitha mekanizmat zbatues të marrëveshjeve për paqen;

(c) Masa që sigurojnë mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të vajzave dhe grave, veçanërisht me ato që lidhen me kushtetutën, sistemin zgjedhor, policinë dhe gjykatësit;

9. U bën thirrje të gjitha palëve në konfliktin e armatosur që të respektojnë plotësisht ligjin ndërkombëtar, të zbatueshëm për të drejtat dhe mbrojtjen e grave dhe të vajzave, duke i trajtuar ato veçanërisht si civilë, si dhe detyrimet e zbatueshme për ta, nën Konventën e Gjenevës të vitit 1949 dhe të Protokolleve Shtesë të vitit 1977, Konventa e Refugjatit e vitit 1951 dhe për më tepër Protokollin e vitit 1967, Konventën për eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit kundër Grave, të vitit 1979 si dhe Protokollin fakultativ të vitit 1999 dhe Konventën e Kombeve të bashkuara për të Drejtat e Fëmijës të vitit 1989 dhe dy Protokolle Fakultative të 25

majit 200 dhe të mbajë në mendje kushtet përkatëse të statutit të Romës të Gjykatës Ndërkombëtar të krimeve;

10. U bën thirrje të gjitha palëve të përfshira në konfliktin e armatosur që të marrin masa të veçanta për të mbrojtur gratë dhe vajzat nga dhuna me bazë gjinore, veçanërisht nga përdhunimi dhe format e tjera të abuzimit seksual, dhe të gjitha llojeve të tjera të dhunës në situatën e një konflikti të armatosur;

11. Thekson përgjegjësinë e të gjitha Shteteve që t'u japin fund pandëshkueshmërisë dhe të ndëshkojnë ata që janë përgjegjës për gjenocidin, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës, përfshirë këtu edhe ato që janë të lidhura me dhunën seksuale dhe dhunë të llojeve të tjera mbi gratë dhe vajzat dhe lidhur me këtë vë theksin në nevojën për të përjashtuar këto krime, atje ku është e mundur nga kushtet për amnisti;

12. Iu bënë thirrje të gjitha palëve të konfliktit të armatosur që të respektojnë civilët si dhe kampet dhe ngulimet e refugjatëve me karakter humanitar dhe të marrin parasysh nevojat e veçanta të grave dhe vajzave, të përfshira në synimet e tyre, dhe rikujton rezolutat e tij 1208 (1998) të 19 Nëntorit 1998 dhe 1296 (2000) të 19 prillit 2000;

13. Inkurajon të gjitha ata që përfshihen në planin për çarmatim, çmobilizim dhe riintegrim që të konsiderojë nevojat e ndryshme të ish-luftëtarëve meshkuj dhe femra dhe të marrë në konsideratë nevojat e familjarëve të tyre;

14. Ripohon gatishmërinë e tij, kur masat janë marrë nën Artikullin 41 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, që të japë vlerësimin e tyre për ndikimin e tyre të mundshme mbi popullsinë civile, duke mbajtur parasysh nevojat e veçanta të grave dhe vajzave, në mënyrë që të kihen parasysh përjashtime humanitare atje ku duhet,

15. Shpreh gatishmërinë e tij, për të siguruar që misionet e Këshillit të Sigurimit të marrin parasysh vlerësimet gjinore dhe të drejtat e grave, të marra prej konsultimeve me grupet lokale dhe ndërkombëtare të grave;

16. Fton Sekretarin e Përgjithshëm që të përfundojë një studim mbi ndikimin e konfliktit të armatosur mbi gratë dhe vajzat, rolin e grave në ndërtimin e paqes dhe përmasat gjinore të proceseve të paqes dhe të zgjidhjes së konfliktit, dhe fton më tej atë që t'i paraqesë një raport Këshillit të Sigurimit mbi rezultatet e këtij studimi dhe ta vërë atë në dispozicion të të gjitha Shteteve Anëtare dhe të Kombeve të Bashkuara;

17. I kërkon Sekretarit të Përgjithshëm, atje ku është e përshtatshme, që të përfshijë në raportin e tij për Këshillin e Sigurimit, përparimin në drejtimet bazë gjinore në të gjitha misionet paqeruajtëse dhe në të gjitha aspektet e tjera që kanë të bëjnë me gratë dhe vajzat.

18. Vendos që të vazhdojë të merret aktivisht me këtë çështje.

Shtojca 2: RKSOKB 1820

Rezoluta e Këshillit të Sigurimit 1820 (2008)

Këshilli i Sigurimit,

Duke riafirmuar zotimin e tij për vazhdimin dhe zbatimin e plotë të rezolutës 1325 (2000), 1612 (2005) dhe 1674 (2006) dhe duke rikujtuar Deklaratat përkatëse të Presidentit me datën 31 Tetor 2001 (Këshilli i Sigurimit/PRST/2001/31), 31 Tetor 2002 (Këshilli i Sigurimit/PRST/2002/32), 28 Tetor 2004 (Këshilli i Sigurimit/PRST/2004/40), 27 Tetor 2005 (Këshilli i Sigurimit/PRST/2005/52), Nëntor 2006 (Këshilli i Sigurimit/PRST/2006/42), 7 Mars 2007 (Këshilli i Sigurimit/PRST/2007/5), dhe 24 Tetor 2007 (Këshilli i Sigurimit/PRST/2007/40);

Udhëhequr nga qëllimet dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara, Duke riafirmuar zgjidhjen e shprehur në Dokumentin Botëror të Samimit 2005 për të eliminuar të gjitha format e dhunës kundër grave dhe vajzave, duke përfshirë dhe duke i dhënë fund mosndëshkimit dhe duke siguruar mbrojtjen e civilëve, në veçanti grave dhe vajzave, gjatë dhe pas konflikteve të armatosura, Shtetet kanë marrë përsipër këto detyrime sipas ligjeve ndërkombëtare humanitare dhe ndërkombëtare të ligjit për të drejtat e njeriut;

Duke rikujtuar gjithashtu zotimet e deklaratës së Pekinit dhe të Platformës për Veprim (A/52/231), si edhe zotimet e përfshira në dokumentin përfundimtar të Sesionit të Veçantë të njëzet e tretë të Asamblesë së Përgjithshme të

Kombeve të Bashkuara, të titulluar "Gratë 2000: Barazia Gjinore, Zhvillimi dhe Paqja për Shekullin e Njëzetë e Një" (A/S-23/10/Rev.1), në veçanti ato që kanë të bëjnë me gratë dhe konfliktin e armatosur;

Duke riafirmuar dhe detyrimet e Shteteve Palë të Konventës lidhur me Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, Protokolli Fakultativ, Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve dhe protokollet opsionale të kësaj Konvente, dhe duke i bërë thirrje shteteve të cilat nuk e kanë bërë ende të konsiderojnë ratifikimin ose pranimin e tyre,

Duke vënë në dukje që shumica e civilëve që janë dëmtuar gjatë konfliktit të armatosur; që gratë dhe vajzat janë veçanërisht të synuara nga përdorimi i dhunës seksuale, kjo taktikë e luftës gjithashtu përdoret edhe për të fyer, dominuar, frikësuar, shpërndarë dhe / ose zhvendosë me dhunë anëtarët civilë të një komuniteti apo grupi etnikë; dhe se dhuna seksuale në disa raste vazhdon edhe pas ndalimit të konflikteve;

Duke rikujtuar dënimin me të fuqishëm të dhunës seksuale si dhe formave të tjera të dhunës së kryer kundër civilëve në konfliktet e armatosura, veçanërisht kundër grave dhe fëmijëve;

Duke përsëritur shqetësimin e thellë, megjithëse dënimet e përsëritura të

dhunës ndaj grave dhe fëmijëve në situata të konfliktit të armatosur, duke përfshirë edhe dhunën seksuale në situata të konfliktit të armatosur, dhe pavarësisht nga thirrjet e drejtuara ndaj të gjitha palët në konfliktin e armatosur për ndërprerjen e akteve të tilla me efekt të menjëhershëm, këto akte vazhdojnë të ndodhin, në disa raste madje edhe në mënyra sistematike, duke i ngritur nivelet e këtyre akteve në një shkallë brutale,

Duke rikujtuar përfshirjen e veprave të dhunës seksuale në Statutin e Romës të Gjykatës Kriminale Ndërkombëtare dhe statutet përkatëse ndërkombëtare të tribunaleve Kriminale Ndërkombëtare,

Duke riafirmuar rolin e rëndësishëm të grave në ndalimin dhe zgjidhjen e konflikteve si dhe në krijimin e paqes, dhe duke theksuar rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre të barabartë dhe integrimin e plotë në të gjitha përpjekjet për ruajtjen dhe promovimin e paqes dhe sigurisë, si dhe nevojën për të rritur rolin e tyre për vetëvendim në lidhje me parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve,

Thellësisht të brengosur edhe me pengesat dhe sfidat e vazhdueshme lidhur me pjesëmarrjen dhe

përfshirjen e plotë të grave në parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve si rezultat i dhunës, kërcënimeve dhe diskriminimeve, gjë që e zvogëlon kapacitetin dhe legjitimitetin e grave për të marrë pjesë në jetën publike të pas-konfliktit, dhe duke pranuar ndikimin negativ që kjo ka për paqe të vazhdueshme, për siguri dhe pajtim, si dhe në ndërtimin e paqes pas-konfliktit,

Duke ditur se Shtetet e mbajnë përgjegjësinë kryesore për të respektuar dhe për të siguruar të drejtat njerëzore të qytetarëve të tyre, si dhe të gjithë individëve brenda territoreve të tyre siç parashihet me ligjin përkatës ndërkombëtar,

Duke riafirmuar se palët e konfliktit të armatosur mbajnë përgjegjësinë kryesore për të marrë të gjithë hapat e mundshme për të siguruar mbrojtjen e civilëve të keqtrajtuar,

Duke mirëpritur koordinimin dhe përpjekjet e vazhdueshme në kuadër të sistemit të Kombeve të Bashkuara, të përkrahura nga iniciativa e ndër-agjencisë "Veprimi i Kombeve të Bashkuara kundër Dhunës Seksuale në Konflikt," për të krijuar vetëdije lidhur me dhunën seksuale në konfliktet e armatosura si dhe situatat gjatë dhe pas konfliktit

dhe, përfundimisht, për t'i vënë fund veprave të tilla,

1. Thekson se dhuna seksuale, kur përdoret si taktikë e luftës me qëllim që të synojë civilët apo si pjesë e një sulmi të gjerë ose sistematik kundër popullsisë civile, në mënyrë të konsiderueshme mund të përkeqësojnë situatën e dhunës në konfliktin e armatosur dhe mund të pengojnë rivendosjen e sigurisë dhe paqes ndërkombëtare, të afirmuar që hapat efektive për të parandaluar dhe për t'iu përgjigjur akteve të tilla të dhunës seksuale mund të kontribuojnë jashtëzakonisht në ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, dhe duke shprehur gatishmërinë e saj, në raste kur konsiderohen situatat në agjendën e Këshillit, për të miratuar hapat e duhur për të adresuar ndalimin dhe përhapjen e gjerë ose sistematike të dhunës seksuale;

2. Kërkon nga të gjitha palët në konfliktin e armatosur ndërprerje të menjëhershme dhe të plotë të të gjitha akteve të dhunës seksuale kundër civilëve me efekt të menjëhershëm;

3. Kërkon që të gjitha palët e konfliktit të armatosur t'i marrin masat e duhura për t'i mbrojtur civilët, duke përfshirë gratë dhe vajzat, nga të gjitha format e dhunës seksuale, të cilat mund të përfshijnë, mes tjerash, zbatimin e masave të përshtatshme ushtarake

disiplinore dhe duke përmbajtur parimin e përgjegjësisë komanduese, trajnimin e trupave mbi ndalimin kategorik të të gjitha formave të dhunës seksuale kundër civilëve, të maskoj mitet që përkrahin dhunën seksuale, verifikimin e forcave të armatosura dhe të sigurimit që të marrin parasysh veprimet e kaluara të dhunimit dhe formave tjera të dhunës seksuale, si dhe evakuimin e grave dhe fëmijëve nën kërcënimin e menjëhershme të sigurisë nga dhuna seksuale, dhe duke kërkuar nga Sekretari i Përgjithshëm, kur është e përshtatshme, të inkurajojë dialogun për të adresuar këtë çështje në kontekstin e diskutimeve të gjëra të zgjidhjes së konfliktit në mes të zyrtarëve të përshtatshëm të Kombeve të Bashkuara dhe palëve në konflikt, duke marrë parasysh, ndër të tjera, opinionet e shprehura nga gratë e komuniteteve lokale;

4. Thekson se dhunimi dhe format e tjera të dhunës seksuale mund të definojnë një krim të luftës, një krim kundër njerëzimit, apo një akt konstitutiv të gjenocidit, duke theksuar nevojën për përjashtimin e krimeve të dhunës seksuale nga dispozitat e amnistisë në kontekstin e proceseve të zgjidhjes së konfliktit, dhe duke u bërë thirrje Shteteve Anëtare të plotësojnë detyrimet e tyre për ndjekjen penale të personave përgjegjës për akte të tilla, për të siguruar se të gjitha viktimat e dhunës seksuale,

veçanërisht gratë dhe vajzat, kanë mbrojtje të barabarta para ligjit si dhe qasje të barabarta në drejtësi, dhe duke theksuar rëndësinë e përfundimit të mosndëshkimit të akteve të këtilla si pjesë e një qasje gjithëpërfshirëse për të siguruar një paqe të qëndrueshme, drejtësinë, të vërtetën, dhe pajtimin kombëtar;

5. Afirmon synimin e vazhdueshëm lidhur me zhvillimin dhe rinovimin e sanksioneve të regjimit të shtetit të Caktuar, për të marrë në konsideratë përshtatshmërinë e masave kundër partive nxitëse të situatave të konfliktit të armatosur të të cilët u angazhuan në dhunime dhe format e tjera të dhunës seksuale kundër grave dhe vajzave në situata të konfliktit të armatosur;

6. Kërkon nga Sekretari i Përgjithshëm, në konsultim me Këshillin e Sigurimit, Komisionin e Posaçëm për Operacionet Paqeruajtëse, si dhe Grupin Punues dhe Shtetit përkatës, sipas rastit, që të hartojnë dhe zbatojnë programe të përshtatshme trajnimi për të gjithë stafin paqeruajtës dhe humanitar të vendosur nga Kombet e Bashkuara në kuadrin e misioneve të mandatuar nga Këshilli për parandalim, njohjen dhe mundësin për t'iu përgjigjur dhunës seksuale dhe formave të tjera të dhunës kundër civilëve në mënyrë më efektive;

7. Kërkojnë nga Sekretari i Përgjithshëm që të vazhdojnë dhe forcojnë përpjekjet e zbatimit të tolerancës zero ndaj shfrytëzimit seksual dhe abuzimit në operacionet paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara; dhe kërkon nga trupat dhe policia e vendeve kontribuuese që të ndërmarrin veprime të përshtatshme parandaluese, duke trajnuar vetëdijen e tyre para-dhe në teatër, si dhe duke marrë masa të tjera për të siguruar përgjegjshmëri të plotë në raste të sjelljeve keqpërdoruese nga personeli i tyre;

8. Inkurajon vendet kontribuuese të trupave dhe të policisë, në konsultim me Sekretarin i Përgjithshëm, të marrin hapa të duhura për të rritur ndërgjegjësimin dhe reagimin e personelit të tyre në operacionet paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara për të mbrojtur civilët, duke përfshirë gratë dhe fëmijët, dhe për të parandaluar dhunën seksuale ndaj grave dhe vajzave si në konflikt ashtu edhe në situatat pas konfliktit, duke përfshirë vendosjen e një përqindje më të lartë të paqeruajtësve ose të policisë së gjinisë femërore;

9. Kërkon Sekretarit i Përgjithshëm për të zhvilluar udhëzime dhe strategji efektive për të rritur aftësinë e operacioneve paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara, në përputhje me mandatet e tyre, për të mbrojtur

civilët, duke përfshirë gratë dhe vajzat, nga të gjitha format e dhunës seksuale dhe që në mënyrë sistematike të përfshijë në raportet e tij me shkrim kushtuar Këshillit vëzhgues lidhur me mbrojtjen e grave dhe vajzave në situata të konfliktit dhe të japë rekomandime në këtë drejtim;

10. Kërkon Sekretarit i Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara dhe agjencive përkatëse, mes tjerash, ndërmjet konsultimit me organizatat e grave si dhe grupeve të udhëhequra nga gratë, krijimin e mekanizmave efikase për të siguruar mbrojtje nga dhuna, duke përfshirë në veçanti dhunën seksuale të grave dhe vajzave brenda dhe përreth kampeve të refugjatëve dhe personave të zhvendosur, si dhe ballafaqimin me çështjet e çarmatimit, çmobilizimit, dhe proceset e ri-integrimit, që të ndihmoj përpjekjet e Kombeve të Bashkuara për të reformuar sektorin e drejtësisë dhe atë të sigurisë;

11. Thekson rolin e rëndësishëm që Komisioni i Paqes mund të luajë duke përfshirë sugjerimet dhe rekomandimet e çështjeve pas

konfliktit, kur është e përshtatshme, duke ofruar mënyra për të trajtuar aktet e dhunës seksuale të kryera gjatë dhe pas konfliktit të armatosur, dhe për të siguruar këshillim dhe përfaqësim efektiv të shoqërive civile të grave, si pjesë përbërëse të qëndrimit të tij ndaj çështjeve gjinore;

12. Inkurajon Sekretarin e Përgjithshëm dhe të dërguarit të tij specialë që të ftojnë gratë që të marrin pjesë në diskutimet përkatëse për parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve, ruajtjen e paqes dhe sigurisë, si dhe zhvillimin e paqes pas konfliktit, dhe të inkurajojnë të gjitha palët përkatëse që të ofrojnë një pjesëmarrje të barabartë dhe të plotë të grave në nivelet e vendim-marrjes;

13. Inkurajon të gjitha palët e interesuara, duke përfshirë Shtetet Anëtare, grupet e Kombeve të Bashkuara dhe institucionet financiare, të mbështesin zhvillimin dhe forcimin e kapaciteteve të institucioneve kombëtare, në veçanti atyre gjyqësore dhe të sistemeve shëndetësore, si dhe të rrjeteve lokale

të shoqërisë civile në mënyrë që të sigurojnë ndihmë të qëndrueshme për viktimat e dhunës seksuale si në konfliktin e armatosur ashtu edhe në situatat e pas konfliktit;

14. Duke i bërë thirrje organeve përkatëse rajonale dhe nën-rajonale të konsiderojnë zhvillimin dhe zbatimin e rregullave dhe aktiviteteve në dobi të grave dhe vajzave të lënduara nga dhuna seksuale në konflikt të armatosur;

15. Si dhe kërkon nga Sekretari i Përgjithshëm të paraqesë një raport para Këshillit deri me 30 Qershor 2009 mbi zbatimin e kësaj rezolute në kontekst të situatave të cilat janë në agjendën e Këshillit, duke shfrytëzuar informacionet nga burimet në dispozicion të Kombeve të Bashkuara, ekipet e vendit, anëtarëve të operacioneve paqeruajtëse, dhe duke u bazuar në analiza të tjera të personelit të Kombeve të Bashkuara, të cilat do të përfshijnë, mes tjerash, informacione lidhur me situatat e konfliktit të armatosur, në të cilin dhuna seksuale është një akt i përhapur gjerësisht ose akt i përdorur në mënyrë sistematike kundër civilëve; të paraqesë një analizë lidhur me trendet e dhunës

seksuale në situata të konfliktit të armatosur; të propozojë strategjitë për të minimizuar ndjeshmërinë e grave dhe vajzave të një dhune të tillë; standardet për mbajtjen e progresit për parandalimin dhe trajtimin e dhunës seksuale; të paraqesë të dhëna të përshtatshme nga partnerët implementues të Kombeve të Bashkuara në këtë fushë; të zbulojë të dhëna mbi planet për mbledhjen e shpejtë, objektive, të saktë, dhe informacione të besueshme për përdorimin e dhunës seksuale në situata të konfliktit të armatosur, duke përfshirë përmirësimin e koordinimit të aktiviteteve të Kombeve të Bashkuara si në terren ashtu edhe në Zyrën Qendrore; dhe të paraqesë informata mbi veprimet e ndërmarra nga palët në konflikt të armatosur për të zbatuar përgjegjësitë e tyre siç përshkruhet në këtë rezolutë, në veçanti lidhur me ndalimin e plotë të të gjitha akteve të dhunës seksuale dhe në marrjen e masave të përshtatshme për të mbrojtur gratë dhe vajzat nga të gjitha format e dhunës seksuale;

16. Vendos që të vazhdojë të merret aktivisht me këtë çështje.

Shtojca 3: RKSOKB 1888

Rezoluta e Këshillit të Sigurimit 1888

“Këshilli i Sigurimit,

“Duke riafirmuar zotimin e tij për zbatimin e vazhdueshëm dhe të plotë të Rezolutave 1325 (2000), 1612 (2005), 1674 (2006), 1820 (2008) dhe 1882 (2009) dhe dhe deklaratave relevante të Presidentit të saj,

“Duke mirëpritur raportin e Sekretarit të Përgjithshëm të 16 korrikut 2009 (S/2009/362), por duke mbetur thellësisht të shqetësuar për mungesën e progresit për çështjen e dhunës seksuale në situatat e konfliktit të armatosur në veçanti kundër grave dhe fëmijëve, veçanërisht ndaj vajzave, dhe duke theksuar siç është e dokumentuar në raportin e Sekretarit të Përgjithshëm se dhuna seksuale ndodhë në konfliktet e armatosura në tërë botën,

“Duke përsëritur shqetësimin e thellë se përkundër dënimit të vazhdueshëm të dhunës ndaj gruas dhe fëmijëve që përfshin të gjitha format e dhunës seksuale në situata të konfliktit të armatosur, dhe përkundër faktit që i bën thirrje të gjitha palëve në konflikt të armatosur për ndërprerjen e këtyre akteve me efekt të menjëhershëm, aktet e tilla vazhdojnë të ndodhin dhe në disa situata janë bërë sistematike dhe të përhapura,

“Duke rikujtuar zotimet e deklaratës së Pekinit dhe të Platformës për Veprim (A/52/231), si edhe zotimet e përfshira në dokumentin përfundimtar të Sesionit të Veçantë të njëzetetretë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, të titulluar “Gratë 2000: Barazia Gjinore, Zhvillimi dhe Paqja për Shekullin e Njëzetë e Një” (A/S-23/10/Rev.1), në veçanti ato që kanë të bëjnë me gratë dhe konfliktin e armatosur,

“Duke riafirmuar dhe detyrimet e Shteteve Palë të Konventës lidhur me Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, Protokolli Fakultativ, Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve dhe protokollat opsionale të kësaj Konvente, dhe duke i bërë thirrje shteteve të cilat nuk e kanë bërë ende të konsiderojnë ratifikimin ose pranimin e tyre,

“Duke rikujtuar se e drejta ndërkombëtare humanitare ofron mbështetje të përgjithshme për gratë dhe fëmijët si pjesë e popullatës civile gjatë konflikteve të armatosura dhe mbrojtje speciale për shkak të faktit që ato mund të vendosen në rrezik të posaçëm,

“Duke rikujtuar përgjegjësinë e Shteteve për t’i dhënë fund pandëshkueshmërisë dhe të ndëshkuar ata që janë përgjegjës për gjenocidin, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës dhe krimet tjera të rënda të kryera ndaj civilëve, dhe në këtë kontekst me shqetësim se vetëm një numër i kufizuar i kryerësve janë sjellë para drejtësisë, duke pranuar se në situata të konfliktit dhe pas konfliktit sistemet vendore të drejtësisë mund të jenë dobësuar në masë të konsiderueshme;

“Duke ripohuar se përfundimi i pandëshkueshmërisë është esencial nëse një shoqëri në konflikt apo që rimëkëmbet nga konflikti do t’i zgjidhni abuzimet e kaluara të kryera ndaj civilëve të prekur nga konflikti i armatosur dhe për të parandaluar abuzimet e tilla të ardhshme, duke tërhequr vëmendje në spektrin e plotë të mekanizmave të drejtësisë dhe pajtimit që do të merren parasysh, duke përfshirë gjykatat dhe tribunalet vendore, ndërkombëtare dhe të “përziera” penale dhe komisionet për të vërtetën dhe pajtimin, si dhe duke theksuar se mekanizmat e tillë

mund të promovojnë jo vetëm përgjegjësinë individuale për krimet e rënda por edhe paqen, të vërtetën, pajtimin dhe të drejtat e viktimave,

“Duke rikujtuar përfshirjen e një spektri të veprave të dhunës seksuale në Statutin e Romës të Gjykatës Ndërkombëtare Penale dhe statuteve të tribunaleve ndërkombëtare penale ad hoc,

“Duke theksuar nevojën për të gjitha shtetet anëtare dhe palët joshtetërore në konflikte të jenë në përputhje me obligimet e tyre sipas së drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë ndalimin e të gjitha formave të dhunës seksuale,

“Duke pranuar nevojën për liderët civilë dhe ushtarakë, në pajtim me parimin e përgjegjësisë komanduese, për të dëshmuar zotimin dhe vullnetin politik për të parandaluar dhunën seksuale dhe pandëshkueshmërinë dhe zbatimin e llogaridhënies, dhe se mosveprimi mund të dërgojë mesazhin se prania e dhunës seksuale në konflikte tolerohet,

“Duke theksuar rëndësinë e trajtimit të çështjeve të dhunës seksuale që nga fillimi i proceseve paqësore dhe përpjekjeve të ndërmjetësimit, për të mbrojtur popullatën në rrezik dhe promovimin e stabilitetit të plotë, posaçërisht në zonat e qasjes humanitare para armëpushimit dhe marrëveshjeve për të drejtat e njeriut, armëpushimin dhe monitorimin e armëpushimi, çarmatosjen, demobilizimin dhe riintegrimin, reformat e sektorit të sigurisë, drejtësinë dhe reparacionet, rimëkëmbjen pas konfliktit dhe zhvillimin,

“Duke theksuar me shqetësim nënpërfaqësimin e grave në proceset formale paqësore, mungesën e ndërmjetësve dhe monitoruesve të armëpushimit me trajnime adekuate në trajtimin e dhunës seksuale, si dhe mungesën e grave si udhëheqëse apo shefe të ndërmjetësve për paqe në bisedimet paqësore të sponsorizuara nga OKB-ja,

“Duke pranuar se the promovimi dhe fuqizimi i grave dhe mbështetja për organizatat dhe rrjetet e grave janë

thelbësore në konsolidimin e paqes për promovimin e pjesëmarrjes së barabartë dhe të plotë të grave dhe duke nxitur shtetet anëtare, donatorët dhe shoqërinë civile, duke përfshirë organizatat joqeveritare, për të ofruar mbështetje në këtë kuptim,

“Duke mirëpritur përfshirjen e grave në misionet paqeruajtëse në funksione civile, ushtarake dhe policore, duke pranuar se gratë dhe fëmijët e prekur nga konflikti i armatosur mund të ndihen më të sigurt të punojnë dhe raportojnë abuzimin e grave tek misionet paqeruajtëse, dhe se prania e tyre mund të nxisë gratë lokale që marrin pjesë më forcat kombëtare të armatosura dhe sigurisë, duke ndihmuar kështu në ngritjen e një sektori të sigurisë që është i qasshëm dhe i përgjegjshëm për të gjithë, posaçërisht gratë,

“Duke mirëpritur përpjekjet e Departamentit të Operacioneve Paqeruajtëse për të hartuar udhëzime gjinore për personelin ushtarak në operacionet paqeruajtëse për të lehtësuar zbatimin e Rezolutave

1325 (2000) dhe 1820 (2008), dhe udhëzimeve operacionale për të ndihmuar komponentat civile, ushtarake dhe policore të misioneve paqeruajtëse që në mënyrë efektive të zbatojnë rezolutën 1820 (2008),

“Pas shqyrtimi të raportit të Sekretarit të Përgjithshëm (S/2009/362) të datës 16 korrik 2009 dhe duke theksuar se rezoluta aktuale nuk mëton të arrijë përcaktim ligjor nëse situatat e referuara në raportin e Sekretarit të Përgjithshëm janë apo nuk janë konflikte të armatosura në kontekst të Konventave të Gjenevës dhe Protokollet shtesë të tyre, dhe nuk paragjykon statusin ligjor të palëve joshtetërore të përfshira në këto situata

“Duke rikujtuar vendimin e Këshillit në rezolutën 1882 të 4 gushtit 2009 (S/RES/1882) për zgjerimin e listës së Shtuar në raportin vjetor të Sekretarit të Përgjithshëm për Fëmijët dhe Konfliktin e Armatosur të palëve në situata të konfliktit të armatosur të angazhuar në rekrutimin apo përdorimin e fëmijëve në shkeljen e së drejtës ndërkombëtare për të përfshirë edhe ato palë në

konfliktin e armatosur që angazhon, në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare në fuqi, në trendet e vrasjes dhe joshjes së fëmijëve dhe/ apo përdhunimit dhe formave tjera të dhunës seksuale ndaj fëmijëve, në situata të konfliktit të armatosur,

“Duke theksuar rolin që aktualisht i caktohet Zyrës së Këshilltarit Special për Çështje Gjinore për monitorimin e zbatimit të Rezolutës 1325 dhe për promovimin e integritetit të perspektivës gjinore në sistemin e OKB-së, fuqizimin e gruas dhe barazinë gjinore, dhe duke shprehur rëndësinë e koordinimit efektiv brenda sistemit të OKB-së në këto fusha,

“Duke pranuar se shtetet bartin përgjegjësi primare për respektimin dhe sigurimin e të drejtave të njeriut për qytetarët e tyre, si dhe të gjithë individëve brenda territorit të tyre sipas së drejtës përkatëse ndërkombëtare,

“Duke riafirmuar se palët në konflikt të armatosur bartin përgjegjësinë primare për t'i ndërmarrë të gjitha hapat e mundshëm për të siguruar mbrojtje të civilëve të prekur,

“Duke përsëritur përgjegjësinë e saj parësore për mbajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare dhe në lidhje me këtë zotimin për të vazhduar me trajtimin e ndikimit të përhapur të konflikteve të armatosura në civilë, duke përfshirë për sa i përket dhunës seksuale,

1. Ripohon se dhuna seksuale, kur përdoret apo mandatohet si një taktikë e luftës që në mënyrë të qëllimshme vë në shënjestër civilët ose si pjesë e një sulmi të përhapur ose sistematik kundër popullatës civile, mund të përkeqësojnë dukshëm situatat në konfliktin e armatosur dhe mund të pengojnë rivendosjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, dhe pohon lidhur me këtë se hapat efektiv për të parandaluar dhe për t’u përgjigjur akteve të tilla të dhunës seksuale mund të kontribuojë ndjeshëm në ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, dhe shpreh gatishmërinë e tij, kur të merr parasysh situata në agjendën e Këshillit, për të ndërmarr, kur të jenë të nevojshme, hapat e duhur për të adresuar dhunën e përhapur ose dhunën sistematike seksuale në situata të konfliktit të armatosur;

2. Rithekson kërkesën e vet që të gjitha palët e konfliktit të armatosur të ndalojnë në tërësi dhe menjëherë të gjitha aktet e dhunës seksuale;

3. Kërkon që të gjitha palët në konfliktin e armatosur menjëherë të marrin masat e duhura për të mbrojtur civilët, përfshirë këtu gratë dhe fëmijët, nga të gjitha format e dhunës seksuale, duke përfshirë masat si, ndër të tjera, zbatimin e masave të duhura ushtarake disiplinore dhe përmbajtjen e parimit të përgjegjësisë komanduese, trajnimin e trupave për ndalimin kategorik të të gjitha formave të dhunës seksuale kundër civilëve, demaskimin e miteve të cilat përkrahin dhunën seksuale dhe verifikimin e kandidatëve për ushtritë kombëtare dhe forcat e sigurisë për të siguruar përjashtimin e atyre që ndërlidhen me shkelje të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, duke përfshirë dhunën seksuale;

4. Kërkon nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara të emëroj një përfaqësues special për të siguruar udhëheqjen koherente dhe

strategjike, për të punuar në mënyrë efektive për të forcuar mekanizmat ekzistues koordinues të Kombeve të Bashkuara, si dhe për t'u angazhuar në përpjekjet avokuese, ndër të tjera, me qeveritë, duke përfshirë përfaqësues ushtarak dhe gjyqësor, si dhe me të gjitha palët e konfliktit të armatosur dhe të shoqërisë civile, për të adresuar, në të dyja selinë dhe në nivel vendi, dhunën seksuale në konfliktet e armatosura, duke promovuar bashkëpunimin dhe koordinimin e përpjekjeve në mesin e të gjithë akterëve relevantë, kryesisht përmes iniciativës ndër-agjenci "veprimi i Kombeve të Bashkuara Kundër dhunës seksuale në Konflikt";

5. Inkurajon entitetet që përbëjnë Veprimin e OKB-së kundër dhunës seksuale në konflikt, si dhe pjesë të tjera të rëndësishme të sistemit të Kombeve të Bashkuara, për të mbështetur punën e Përfaqësuesit të lartpërmendur Special të Sekretarit të Përgjithshëm dhe për të vazhduar dhe për të përmirësuar bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit në mes të gjithë akterëve relevant, për të përforcuar

koordinimin dhe për t'ju shmangur dyfishimit në nivel të selisë dhe nivel vendi si dhe përmirësimin e sistemit të gjerë të reagimit;

6. Nxit Shtetet që të ndërmarrin reforma gjithëpërfshirëse ligjore dhe gjyqësore, sipas nevojës, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, pa vonesë dhe me një synim për të sjellë autorët e dhunës seksuale në konflikte para drejtësisë dhe për të siguruar që të mbijetuarit të kenë qasje në drejtësi, të trajtohen me dinjitet gjatë tërë procesit të drejtësisë dhe të jenë të mbrojtur dhe të marrin dëmshpërblim për vuajtjet e tyre;

7. Kërkon nga të gjitha palët në konflikt që të sigurojnë që të gjithë raportime për dhunë seksuale të kryera nga civilët ose nga personeli ushtarak të hetohen plotësisht dhe autorët e dyshuar të sillen para drejtësisë, dhe që eprorët civil dhe komandantët ushtarakë, në përputhje me ligjin ndërkombëtar humanitar, të përdorin autoritetin e tyre dhe kompetencat për të parandaluar dhunën seksuale, duke përfshirë luftimin e mosndëshkimit;

8. I bën thirrje Sekretarit të Përgjithshëm që të identifikojnë dhe të marr masat e duhura për të vendosur me shpejtësi një ekip ekspertësh tek situatat me interes të veçantë në lidhje me dhunën seksuale në konflikt të armatosur, duke punuar përmes pranisë së Kombeve të Bashkuara në terren dhe me pëlqimin e qeveris; vendore, për të ndihmuar autoritetet kombëtare për të forcuar sundimin e ligjit, dhe rekomandon përdorimin e burimeve ekzistuese njerëzore brenda sistemit të Kombeve të Bashkuara dhe kontributet vullnetare, duke punuar mbi ekspertizën e domosdoshme, sipas nevojës, në sundimin e ligjit, sistemet gjyqësore civile dhe ushtarake, ndërmjetësimin, hetimin penal, reformat në sektorin e sigurisë, mbrojtjen e dëshmitarëve, standardet për gjykim të drejtë dhe punën publike në terren, për, ndër të tjera:

(a) Të punojnë ngushtë me zyrtarë vendor ligjor dhe gjyqësor dhe personelin tjetër në sistemet civile

dhe të drejtësisë ushtarake të qeverive përkatëse për të adresuar mosndëshkimin, duke përfshirë aftësimin e kuadrove vendore, dhe duke tërhequr vëmendjen në një sërë mekanizma të drejtësisë që duhet të merren parasysh;

(b) Të identifikoj zbrazëtitat në reagimet vendore dhe për të inkurajuar një qasje më të gjerë vendore për të adresuar dhunën seksuale në konflikt të armatosur, duke përfshirë edhe rritjen e përgjegjësisë penale, reagimi ndaj viktimave, dhe kapacitetin gjyqësor;

(c) Të bëjë rekomandime për të koordinuar përpjekjet e brendshme dhe ndërkombëtare dhe burimet për të përforcuar aftësinë e qeverisë për të adresuar dhunën seksuale në konflikt të armatosur;

(d) Të punoj me Misionin e Kombeve të Bashkuara, ekipin vendor, si dhe Përfaqësuesin e lartpërmendur Special të Sekretarit të Përgjithshëm sipas nevojës drejt implementimit të plotë të masave të kërkuara nga Rezoluta 1820 (2008);

9. Inkurajon shtetet, subjektet përkatëse të Kombeve të Bashkuara, dhe shoqërinë civile, sipas nevojës, për të siguruar ndihmë në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet vendore për aftësimin e kuadrove vendore në sistemet gjyqësore dhe sistemet e zbatimit të ligjit në situata me interes të veçantë në lidhje me dhunën seksuale në konflikt të armatosur;

10. Rithekson qëllimin e vet, kur të miratoj ose rinovoj sanksionet e planifikuara në situatat e konfliktit të armatosur, të marrin në konsideratë duke përfshirë, aty ku është e përshtatshme, përcaktimin e kriterëve që kanë të bëjnë me aktet e përdhunimit dhe formave të tjera të dhunës seksuale; dhe ju bën thirrje të gjitha operacioneve paqeruajtëse dhe misioneve tjera relevante të Kombeve të Bashkuara dhe organeve të Kombeve të Bashkuara, në veçanti Grupit Punues për fëmijët dhe konfliktin e armatosur, për të ndarë, të gjitha informatat përkatëse në lidhje me dhunën seksuale, me komisionet relevante të sanksioneve të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, edhe nëpërmjet të grupeve monitoruese të Komisionit për Sanksione të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe grupeve të ekspertëve;

11. Shpreh synimin e tij për të siguruar që rezolutat, të cilat krijojnë apo rinovojnë mandatet paqeruajtëse, të përmbajnë dispozita, sipas nevojës,

në parandalimin e dhe reagimin ndaj, dhunës seksuale, me kërkesat korresponduese të raportimit tek Këshilli;

12. Vendos të përfshijë dispozita të veçanta, sipas nevojës, për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve nga përdhunimi dhe dhuna tjetër seksual në mandatet e operacioneve paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë, nga rasti në rast, identifikimin e këshilltarëve për mbrojtje të grave (WPAs) në mesin e këshilltarëve për çështje gjinore dhe njësitë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, dhe kërkon që Sekretari i Përgjithshëm të siguroj që nevoja për të, dhe numri si dhe rolet e WPAs vlerësohen sistematikisht gjatë përgatitjes së çdo operacioni paqeruajtës të Kombeve të Bashkuara;

13. Inkurajon shtetet, me mbështetjen e bashkësisë ndërkombëtare, për të rritur qasjen në kujdesin shëndetësor, mbështetje psiko-sociale, ndihmën ligjore dhe shërbimet e ri-integrimit social-ekonomik për viktimat e dhunës seksuale, në veçanti në zonat rurale;

14. Shpreh synimin e saj që të përdor në mënyrën më të mirë të mundshme vizitat periodike në terren në zonat e konfliktit, përmes organizimit të takimeve interaktive me femrat lokale dhe organizatat e grave në terren rreth shqetësimeve dhe nevojave të grave në zonat e konfliktit të armatosur;

15. Inkurajon liderët në nivel kombëtar dhe lokal, duke përfshirë udhëheqësit tradicional ku ata ekzistojnë dhe udhëheqësve fetarë, për të luajtur një rol më aktiv në sensibilizimin e komuniteteve për dhunën seksuale për të evituar marginalizimin dhe stigmatizimin e viktimave, për të ndihmuar me ri-integrimin e tyre sociale, si dhe për të luftuar një kulturë të mosndëshkimit të këtyre krimeve;

16. Kërkon nga Sekretari i Përgjithshëm, Shtetet Anëtare dhe krerët e organizatave rajonale të marrin masapërtëriturpërfaqësimin e grave në proceset e ndërmjetësimit dhe proceset vendim-marrëse në lidhje me zgjidhjen e konflikteve dhe ndërtimin e paqes;

17. Kërkon që çështjet e dhunës seksuale të përfshihen në të gjitha agjendat e sponsorizuara nga Kombet e Bashkuara për negociatat e paqes, si dhe kërkon përfshirjen e çështjeve të dhunës seksuale nga fillimi i proceseve të paqes në situata të tilla, në veçanti në fushat e para-armëpushimit, qasje humanitare dhe marrëveshje për të drejtat e njeriut, armëpushimin dhe monitorimin e armëpushimit, aranzhimet e DDR-së dhe SSR-së, verifikimi i forcave të armatosura dhe forcave të sigurisë, drejtësisë, riparimet, dhe rimëkëmbjen/zhvillimin;

18. Riafirmon rolin e Komisionit të ndërtimit të paqes në promovimin e qasjeve që kanë për bazë gjithë përfshirjen gjinore në uljen e jo stabilitetit në situatat e pas konfliktit, duke vënë në dukje rolin e rëndësishëm të grave në rindërtimin e shoqërisë, dhe nxit Komisionin e ndërtimit të paqes për të inkurajuar të gjitha palët në vend që të përfshijnë në agjendat e veta dhe të zbatoj masat për të zvogëluar dhunën seksuale në strategjitë e periudhës pas konfliktit;

19. Inkurajon shtetet anëtare për të dërguar një numër më të madh të femrave si personel ushtarak dhe policor në operacionet paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara, si dhe ti sigurojë të gjithë personelit ushtarak dhe policor trajnim adekuat për të kryer përgjegjësitë e tyre;

20. Kërkon Sekretaritetin Përgjithshëm për të siguruar që mbështetja teknike i është dhënë trupave dhe policisë së vendeve kontribuuese, në mënyrë që të përfshijë udhëzime për personelin ushtarak dhe policor mbi dhunën seksuale në trajnimin para dërgimit në mision dhe trajnimeve të para informuese;

21. Kërkon Sekretaritetin Përgjithshëm për të vazhduar dhe për të forcuar përpjekjet për të zbatuar politikën e zero tolerancës ndaj shfrytëzimit seksual dhe abuzimit në operacionet paqeruajtëse të Kombeve të

Bashkuara, dhe kërkon nga trupat-dhe-policia e vendeve kontribuuese që të ndërmarrin masat e duhura parandaluese, duke përfshirë trajnimet para dërgimit në mision dhe trajnimet e vetëdijesimit dhe veprime të tjera për të siguruar llogaridhënie të plotë në rast të sjelljes së tillë që do të përfshinte personelin e tyre;

22. Kërkon që Sekretari i Përgjithshëm të vazhdojë të drejtojë të gjitha subjektet relevante të Kombeve të Bashkuara për të marrë masa të veçanta për të siguruar integrimin sistematik të çështjeve gjinore brenda institucioneve të tyre përkatëse, duke përfshirë edhe sigurimin e alokimeve të burimeve të mjaftueshme financiare dhe njerëzore brenda të gjitha zyrave përkatëse dhe departamenteve dhe në terren, si dhe për të forcuar, brenda mandateve të tyre përkatëse, bashkëpunimin dhe koordinimin e tyre, kur të trajtohen çështjet e dhunës seksuale në konflikt të armatosur;

23. Kërkon nga përfaqësuesit special relevant dhe koordinatorët për ndihma emergjente të Sekretarit të Përgjithshëm, me mbështetjen strategjike dhe teknike nga rrjeti i Veprimit të OKB-së, që të punojnë me shtetet anëtare për të krijuar strategji gjithëpërfshirëse të përbashkëta në mes të Qeverisë dhe Kombeve të Bashkuara për të luftuar dhunën seksuale, në konsultim me të gjitha palët e përfshira, dhe për të siguruar rregullisht përditësime për këtë situatë në raportimet e tyre standarde në selinë qendrore;

24. Kërkon që Sekretari i Përgjithshëm të siguroj raportim më sistematik mbi incidentet e tendencave, modelet e reja të sulmit, dhe indikatorët e paralajmërimit të hershëm të përdorimit të dhunës seksuale në konflikt të armatosur në të gjitha raportet përkatëse të Këshillit, si dhe inkurajon përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm, Koordinatorin për ndihma emergjente, Komisionari e Lartë për të Drejtat e Njeriut, Raportuesin Special mbi dhunën kundër grave, dhe kryesuesin (et) e Veprimit të OKB-së, që ti siguroj Këshillit, në koordinim me Përfaqësuesin special të lartpërmendur, informime dhe dokumentacion shtesë mbi dhunën seksuale në konfliktin e armatosur;

25. I kërkon Sekretarit të Përgjithshëm që të përfshij, kur është e përshtatshme, në raportet e tij të rregullta për operacionet paqeruajtëse individuale, informacion mbi hapat e ndërmarra për zbatimin e masave për të mbrojtur civilët, veçanërisht gratë dhe fëmijët, kundër dhunës seksuale;

26. I kërkon Sekretarit të Përgjithshëm, duke marrë parasysh propozimet e përfshira në raportin e tij, si dhe elemente të tjera të rëndësishme, për të hartuar urgjentisht dhe mundësisht brenda tre muajve, propozime specifike mbi mënyrat për të siguruar monitorimin dhe raportimin në një mënyrë më efektive dhe efikase brenda sistemit ekzistuese të Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve nga përdhunimi dhe dhuna të tjera

seksuale në konfliktin e armatosur dhe situatat e pas konfliktit, duke shfrytëzuar ekspertizën nga sistemi i Kombeve të Bashkuara dhe kontributet e qeverive kombëtare, organizatave rajonale, organizatave jo-qeveritare në kapacitetin e tyre këshillëdhënës dhe akterëve të ndryshëm të shoqërisë civile, në mënyrë që të sigurojë informata në kohë, objektive, të sakta dhe të besueshme mbi zbrazëirat në reagimin e entiteteve të Kombeve të Bashkuara, për të konsideruara marrjen e masave të përshtatshme;

27. Kërkon që Sekretari i Përgjithshëm që të vazhdoj ti paraqes raportet vjetore para Këshillit për zbatimin e rezolutës 1820 (2008) dhe të paraqesë raportin e tij të ardhshëm deri në shtator të vitit 2010 mbi zbatimin e kësaj rezolute dhe rezolutës 1820 (2008) për të përfshirë, ndër të tjera:

(a) një plan të hollësishëm koordinues dhe strategjik për mbledhjen e informatave në kohë dhe në mënyrë etike;

(b) Përditësimet për përpjekjet nga personat përgjegjës, të Misionit të Kombeve të Bashkuara, për dhunën seksuale të punojnë ngushtë me Koordinatorin Kryesor/Koordinatorin Humanitar (RC/ HC), ekipin vendor të Kombeve të Bashkuara, dhe, kur është e përshtatshme, përfaqësuesi i lartpërmendur special dhe/ose ekipi i ekspertëve, për të adresuar dhunën seksuale

(c) informacionet në lidhje me palët e konfliktit të armatosur që besohen si të dyshuar për kryerjen sistematike të përdhunimit apo formave të tjera të dhunës seksuale, në situata që janë në agjendën e Këshillit;

28. Vendos për të shqyrtuar, duke marrë parasysh procesin e themeluar nga rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 63/311 lidhur me një entitet të Kombeve të Bashkuara të përbërë nga aspekti gjinor, mandatet e Përfaqësuesit Special që kërkohen në paragrafin 4 dhe ekipin e ekspertëve në paragrafin 8 operativ brenda dy viteve, dhe pas kësaj sipas nevojës;

29. Vendos që të vazhdojë të merret aktivisht me këtë çështje

Shtojca 4: RKSOKB 1889

Këshilli i Sigurimit njëzëri ka miratuar rezolutën 1889 (2009), teksti i plotë i së cilës është si në vijim:

Rezoluta e Këshillit të Sigurimit 1889

“Këshilli i Sigurimit,

“Duke riafirmuar zotimin e tij për zbatimin e vazhdueshëm dhe të plotë, në mënyrë reciprokisht të detyruar, të Rezolutave 1325 (2000), 1612 (2005), 1674 (2006), 1820 (2008), 1882 (2009), 1888 (2009) dhe dhe deklaratave relevante të Presidentit të saj,

“Të udhëhequr nga qëllime dhe parimet e Kartës së OKB-së dhe duke pasur parasysh përgjegjësinë primare të Këshillit të Sigurimit sipas Kartës për mbajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare,

“Duke rikujtuar vendosmërinë e shprehur në 2005 të Dokumentin e Përfundimeve të Samitit Botëror Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara (A/RES/60/1) për të eliminuar të gjitha format e dhunës kundër grave dhe vajzave, detyrimet e Shteteve Palë të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave dhe Protokollit Opsional, Konventës për të Drejtat e Fëmijëve dhe Protokollit Opsional të saj, duke rikujtuar edhe zotimet e përfshira në Platformën dhe Deklaratën së Pekinit për Veprim, si dhe ato të përfshira

në dokumentin përfundimtar të Seancës së njëzetetretë speciale të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara me titull “Gratë 2000: Barazia gjinore, Zhvillimi i Paqes për Shekullin e Njëzetënjëtë” (A/S-23/10/Rev.1), në veçanti ato në lidhje me gratë dhe konfliktin e armatosur,

“Pas shqyrtimi të raportit të Sekretarit të Përgjithshëm (S/2009/465) të datës 16 shtator 2009 dhe duke theksuar se rezoluta aktuale nuk mëton të arrijë përcaktim ligjor nëse situatat e referuara në raportin e Sekretarit të Përgjithshëm janë apo nuk janë konflikte të armatosura në kontekst të Konventave të Gjenezës dhe Protokollit shtesë të tij, dhe nuk paragjykon statusin ligjor të palëve joshitetërore të përfshira në këto situata,

“Duke përshëndetur përpjekjet e Shteteve Anëtare në zbatimin e rezolutës 1325 (2000) në nivel kombëtar, duke përfshirë zhvillimin e planeve kombëtare të veprimit, dhe duke nxitur Shtetet anëtare që të vazhdojnë të ndjekin zbatimin e tillë,

“Duke përsëritur nevojën për pjesëmarrje të plotë, të barabartë dhe efektive të grave në të gjitha fazat e proceseve të paqes duke pasur parasysh rolin e tyre vital në zgjidhjen dhe parandalimin e konfliktit dhe ndërtimin e paqes, duke ripohuar rolin kyç që gratë mund ta luajnë në rithemelimin e strukturës së shoqërisë në rimëkëmbje dhe duke theksuar nevojën për përfshirjen e tyre në hartimin dhe zbatimin e strategjive pas konfliktit në mënyrë që të marrin parasysh pikëpamjet dhe nevojat e tyre,

“Duke shprehur shqetësimin e thellë për nënpërfaqësimin e grave në të gjitha fazat e proceseve paqësore, posaçërisht numrin e ulët të grave në rolet formale në proceset ndërmjetëse dhe duke theksuar nevojën për të siguruar se gratë emërohen në mënyrë të duhur në nivelet vendimmarrëse, si ndërmjetës të nivelit të lartë, dhe në përbërje të ekipeve ndërmjetëse, “Thellësisht të brengosur edhe me pengesat dhe sfidat e vazhdueshme lidhur me pjesëmarrjen dhe përfshirjen e plotë të grave në parandalimin dhe zgjidhjen e

konflikteve dhe pjesëmarrjen në jetën publike pas konfliktit, si rezultat i dhunës, kërcënimeve, mungesës së sigurisë dhe sundimit të ligjit, diskriminimit kulturor dhe stigmatizimit, përfshirë edhe rritjen e mendimeve ekstremiste dhe fanatike për gratë, dhe faktorëve socio-ekonomikë që përfshijnë mungesën e qasjes në arsim, dhe në këtë kuptim, duke pranuar se marginalizimi i gruas mund të shtyjë apo minojë arritjen e paqes së qëndrueshme, sigurinë dhe pajtimin “Duke njohur nevojat e veçanta të grave dhe vajzave në situatat e pas konfliktit, duke përfshirë, mes tjerash, sigurinë fizike, shërbimet shëndetësore duke përfshirë shëndetin riprodhues dhe mendor, mënyrat për të siguruar jetesën e tyre, të drejtat në tokë dhe ato pronësore, punësimin, si dhe pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje dhe planifikim të pas konfliktit, veçanërisht në fazat e hershme të ndërtimit të paqes pas konfliktit,

“Duke theksuar se përkundër progresit, ende ka pengesa për fuqizimin e pjesëmarrjes së grave në parandalimin e konflikteve, zgjidhjen

e konflikteve dhe ndërtimin e paqes, duke shprehur shqetësimin se kapaciteti i grave për t'u angazhuar në vendimmarrjen publike dhe rimëkëmbje ekonomike shpeshherë nuk merr njohjen adekuate ose financim në situatat e pas konfliktit, dhe duke nënvizuar se financimi për nevojat e grave në rimëkëmbjen e hershme është me rëndësi jetike për rritjen e fuqizimit të grave, të cilat mund të kontribuojnë në ndërtimin efektiv të paqes pas konfliktit,

“Duke theksuar se gratë në situata të konfliktit të armatosur dhe situatat e pas konfliktit vazhdojnë të konsiderohen shpeshherë si viktime dhe jo si aktere në adresimin dhe zgjidhjen e situatave të konfliktit të armatosur dhe duke theksuar nevojën që fokusi të mos jetë vetëm në mbrojtjen e grave, por edhe në fuqizimin e tyre në ndërtimin e paqes,

“Duke pranuar se të kuptuarit e ndikimit të situatave të konfliktit të armatosur mbi gratë dhe vajzat, duke përfshirë kur ato janë refugjate dhe personatëzhvendosurbrendavendit, reagimit të shpejtë dhe adekuat ndaj nevojave të tyre të veçanta, dhe aranzhimeve institucionale efektive për të garantuar mbrojtjen

dhe pjesëmarrjen e tyre të plotë në procesin e paqes, veçanërisht në fazat e hershme të ndërtimit të paqes pas konfliktit, mund të kontribuojë ndjeshëm në mirëmbajtjen dhe promovimin e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare,

“Duke mirëpritur nismën e OKB-së për zhvillimin e një sistemi të ngjashëm me atë të nisur për herë të parë nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim për t'i lejuar vendimmarrësit që të gjurmojnë alokimet që kanë të bëjnë me çështje gjinore në Fondin e Mirëbesimit të Donatorëve të Grupit të OKB-së për Zhvillim,

“Duke i përshëndetur përpjekjet e Sekretarit të Përgjithshëm për emërimin e më shumë grave në pozita të larta në OKB, posaçërisht në misione të jashtme, si hap i prekshëm drejt sigurimit të lidërshipt të OKB-së në zbatimin rezolutës së saj 1325 (2000),

“Duke përshëndetur themelimin e ardhshëm të Komisionit Drejtues të OKB-së për avancimin e dukshmërisë dhe fuqizimin e koordinimit brenda sistemit të OKB-së që ka të bëjë me përgatitjet për përvjetorin e dhjetë

të Rezolutës 1325 (2000),
"Duke nxitur akterët relevantë që të organizojë ngjarje gjatë periudhës 2009-2010 në nivel global, rajonal dhe kombëtar për të rritur ndërgjegjësimin në lidhje me Rezolutën 1325 (2000), përfshirë edhe ngjarje ministrore, për të ripërtërirë zotimet për "Gratë, paqen dhe sigurinë", dhe për të identifikuar mënyrat për t'i adresuar sfidat e reja dhe në zbatimin e rezolutës 1325 (2000) në të ardhmen,

1.

Nxit Shtetet Anëtare, organizatat ndërkombëtare dhe rajonale të ndërmarrin masa të tjera për të përmirësuar pjesëmarrjen e grave gjatë të gjitha fazave të procesit të paqes, sidomos në zgjidhjen e konflikteve, planifikimit të periudhës pas konfliktit dhe ndërtimit të paqes, duke përfshirë edhe rritjen e angazhimit të tyre në vendim-marrjet politike dhe ekonomike në fazat e hershme të proceseve të rimëkëmbjes, ndër të tjera, përmes promovimit të lidershit të grave dhe kapacitetit për t'u angazhuar në menaxhimin dhe planifikimin e ndihmës, duke mbështetur organizatat e grave, si dhe në luftimin kundër qëndrimeve negative shoqërore për kapacitetin e grave për të marrë pjesë në mënyrë të barabartë;

2. Përsërit thirrjet e veta për të gjitha palët në konfliktet e armatosura që të respektojnë plotësisht ligjin ndërkombëtar që aplikohet për të drejtat dhe mbrojtjen e grave dhe vajzave;

3. Dënon fuqishëm të gjitha shkeljet e aplikueshme të së drejtës ndërkombëtare të kryera ndaj grave dhe vajzave në situatat e konflikteve të armatosura dhe situatave pas konfliktit, kërkon nga të gjitha palët në konflikt të ndërpresë akte të tilla menjëherë, dhe thekson përgjegjësinë e të gjitha shteteve për t'i dhënë fund mosndëshkimit dhe për të ndjekur penalisht ata që janë përgjegjës për të gjitha format e dhunës së kryer ndaj grave dhe vajzave në konflikte të armatosura, duke përfshirë përdhunimin dhe dhunë tjetër seksuale;

4. I bën thirrje Sekretarit të Përgjithshëm që të hartoj një strategji, duke përfshirë trajnimin e duhur, për të rritur numrin e grave të emëruar për të kryer punë në emër të tij, veçanërisht si Përfaqësuese Speciale dhe të dërguara Speciale, si dhe të ndërmarrin masa për të rritur pjesëmarrjen e grave në misionet politike, paqeruajtëse dhe misionet për ndërtimin e paqes të Kombet e Bashkuara;

5. I kërkon Sekretarit të Përgjithshëm që të sigurojë që të gjitha raportet në Këshillin e Sigurimit të japin informacion mbi ndikimin e situatave të konfliktit të armatosur mbi gratë dhe vajzat, nevojat e tyre të veçanta në situatat pas konfliktit dhe pengesave për realizimin e këtyre nevojave;

6. I kërkon Sekretarit të Përgjithshëm që të siguroj që organet relevante të Kombeve të Bashkuara, në bashkëpunim me shtetet anëtare dhe të shoqërisë civile, të mbledhin të dhëna, analizojnë dhe vlerësojnë sistematikisht nevojat e veçanta të grave dhe vajzave në situatat e pas konfliktit, duke përfshirë, ndër të tjera, informacione mbi nevojat e tyre nevojat për siguri fizike dhe pjesëmarrje në vendimmarrje dhe planifikim pas konfliktit, në mënyrë që të përmirësohet sistemi i gjerë i reagimit ndaj këtyre nevojave;

7. Shpreh synimin e tij, që kur të themeloj dhe rinovoj mandatet e misioneve të Kombeve të Bashkuara, të përfshijë dispozita për promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave në situatat e pas konfliktit, dhe kërkon që Sekretari i Përgjithshëm të vazhdoj, sipas nevojës, emëroj këshilltarët për çështje gjinore dhe/ose këshilltarët për mbrojtjen e grave në misionet e Kombeve të Bashkuara dhe të kërkoj nga ato, që

në bashkëpunim me ekipet vendore të Kombeve të Bashkuara, të ofroj ndihmë teknike dhe përpjekje të përmirësuara për të adresuar nevojat e rimëkëmbjes së grave dhe vajzave në situatat e pas konfliktit;

8. Nxit Shtetet Anëtare për të siguruar integrimin gjinor në të gjitha situatat e ndërtimit të paqes si dhe proceset dhe sektorët që merren me rimëkëmbjen;

9. Kërkon nga Shtetet Anëtare, organet e Kombeve të Bashkuara, donatorët dhe shoqëria civile që të sigurojnë se fuqizimi i grave është marrë parasysh gjatë vlerësimit të nevojave dhe planifikimeve pas konfliktit, dhe është faktorizuar në shpërndarjen e fondeve pasuese dhe aktiviteteve të programit, duke përfshirë analizën e zhvillimit transparent dhe gjurmimin e fondeve të akorduara për adresimin e nevojave të grave në fazën e pas konfliktit;

10. Nxit Shtetet Anëtare në situatat e pas konfliktit, në konsultim me shoqërinë civile, përfshirë edhe organizatat e grave, të specifikojë në hollësi nevojat dhe prioritetet e grave dhe vajzave dhe të hartoj strategjitë konkrete në përputhje me sistemet e tyre ligjore, për të adresuar këto nevoja dhe prioritete, të cilat ndër të tjera mbështetësin siguri më

të madhe fizike dhe kushtet më të mira socio-ekonomike, nëpërmjet edukimit, aktiviteteve të krijimit të ardhurave, qasje në shërbimet themelore, në veçanti në shërbimet shëndetësore, duke përfshirë shëndetin seksual dhe riprodhues dhe të drejtat riprodhuese dhe shëndetin mendor, zbatimin e ligjit që është i përgjegjshëm në aspektin gjinor dhe qasje në drejtësi, si dhe rritjen e kapaciteteve për tu angazhuar në vendimmarrjen publike në të gjitha nivelet;

11. Kërkon nga Shtetet Anëtare, organet e Kombeve të Bashkuara, dhe shoqëria civile, duke përfshirë organizatat joqeveritare, që të marrin të gjitha masat e mundshme për të siguruar qasje të barabarta për gratë dhe vajzat në arsimim në situatat e pas konfliktit, duke pasur parasysh rolin jetik të arsimit në promovimin e pjesëmarrjes së grave në vendim marrjet pas konfliktit;

12. U bën thirrje të gjitha palëve në konfliktet e armatosura që të respektojnë karakterin civil dhe humanitar të kampeve të refugjatëve dhe vendbanimet, dhe për të siguruar mbrojtjen e të gjithë civilëve që banojnë në kampe të tilla, në veçanti mbrojtjen e grave dhe vajzave, nga të gjitha format e dhunës, duke përfshirë përdhunimin dhe dhunën tjetër seksuale, dhe për të siguruar qasje të plotë, të papenguar dhe humanitare në kampe;

13. U bën thirrje të gjithë atyre që janë të përfshirë në planifikimin e çarmatimit, çmobilizimit dhe ri-integrimit të marrin parasysh nevojat e veçanta të grave dhe vajzave të ndërlidhura me forcat e armatosura dhe grupet e armatosura dhe fëmijët e tyre, dhe të sigurojë për qasjen e tyre të plotë për këto programe;

14. Inkurajon Komisionin për ndërtimin e paqes dhe Zyrën për asistencë në ndërtimin e paqes për të vazhduar në sigurimin e vëmendjes sistematike ndaj dhe mobilizimin e burimeve për avancimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave si pjesë integrale e ndërtimit të paqes pas konfliktit, dhe për të inkurajuar pjesëmarrjen e plotë të grave në këtë proces;

15. Kërkon nga Sekretari i Përgjithshëm, në agjendën e tij për veprim për të përmirësuar përpjekjet e Kombevetë Bashkuara në ndërtimin e paqes, të marrë parasysh nevojën për të përmirësuar pjesëmarrjen e grave në vendimmarrjet politike dhe ekonomike nga fazat më të hershme të procesit të ndërtimit të paqes;

16. Kërkon nga Sekretari i Përgjithshëm që të sigurojë transparencë të plotë, bashkëpunim dhe koordinim të përpjekjeve në mes të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për Fëmijët dhe konfliktin e armatosur dhe Përfaqësuesin Special të Sekretarit të

Përgjithshëm mbi dhunën seksuale dhe konfliktin e armatosur emërimi i të cilit është kërkuar nga rezoluta 1888 (2009);

17. I kërkon Sekretarit të Përgjithshëm që të paraqesë në Këshillin e Sigurimit brenda 6 muajve, për shqyrtim, një sërë treguesish për përdorim në nivel global për të ndjekur zbatimin e rezolutës 1325 (2000), e cila mund të shërbejë si një bazë e përbashkët për raportimi nga subjektet relevante të Kombeve të Bashkuara, organizatat e tjera ndërkombëtare dhe rajonale, si dhe Shtetet Anëtare, për zbatimin e rezolutës 1325 (2000) në vitin 2010 dhe më tej;

18. Kërkon nga Sekretari i Përgjithshëm, brenda raportit të kërkuar në S/PRST/2007/40, që gjithashtu të përfshijë një rishikim të progresit në zbatimin e rezolutës 1325 (2000), një vlerësim i proceseve me të cilat Këshilli i Sigurimit merr, analizon dhe ndërmerri veprime mbi informacionin që i përket rezolutës 1325 (2000), rekomandime për masa të tjera për të përmirësuar koordinimin në të gjithë sistemin e Kombeve të Bashkuara, si dhe me shtetet anëtare dhe shoqërinë civile për të kryer zbatimin dhe të dhënat mbi pjesëmarrjen e grave në misionet e Kombeve të Bashkuara;

19. I kërkon Sekretarit të Përgjithshëm që të paraqesë një raport për Këshillin e Sigurimit brenda 12 muajve në adresimin e pjesëmarrjes së grave në ndërtimin e paqes dhe përfshirjen dhe planifikimin pas konfliktit, duke marrë parasysh pikëpamjet e Komisionit për ndërtimin e paqes dhe të përfshij, ndër të tjera:

a. Analizat për nevojat e veçanta të grave dhe vajzave në situatat pas konfliktit

b. Sfidat për pjesëmarrjen e grave në zgjidhjen e konfliktit dhe ndërtimin e paqes si dhe integrimin gjinor në të gjithë proceset fillestare të planifikimit, financimit dhe rimëkëmbjes pas konfliktit;

c. Masat për të mbështetur kapacitetet kombëtare në planifikimin për dhe reagimin financiar për nevojat e grave dhe vajzave në situatat e pas konfliktit;

d. Rekomandimet për përmirësimin e reagimeve ndërkombëtare dhe kombëtare për nevojat e grave dhe vajzave në situatat e pas konfliktit, duke përfshirë zhvillimin e marrëveshjeve efektive financiare dhe institucionale për të garantuar pjesëmarrjen e plotë dhe të barabartë të grave në procesin e ndërtimit të paqes,

20. Vendosi që të vazhdojë të merret aktivisht me këtë çështje.

Shtojca 5: RKSOKB 1960

Rezoluta e Këshillit të Sigurimit 1960 (2010)

Këshilli pastaj ka miratuar njëzëri rezolutën 1960 (2010), teksti i plotë i së cilës është si në vijim:

“Këshilli i Sigurimit,

“Duke riafirmuar zotimin e tij për zbatimin e vazhdueshëm dhe të plotë, në mënyrë reciprokisht të detyruar, të Rezolutave 1325 (2000), 1612 (2005), 1674 (2006), 1820 (2008), 1882 (2009), 1888 (2009), 1889 (2009) dhe 1894 (2009), dhe dhe deklaratave relevante të Presidentit të saj,

“Duke mirëpritur raportin e Sekretarit të Përgjithshëm të 24 nëntorit 2010 (S/2010/604), por duke mbetur thellësisht të shqetësuar për mungesën e progresit për çështjen e dhunës seksuale në situatat e konfliktit të armatosur në veçanti kundër grave dhe fëmijëve, veçanërisht ndaj vajzave, dhe duke theksuar siç është e dokumentuar në raportin e Sekretarit të Përgjithshëm se dhuna seksuale ndodhë në konfliktet e armatosura në tërë botën,

“Duke përsëritur shqetësimin e thellë se përkundër dënimit të vazhdueshëm të dhunës ndaj gruas dhe fëmijëve që përfshin të gjitha format e dhunës seksuale në situata të konfliktit të armatosur, dhe përkundër faktit që i bën thirrje të gjitha palëve në konflikt të armatosur për ndërprerjen e këtyre akteve me efekt të menjëhershëm, aktet e tilla vazhdojnë të ndodhin dhe në disa situata janë bërë sistematike dhe

të përhapur, duke rritur nivele të tmerrshme të brutalitetit,

“Duke theksuar nevojën për të gjitha shtetet anëtare dhe palët joshtetërore në konflikte të jenë në përputhje me obligimet e tyre sipas së drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë ndalimin e të gjitha formave të dhunës seksuale,

“Duke pranuar nevojën për liderët civilë dhe ushtarakë, në pajtim me parimin e përgjegjësisë komanduese, për të dëshmuar zotimin dhe vullnetin politik për të parandaluar dhunën seksuale dhe pandëshkueshmërinë dhe zbatimin e llogaridhënies, dhe se mosveprimi mund të dërgojë mesazhin se prania e dhunës seksuale në konflikte tolerohet,

“Duke rikujtuar përgjegjësinë e Shteteve për t’i dhënë fund pandëshkueshmërisë dhe të ndëshkuar ata që janë përgjegjës për gjenocidin, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës dhe krimet tjera të rënda të kryera ndaj civilëve, dhe në këtë kontekst me shqetësim se vetëm një numër i kufizuar i kryerësve janë sjellë para drejtësisë, duke pranuar se në situata të konfliktit dhe pas konfliktit sistemet vendore të drejtësisë mund të jenë dobësuar në masë të konsiderueshme;

“Duke përshëndetur përparimin e bërë në funksionalizimin e ekipit të ekspertëve për të ndihmuar autoritetet kombëtare në forcimin e sundimit të ligjit në pajtim me rezolutën 1888 (2009); duke rikonfirmuar rëndësinë e zbatimit të tij me shpejtësi në situatat me shqetësim të veçantë në lidhje me dhunën seksuale në konflikt të armatosur, duke punuar përmes pranisë së Kombeve të Bashkuara në terren dhe me pëlqimin e Qeverisë pritëse dhe në këtë drejtim, duke vlerësuar kontributet vullnetare për mbështetjen e punës së tij,

“Duke pranuar se shtetet bartin përgjegjësi primare për respektimin dhe sigurimin e të drejtave të njeriut për qytetarët e tyre, si dhe të gjithë individëve brenda territorit të tyre sipas së drejtës përkatëse ndërkombëtare,

“Duke riafirmuar se palët në konflikt të armatosur bartin përgjegjësinë primare për t’i ndërmarrë të gjitha hapat e mundshëm për të siguruar mbrojtje të civilëve të prekur,

“Duke rikujtuar se e drejta ndërkombëtare humanitare ofron mbështetje të përgjithshme për gratë dhe fëmijët si pjesë e popullatës civile gjatë konflikteve të armatosura dhe mbrojtje speciale për shkak të faktit që ato mund të vendosen në rrezik të posaçëm,

“Duke ripohuar se përfundimi i pandëshkueshmërisë është esencial nëse një shoqëri në konflikt apo që rimëkëmbet nga konflikti do t’i zgjidhni abuzimet e kaluara të kryera ndaj civilëve të prekur nga konflikti i armatosur dhe për të parandaluar abuzimet e tilla të ardhshme, duke tërhequr vëmendje në spektrin e plotë të mekanizmave të drejtësisë dhe pajtimit që do të merren parasysh, duke përfshirë gjykatat dhe tribunat vendore, ndërkombëtare dhe të “përziera” penale dhe komisionet për të vërtetën dhe pajtimin, si dhe duke theksuar se mekanizmat e tillë mund të promovojnë jo vetëm përgjegjësinë individuale për krimet e rënda por edhe paqen, të vërtetën, pajtimin dhe të drejtat e viktimave

“Duke rikujtuar përfshirjen e një spektri të veprave të dhunës seksuale në Statutin e Romës të Gjykatës Ndërkombëtare Penale dhe statuteve të tribunaleve ndërkombëtare penale ad hoc,

“Duke riafirmuar rëndësinë për shtetet, me mbështetje të bashkësisë ndërkombëtare, përritjen e qasjes në kujdesin shëndetësor, mbështetjen psikologjike, ndihmën ligjore, si dhe shërbimet e riintegritit ekonomik për viktimat e dhunës seksuale, në veçanti në zonat rurale, dhe duke pasur parasysh nevojat specifike të personave me aftësi të kufizuara,

“Duke përshëndetur propozimet, konkluzionet dhe rekomandimet e përfshira në raportin e Komitetit të Posaçëm për Operacione Paqeruajtëse (A/64/19) për nevojën për aftësi adekuate dhe udhëzimeve të qarta dhe të përshtatshme për të mundësuar që misionet paqeruajtëse të kryejnë të gjitha detyrat e tyre të mandatuara, duke përfshirë parandalimin dhe reagimin ndaj dhunës seksuale; duke theksuar rëndësinë e sigurimit të angazhimit të lidershit të lartë të misionit për mbrojtjen e civilëve, duke përfshirë parandalimin dhe reagimin ndaj rasteve të dhunës seksuale në konflikte të armatosura, me qëllim për të siguruar që të gjithë komponentët e misionit dhe të gjithë nivelet e zinxhirit të komandës janë të informuar siç duhet dhe të përfshirë në mandatin e misionit dhe përgjegjësitë e tyre përkatëse; duke përshëndetur progresin e arritur nga Sekretari i Përgjithshëm në zhvillimin e mjeteve operative për zbatimin e mbrojtjes së mandateve të civilëve; dhe duke inkurajuar shtetet kontribuuese të trupave dhe policisë që shfrytëzojnë maksimalisht dhe të ofrojnë komente mbi këto materiale të rëndësishme,

“Duke i pranuar përpjekjet e Sekretarit të Përgjithshëm për trajtimin e nënpërfaqësimit të grave në proceset formale paqësore, mungesën e ndërmjetësve dhe monitoruesve të armëpushimit me trajnime adekuate në trajtimin e dhunës seksuale, si dhe mungesën e grave si udhëheqëse apo shefe të ndërmjetësve për paqe në bisedimet paqësore të sponsorizuara nga OKB-ja; dhe inkurajimin e përpjekjeve të tilla të mëtejme,

“Duke mirëpritur përfshirjen e grave në misionet paqeruajtëse në funksione civile, ushtarake dhe policore, duke pranuar se prania e tyre mund të nxisë gratë nga komunitetet lokale që t’i raportojnë aktet e dhunës seksuale,

“Pas shqyrtimi të raportit të Sekretarit të Përgjithshëm të datës 24 nëntor 2010 (S/2009/362) dhe duke theksuar se rezoluta aktuale nuk mëton të arrijë përcaktim ligjor nëse situatat e referuara në raportin e Sekretarit të Përgjithshëm janë apo nuk janë konflikte të armatosura në kontekst të Konventave të Gjenevës dhe Protokollet shtesë të tyre, dhe nuk paragjykon statusin ligjor të palëve joshtetërore të përfshira në këto situata,

1. Ripohon se dhuna seksuale, kur përdoret apo mandatohet si një taktikë e luftës ose si pjesë e një sulmi të përhapur ose sistematik kundër popullatës civile, mund të përkeqësojnë dukshëm situatat e konfliktit të armatosur dhe mund të pengojnë kthimin e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, pohon lidhur me këtë se hapat efektiv për të parandaluar dhe për t'iu përgjigjur akteve të tilla të dhunës seksuale mund të kontribuojë ndjeshëm në ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, dhe shpreh gatishmërinë e tij, kur të merr parasysh situata në agjendën e Këshillit, për të ndërmarr, kur të jenë të nevojshme, hapat e duhur për të adresuar dhunën e përhapur ose dhunën sistematike seksuale në situata të konfliktit të armatosur;

2. Rithekson kërkesën e vet që të gjitha palët në konfliktin e armatosur të ndalojnë në tërësi dhe menjëherë të gjitha aktet e dhunës seksuale;

3. Inkurajon Sekretarin e Përgjithshëm që të përfshijë në raportet e tij vjetore të dorëzuara në përputhje me rezolutat 1820 (2008) dhe 1888 (2009) informacione të hollësishme për palët në konflikt të armatosur që besohet se janë të dyshuar për kryerjen e përdhunimit

apo formave të tjera të dhunës seksuale, dhe të listohen në shtojcë e këtyre raporteve vjetore palët që janë të dyshuar për kryerjen ose janë përgjegjës për përdhunimit sistematik dhe formave të tjera të dhunës seksuale në situata të konfliktit të armatosur në agjendën e Këshillit të Sigurimit; shpreh synimin e tij për të përdorur këtë listë si bazë për më shumë angazhim të fokusuar të Kombeve të Bashkuara me ato palë, duke përfshirë, sipas nevojës, masa në përputhje me procedurat e komisioneve përkatëse të sanksioneve;

4. I kërkon Sekretarit të Përgjithshëm, në përputhje me rezolutën e tanishme dhe duke marrë parasysh specifikat e tij, për të aplikuar kriterin e futjes në listë dhe heqjes nga lista të partive që janë listuara në raportin e tij vjetor mbi dhunën seksuale në konfliktet e armatosura në përputhje me paragrafët 175, 176, 178, dhe 180 të raportit të tij A/64/742-S/2010/181;

5. U bën thirrje palëve në konfliktin e armatosur për të bërë dhe zbatuar angazhimet specifike dhe me afate kohore për të luftuar dhunën seksuale, të cilat duhet të përfshijnë, ndër të tjera, lëshimin e urdhrave të qarta nëpërmjet zinxhirëve të

komandës që ndalojnë dhunën seksuale dhe ndalimin e dhunës seksuale në Kodet e Sjelljes, manualët ushtarake në terren, ose ekuivalente; dhe thirrjet e tjera për ato palë për të bërë dhe për të zbatuar angazhimet specifike për hetimin e abuzimeve të dyshuara në kohë në mënyrë që të mbajë autorët përgjegjës për veprat;

6. I kërkon Sekretarit të Përgjithshëm të gjurmoj dhe monitoroj zbatimin e këtyre angazhimeve nga palët në konfliktin e armatosur në agjendën e Këshillit të Sigurimit që të angazhohen në strukturat e përdhunimit dhe dhunës tjetër seksuale, dhe rregullisht të përditësoj Këshillin me raportet përkatëse dhe informacionet;

7. Rithekson qëllimin e vet, kur të miratoj ose rinovoj sanksionet e planifikuara në situatat e konfliktit të armatosur, të marrin në konsideratë duke përfshirë, aty ku është e përshtatshme, përcaktimin e kritereve që kanë të bëjnë me aktet e përdhunimit dhe formave të tjera të dhunës seksuale; dhe ju bën thirrje të gjitha operacioneve paqeruajtëse dhe misionëve tjera relevante të Kombeve të Bashkuara dhe organeve të Kombeve të Bashkuara, në veçanti Grupit Punues për fëmijët

dhe konfliktin e armatosur, për të ndarë, të gjitha informatat përkatëse në lidhje me dhunën seksuale, me komisionet relevante të sanksioneve të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, edhe nëpërmjet të grupeve monitoruese të Komisionit për Sanksione të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe grupeve të ekspertëve;

8. I kërkon Sekretarit të Përgjithshëm që të themeloj aranzhime të monitorimit, analizimit dhe raportimit mbi dhunën seksuale që ndërlidhet me konfliktin, duke përfshirë dhunimin në situata të konfliktit të armatosur dhe pas konfliktit dhe situatave të tjera relevante për zbatimin e rezolutës 1888 (2009), sipas nevojës, dhe duke marrë parasysh specifikat e secilit vend, që sigurojnë një qasje koherente dhe të koordinuar në nivel të terrenit, dhe inkurajon Sekretarin e Përgjithshëm që të angazhohen me të akterët e Kombeve të Bashkuara, institucionet kombëtare, organizatat e shoqërisë civile, ofruesit e shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe grupeve të grave për të përmirësuar mbledhjen e të dhënave dhe analizën e incidenteve, trendëve, dhe modeleve të dhunimit dhe formave të tjera të dhunës seksuale

për të ndihmuar në konsiderimet e Këshillit për veprime të duhura, duke përfshirë masat e synuara dhe të aspiruara, duke respektuar plotësisht integritetin dhe specifikat e monitorimit dhe mekanizmat e raportimit që zbatohen sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit 1612 (2005) dhe 1882 (2009) për fëmijët dhe konfliktin e armatosur;

9. Kërkon nga Sekretari i Përgjithshëm që të sigurojë transparencë të plotë, bashkëpunim dhe koordinim të përpjekjeve në mes të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për Fëmijët dhe konfliktin e armatosur dhe Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm mbi dhunën seksuale në konflikt;

10. Mirëpret punën e këshilltarëve gjinor; mezi pret emërimin e këshilltarëve të tjerë për mbrojtjen e grave në misionet paqeruajtëse, në përputhje me rezolutën 1888 (2009); thekson kontributin e tyre potencial në kuadër të analizimit, monitorimit, dhe aranzhimeve të raportimit që do të krijohej në pajtim me paragrafin operativ 8 të rezolutës aktuale;

11. Mirëpret elaborimin nga Sekretari i Përgjithshëm për materialet trajnuese të bazuara në skenar për të luftuar dhunën seksuale për paqeruajtësit dhe inkurajon Shtetet Anëtare për t'i përdorur ato si një referencë për përgatitjen dhe vendosjen e operacioneve paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara;

12. Nënvizon se, në mënyrë që të kryejnë mandatin e tyre, misionet duhet të komunikojnë në mënyrë efektive me komunitetet lokale dhe inkurajon Sekretarin e Përgjithshëm për të përmirësuar kapacitetin e tyre për ta bërë këtë;

13. Shpreh synimin e vet për t'i dhënë vëmendjen e duhur dhunës seksuale në autorizimet e mandatit dhe rinovimet dhe të kërkojë nga Sekretari i Përgjithshëm që të përfshijë, sipas nevojës, ekspertizën gjinore në misionet e vlerësimit teknik;

14. Inkurajon njësitë që përbëjnë Veprimin e Kombeve të Bashkuara kundër dhunës seksuale në konflikt, si dhe pjesë të tjera të rëndësishme të sistemit të Kombeve të Bashkuara, për të vazhduar mbështetjen e punës së Përfaqësuesit Special të lartpërmendur të Sekretarit të Përgjithshëm mbi dhunën seksuale në konflikt dhe për të përmirësuar bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit në mes të gjithë akterëve relevant, për të përforcuar koordinimin dhe për t'ju shmangur dyfishimit në nivel të selisë dhe nivel vendi si dhe përmirësimin e sistemit të gjerë të reagimit;

15. Inkurajon shtetet anëtare për të dërguar një numër më të madh të femrave si personel ushtarak dhe policor në operacionet paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara, si dhe ti sigurojë të gjithë personelit ushtarak dhe policor trajnim adekuat, në mes të tjerave, për të kryer përgjegjësitë e tyre;

16. I kërkon Sekretarit të Përgjithshëm për të vazhduar dhe për të forcuar përpjekjet për të zbatuar politikën e zero tolerancës ndaj shfrytëzimit seksual dhe abuzimit në operacionet paqeruajtëse dhe personelit humanitar të Kombeve të Bashkuara, dhe më tej kërkon nga Sekretari i Përgjithshëm që të vazhdoj të ofroj udhëzime për të adresuar dhunën seksuale në trajnimet para dërgimit në mision dhe trajnimet e para për personelin ushtarak dhe policor dhe të asistoj misionet që të krijojnë procedura specifike për situatat e tilla për të adresuar dhunën seksuale në terren dhe të siguroj se përkrahja teknike është ofruar për vendet kontribuues me trupa dhe polici për të përfshirë udhëzimet për personelin ushtarak dhe policor për të adresuar dhunën seksuale në trajnimet para dërgimit dhe në trajnimet e para në mision;

17. Fton Përfaqësuesin Special për dhunën seksuale në konflikt të vazhdojë të ofrojë informacione për dhunën seksuale, në përputhje me rezolutën 1888 (2009);

18. Kërkon që Sekretari i Përgjithshëm të vazhdoj të paraqes raportet vjetore para Këshillit për zbatimin e rezolutave 1820 (2008) dhe 1888 (2009) dhe të paraqesë raportin e tij të ardhshëm deri në dhjetor të vitit 2011 për zbatimin e rezolutave 1820 (2008) dhe 1888 (2009) dhe rezoluta aktuale të përfshij, ndër të tjera:

(a) një plan i hollësishëm koordinues dhe strategjik për mbledhjen në kohë dhe në mënyrë etike të informacionit;

(b) informacioni për progresin e bërë në zbatimin e aranzhimeve të monitorimit, analizave dhe raportimit të përmendura në paragrafin 8;

(c) informacione të hollësishme për palët në konfliktin e armatosur që besohet të jenë të dyshuar për kryerjen e ose janë përgjegjës për aktet e dhunimit apo formave të tjera të dhunës seksuale, si dhe një aneks me një listën e palëve që janë të dyshuara për kryerjen e ose janë përgjegjës për dhunimin sistematik dhe format të tjera të dhunës seksuale në situata të konfliktit të armatosur, në agjendën e Këshillit të Sigurimit;

(d) Përditësimet për përpjekjet nga personat përgjegjës, të Misionit të Kombeve të Bashkuara, për dhunën seksuale, që të punojnë ngushtë me Koordinatorin Kryesor/Koordinatorin Humanitar (RC/ HC), ekipin vendor të Kombeve të Bashkuara, dhe, kur është e përshtatshme, përfaqësuesin

(e) lartpërmendur special dhe/ose ekipin e ekspertëve, për të adresuar dhunën seksuale;

19. Vendos që të vazhdojë të merret aktivisht me këtë çështje."

Shtojca 6: Indikatorët Globalë të KS të OKB-së

INDIKATORËT GLOBAL

Lista e 26 indikatorëve të paraqitur para Këshillit të Sigurimit si pjesë e raporteve të Sekretarit të Përgjithshëm S/2010/498.

Numri	Indikator
1a	Përhapja e dhunës seksuale
1b	Trende të dhunës seksuale në situata të konfliktit dhe pas konfliktit Teksti i pjesës së rekomandimeve për të raportuar për: <ul style="list-style-type: none"> • Llojet e masave (të propozuara kundrejt të zbatuara) • Llojet e shkeljeve • Lloji i kryerësit • Grupet specifike të prekura (etnia, lokacioni gjeografik, mosha)
2	Shkalla në të cilën Misionet Paqeruajtëse dhe Misionet Speciale Politike të OKB-se përfshijnë informata për shkeljet e të drejtave të njeriut të grave dhe vajzave në raportimin e tyre periodik para Këshillit të Sigurimit
3a	Shkalla e raportimit, referimit dhe hetimit të shkeljeve të të drejtave të njeriut të grave dhe vajzave nga organet për të drejtat e njeriut Raportim për: <ul style="list-style-type: none"> • Numrin dhe llojet e rasteve të raportuara, referuara dhe hetuara • Logaria e veprimeve të ndërmarra/rekomanduara për trajtimin e shkeljeve
3b	Numri dhe përqindja e grave në organet qeverisëse të Trupave Vendore për të Drejtat e Njeriut
4	Përqindja e rasteve të raportuara të shfrytëzimit dhe abuzimit seksual që pohohet të jenë kryer nga paqeruajtës në uniformë dhe civilë dhe/apo punonjës humanitarë për të cilat është ndërmarrë veprim nga gjithsej numri i rasteve të raportuara
5a	Shkalla në të cilën masat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të grave dhe vajzave përfshihen në Direktivat e Udhëheqësve Paqeruajtës të Komponentëve Ushtarakë dhe Udhëheqësve të Komponentëve Policorë
5b	Shkalla në të cilën masat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të grave dhe vajzave përfshihen në kornizat e politikave vendore të sigurisë. Gjuha ekzistuese dhe e re specifike gjinore për raportim për: <ul style="list-style-type: none"> • Llojin e dokumentit • Analiza e kontekstit të kërcënimeve të sigurisë për vajzat dhe gratë • Llojet e masave
6	Numri dhe lloji i veprimeve të ndërmarra nga Këshilli i Sigurimit që kanë të bëjnë me rezolutën 1325 (2000) Raport për: <ul style="list-style-type: none"> • Numrin e veprimeve • Llojet e veprimeve: kërkim i hetimit, ngritja e një mekanizmi specifik, mandatimi i paqes, mbajtja e operationeve, nxjerrja e ndëshkimeve, autorizimi i përdorimit të forcës, themelimi i një tribunali ndërkombëtar, referimi një situatë në ICC • Lloji i dokumentit (d.m.th. rezoluta, PRST)
7	Numri dhe përqindja e grave në pozita ekzekutive të organizatave relevante rajonale dhe nënrajonale të përfshira në parandalimin e konfliktit Organizatave rajonale dhe nënrajonale përfshijnë ato të identifikuar në A/RES/55/285.
8	Përqindja e marrëveshjeve paqësore me dispozita specifike për përmirësimin e sigurisë dhe statusit të grave dhe vajzave
9	Proporcioni i grave në pozitat e larta të OKB-së në misione të jashtme
10	Përqindja e misioneve të jashtme me ekspertë të lartë gjinorë
11a	Përfaqësimi i grave në mesin e ndërmjetësve, negociatorëve dhe ekspertëve teknikë në negociatat formale për paqe

11b	Pjesëmarrja e grave me status të vëzhguesit zyrtar në fillim dhe fund të negociatave formale për paqe
12a	Pjesëmarrja politike e gruas dhe në pozita ministrore. Raport për pjesëmarrjen e grave si: <ul style="list-style-type: none"> • Deputete në kuvende • Pozita ministrore
12b	Pjesëmarrja politike e gruas si votuese dhe kandidate. Raport për pjesëmarrjen e grave si: <ul style="list-style-type: none"> • Persona të regjistruar për të votuar • persona që votojnë • Kandidate parlamentare
13	Shkalla në të cilën misionet e Këshillit të Sigurimit trajtojnë çështje specifike që prekin gratë dhe vajzat në Termat e Referencës së tyre dhe Raporte të Misioneve
14	Indeksi i sigurisë fizike të grave dhe vajzave. Indikator i anketës për të matur tri dimensione: <ul style="list-style-type: none"> • perceptimet e sigurisë fizike të grave dhe vajzave (sipas lokacionit, kohës së ditës) • Variablat proksi që matin se si është prekur aftësia e grave dhe vajzave në jetën publike • Variablat proksi që matin se si janë prekur aktivitetet e rregullta të grave dhe vajzave
15	Shkalla në të cilën ligjet vendore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të grave dhe vajzave janë në pajtim me standardet ndërkombëtare
16	Niveli i pjesëmarrjes së grave në sektorin e drejtësisë dhe sigurisë
17	Ekzistimi i mekanizmave kombëtarë për kontrollin e armëve të paligjshme të vogla dhe të lehta. Ky indikator raporton për: <ul style="list-style-type: none"> • Ekzistimin e agjencisë kombëtare të koordinimit për SA/LW apo Pikës kombëtare kontaktuese (paragrafët 4 dhe 5 të Pjesës II të POA) • Mbajtja e shënimeve për mbajtjen dhe bartjen e SA/LW (paragrafi 9 në pjesën II të POA)
18	Përqindja e përfitimeve (monetare, të përafërt) nga punësimi në kontekst të programeve të hershme të rimëkëmbjes ekonomike të pranuar nga vajzat dhe gratë
19	Përqindja e rasteve të referuara të dhunës seksuale dhe në baza gjinore kundër grave dhe vajzave të cilat raportohen, hetohen dhe dënohen
20	Orët e trajnimeve për kokë banori të stafit vendimmarrës në institucionet e sektorit të sigurisë dhe drejtësisë për trajtimin e rasteve të DHSBGJ
21a	Shkalla e vdekshmërisë së nënave
21b	Shkalla neto e regjistrimit në shkollim fillor dhe të mesëm, sipas gjinisë
22a	Proporcioni i buxhetit që ka të bëjë me indikatorët që trajtojnë çështjet e barazisë gjinore në kornizat e planifikimit strategjik
22b	Proporcioni i buxhetit që ka të bëjë me synimet që trajtojnë çështjet e barazisë gjinore në kornizën e planifikimit strategjik
23a	Proporcioni i gjithsej financimit të ndarë për organizatat e shoqërisë civile që ndahet për trajtimin e çështjeve të barazisë gjinore
23b	Proporcioni i gjithsej financimit të ndarë për mbështetjen e çështjeve të barazisë gjinore që ndahet për organizatat e shoqërisë civile
24a	Proporcioni i shfrytëzimit të Fondit të Mirëbesimit të Donatorëve të Shumtë (MDTF) për trajtimin e çështjeve të barazisë gjinore
24b	Proporcioni i gjithsej shpenzimit të sistemit të OKB-së për mbështetjen e çështjeve të barazisë gjinore
25	Shkalla në të cilën Komisioni i së Vërtetës dhe Pajtimit përfshin dispozita për trajtimin e të drejtave dhe pjesëmarrjes së grave dhe vajzave
26a	Përqindja e përfitimeve (monetare, të përafërta) nga programet e DDR të pranuar nga gratë dhe vajzat
26b	Përqindja e përfitimeve (monetare, të përafërta) nga programet e DDR të pranuar nga gratë dhe vajzat

Shtojca 7: Udhëzues për pyetjet për nismën e identifikimit e nismave për gratë, paqen dhe sigurinë

Parandalimi

A. Parandalimi i të gjitha formave të dhunës ndaj gruas, posaçërisht dhunës seksuale dhe në baza gjinore.

Pyetjet:

- A keni ndërmarrë projekte që kontribuojnë në parandalimin e të gjitha formave të dhunës ndaj gruas? (Dhuna në familje, abuzimi seksual, etj.)
- A keni ndërmarrë projekte që synojnë parandalimin e praninë e dhunës seksuale?

B. Sistemet operationale të përgjegjshme gjinore në fuqi për monitorimin, raportimin dhe reagimin ndaj shkeljeve të të drejtave të grave dhe vajzave gjatë konfliktit, shuarjen e zjarreve, negociatat paqësore dhe pas konfliktit.

Pyetje:

- Kur keni filluar me përdorimin e të dhënave të ndara gjinore në raportet tuaja të monitorimit, raportim dhe përgatitje të projekteve/programeve?
- A ka pasur nisma specifike që kanë të bëjnë me raportimin/regjistrimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut të grave dhe vajzave?
- A janë përfshirë këto informata në raportimin periodik para Këshillit të Sigurimit të OKB-së?
- A ka pasur nisma me fokus në krahasimin e shkeljeve të të drejtave të grave dhe vajzave përgjatë viteve?
- Si ka reaguar institucioni juaj pas konfliktit në trajtimin e shkeljeve të të drejtave të grave dhe vajzave gjatë konfliktit?

C. akterët ndërkombëtarë dhe joshtetërorë të sigurisë që janë përgjegjës dhe japin llogari për shkelje të të drejtave të grave dhe vajzave, në pajtim me standardet ndërkombëtare.

Pyetjet:

- A keni ndërmarrë nisma për themelimin, mbajtjen dhe fuqizimin e strukturave në të cilat raportohen rastet e dhunës seksuale të kryer nga paqeruajtësit në uniformë, civilë dhe/apo punonjësit humanitarë?
- A keni ndërmarrë nisma për të reaguar ndaj këtyre rasteve?

- A ka ndërmarrë organizata juaj nisma për organizimin e trajnimeve, fushatave me qëllim të informimit të grave dhe vajzave për rregullat dhe ligjet që aplikohen për paqeruajtësit në uniformë dhe civilë dhe punonjësit humanitarë?
- A keni rregulla apo rregullore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të grave dhe vajzave të përfshira në direktivat e udhëheqësve të komponenteve ushtarake/policore?
- A keni ndërmarrë nisma për përfshirjen e masave specifike për mbrojtjen të drejtave të njeriut të grave dhe vajzave në direktivat e nxjerra nga komponentet ushtarake dhe udhëheqësit e komponenteve të misioneve paqeruajtëse?
- Shkalla në të cilën masat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të grave dhe vajzave janë të përfshira në sigurinë kombëtare, kornizat e politikave, etj. A keni rregulla apo rregullore për mbrojtjen të drejtave të njeriut të grave dhe vajzave të përfshira në kornizat e politikave kombëtare të sigurisë?

D. Dispozitat për trajtimin e nevojave dhe çështjeve specifike për gratë dhe vajzat janë të përfshira në sistemet e paralajmërimit të hershëm dhe mekanizmat e parandalimit të konfliktit dhe zbatimit i tyre monitorohet.

Pyetjet:

- A ka pasur veprime specifike nga Këshilli i Sigurimit në lidhje me rezolutën 1325? (nuk aplikohet për Kosovën por duhet të ceket në raport)
- A ka ndërmarrë institucioni juaj nisma për rritjen e numrit të grave në pozita ekzekutive të organizatave relevante rajonale dhe nënrajonale?
- A keni ndërmarrë nisma për të nxitur gratë që të marrin pjesë në pozita ekzekutive të organizatave rajonale dhe nënrajonale të përfshira në parandalimin e konfliktit?

Pjesëmarrje

A. Përfshirja e grave dhe interesave të grave në proceset vendimmarrëse në lidhje me menaxhimin e parandalimit dhe zgjidhjen e konflikteve.

Pyetjet:

- A ka përfshirë Rezoluta 1244 theks të veçantë apo dispozita për përmirësimin e sigurisë dhe statusit të grave dhe vajzave?
- A ka ndërmarrë organizata juaj nisma për rritjen e përfaqësimit dhe pjesëmarrjen kuptimplotë të grave në misione të OKB-së dhe misione tjera ndërkombëtare që kanë të bëjnë me paqen dhe sigurinë?
- A janë ndërmarrë nisma për rritjen e numrit të grave në misionet e jashtme të OKB-së?
- A ka ndërmarrë organizata juaj nisma që krahasojnë pjesëmarrjen e grave në pozita të larta në misionet e jashtme të OKB-së?
- A janë ndërmarrë nisma për emërimin e një eksperti të lartë gjinor në misione të jashtme?
- A janë ndërmarrë nisma për kualifikimin apo trajnimin e ekspertëve gjinorë për pozita të larta në misionet e jashtme?

B. Rritja e përfaqësimit dhe pjesëmarrjes kuptimplote të grave në negociatat formale dhe joformale për paqe dhe proceset e ndërtimit të paqes.

Pyetjet:

- A janë ndërmarrë nisma për të pasur gra në pozita ndërmjetëse, negociuese dhe eksperte teknike në negociatat formale për paqe?
- A janë ndërmarrë nisma për të nxitur pjesëmarrjen e grave në status të vëzhguesit zyrtar në fillim dhe fund të negociatave formale për paqe?

C. Rritja e përfaqësimit dhe pjesëmarrjes kuptimplote të grave në qeverinë qendrore dhe lokale si zyrtarë dhe vendimmarrës të zgjedhur.

Pyetjet:

- A ka ndërmarrë organizata nisma për rritjen e pjesëmarrjes politike të gruas në kuvend dhe pozita ministrore?
- A janë ndërmarrë nisma për identifikimin, planifikimin dhe trajnimin e grave me shkathtësi të udhëheqëse dhe prapavijë të posaçme?
- A ka ndërmarrë organizata juaj nisma për informimin e grave për të drejtat e tyre si votues individualë?
- A janë ndërmarrë nisma për nxitjen e pjesëmarrjes politike të grave si kandidate?

D. Rritje e pjesëmarrjes së gruas dhe organizatave të gruas në aktivitetet për parandalimin, menaxhimin, zgjidhjen dhe reagimin ndaj konfliktit dhe shkeljeve të të drejtave të gruas dhe vajzave.

Pyetjet:

- A keni vërejtjet specifike në termat e referencës të misionit të këshillit të sigurimit që trajtojnë çështjet që prekin gratë dhe vajzat?

Mbrojtja

A. Garantohet siguria, shëndeti fizik dhe mendor i grave dhe vajzave dhe siguria e tyre ekonomike dhe respektohen të drejtat e tyre të njeriut.

Pyetjet:

- A ka pasur nisma për të garantuar sigurinë fizike të grave dhe vajzave?
- A ka pasur struktura specifike të mbrojtjes që janë krijuar si rrjedhojë e nismave të ndërmarra nga organizata juaj?

B. Të drejtat politike, ekonomike, sociale dhe kulturore të grave dhe vajzave mbrohen dhe zbatohen me ligjet vendore në pajtim me standardet ndërkombëtare.

- A keni ndërmarrë nisma për miratimin e ligjeve të reja për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të grave dhe vajzave në pajtim me standardet ndërkombëtare?
- Nëse ka pasur të tilla, cilët ishin këto ligje specifike?
- Kur janë miratuar këto ligje nga parlamenti?
- A është monitoruar zbatimi i këtyre ligjeve?

C. Mekanizmat dhe strukturat operacionale në fuqi për fuqizimin e sigurisë fizike për gratë dhe vajzat.

Pyetjet:

- A keni ndërmarrë nisma për përmirësimin e pjesëmarrjes së grave në institucionin tuaj (sektorin e drejtësisë, sigurisë, shërbimit të jashtëm.)?
- A ka pasur rritje në nivelin e pjesëmarrjes së grave në organizatën tuaj që është rrjedhojë e një nisme specifike që e keni ndërmarrë?
- A ka pasur nismë specifike për nxitjen e mekanizmave kombëtar për kontrollimin e armëve joligjore të vogla dhe armëve të lehta?

D. Gratë dhe vajzat në rrezik kanë qasje në shërbime për mbështetjet të jetesës.

Pyetjet:

- A keni ndërmarrë nisma të punësimit të përkohshëm në kontekst të programeve të rimëkëmbjes së hershme ekonomike për gratë dhe vajzat?
- A janë ndërmarrë nisma për ngritjen e përqindjes së përfitimeve të pranuar nga gratë dhe vajzat në kontekst të programeve të rimëkëmbjes së hershme ekonomike?
- A janë ndërmarrë nisma për të përfshirë gratë dhe vajzat si grup i veçantë i synimit në programet tuaja për mbështetje të jetesës?

E. Rritje e qasjes për drejtësinë për gratë të drejtat e cilave janë shkelur.

Pyetjet:

- A janë ndërmarrë nisma nga institucioni juaj për miratimin e Procedurave Standarde të Operimit (PSO)?
- A janë ndërmarrë nisma për krijimin e një baze specifike të të dhënave që do të mbledhë informata për rastet e referuara të dhunës seksuale dhe në baza gjinore ndaj grave dhe vajzave, për t'i informuar lidhur me nivelin e përparimit në referimin e dhunës seksuale dhe në baza gjinore?
- A ka marrë pjesë stafi i institucionit tuaj në trajnime specifike për dhunën në baza gjinore?
- A keni ndërmarrë nisma për informimin e stafit lidhur me trajtimin e rasteve të dhunës seksuale dhe në baza gjinore?

Ndihma dhe rimëkëmbja

A. Nevojat e shëndetit riprodhues të grave dhe vajzave plotësohen në situatat e konfliktit dhe pas konfliktit.

Pyetjet:

- A janë kryer trajnime për stafin mjekësor me fokus në shërbime cilësore të ofruara për nënat e reja?
- A ka ndërmarrë organizata juaj për t'i informuar nënat e reja lidhur me sistemin e kujdesit shëndetësor dhe si mund të kenë qasje në qendrat shëndetësore?
- A keni ndërmarrë nisma për rritjen e regjistrimit të vajzave në shkolla?
- A keni ndërmarrë nisma që do të tregojnë progresin me regjistrimin e vajzave në shkolla?

B. Nevojat e grave dhe vajzave, posaçërisht të grupeve të cënueshme (personat e zhvendosur brenda vendit, viktimat e dhunës seksuale dhe në baza gjinore, ish luftëtarët, refugjatët, të kthyerit) janë trajtuar në programet e ndihmës, rimëkëmbjes së hershme dhe të rimëkëmbjes ekonomike

Pyetjet:

- A janë ndërmarrë nisma për të buxhetuar zbatimin e strategjive që trajtojnë çështjet e barazisë gjinore?
- A janë ndërmarrë nisma për të krahasuar proporcionin e buxhetit që ka të bëjë me treguesit që trajtojnë çështjet e barazisë gjinore në kornizën e kornizave të planifikimit?
- A janë ndërmarrë nisma për sa i përket çështjes së planifikimit të buxhetit në lidhje me synimet që trajtojnë çështjet e barazisë gjinore në kornizën e planifikimit strategjik?
- Cilat janë projektet e zbatuar nga OJQ-të që kanë pranuar mbështetjen tuaj në lidhje me barazinë gjinore?
- A janë ndërmarrë nisma për ngritjen e financimit të përgjithshëm të ndarë për organizatat e shoqërisë civile për trajtimin e çështjeve të barazisë gjinore?

- Cilat projekte janë zbatuar dhe financuar nga Fondi i Mirëbesimit i Donatorëve që kanë trajtuar çështjet e barazisë gjinore?
- Cilat kanë qenë nismat e ndërmarra për barazinë gjinore?
- A janë ndërmarrë nisma për analizimin dhe vlerësimin e përfundimit të gjithsej shpenzimeve të sistemit të OKB-së që është përdorur për mbështetjen e çështjeve të barazisë gjinore?

C. Institucionet e pas konfliktit dhe proceset e drejtësisë tranzicionale, pajtimit dhe rindërtimit janë të përgjegjshme gjinore.

Pyetjet:

- A janë ndërmarrë nisma për të vërtetën, pajtimin dhe rindërtimin në lidhje me gratë?
- A i keni monitoruar ndryshimet apo progresin që ka të bëjë me komisionin e së vërtetës dhe pajtimit duke përfshirë dispozitat për trajtimin e të drejtave dhe pjesëmarrjes së grave dhe vajzave?

D. Programet për çarmatosje, demobilizim dhe riintegrim dhe reformat në sektorin e sigurisë trajtojnë nevojat specifike të sigurisë dhe të tjera të aktereve të sigurisë, ish luftëtareve, dhe grave dhe vajzave të shoqëruara me grupet e armatosura.

Pyetjet:

- A janë ndërmarrë nisma në lidhje me programe të reparacionit për gratë dhe vajzat?
- A janë ndërmarrë nisma për përfitimet nga programet e DDR të pranuar nga gratë dhe vajzat?

Shtojca 8: Lista e Institucioneve

Emri dhe mbiemri	Institucioni	Numri kontaktues	Data/koha e takimit
Edona Hajrullahu	Agjencia për Barazi Gjinore	Edona.hajrullahu@rks-gov.net	12.03.2013/11:00
Emma Kay	Ambasada e Holandës	emma.kay@minbuza.nl	E-mail
Patrick Schmelzer VisarBivolaku	Zyra e BE-së në Kosovë	patrick.schmelzer@eeas.europa.eu visar.bivolaku@ext.eeas.europa.eu	E-mail
Brigitte Holzner	EULEX	Brigitte.Holzner@eulex-kosovo.eu	09.11.2012/14:30
Kotilainen Vesa	Ambasada e Finlandës	Vesa.Kotilainen@formin.fi	E-mail
Gabriele Becker Rrezarta Jashari	GIZ	038 233002316 gabriele.becker@giz.de rrezarta.jashari@giz.de	09.11.2012/10
Roberto Cancel	IOM	45284563 rcancel@iom.int	E-mail
Elisabeth Schleicher	KFOR	SCHLEICHERE@hq.kfor.nato.int	E-mail
Behar Selimi Hysni Shala	Policia e Kosovës	045 99 88 77; 044 519 919 bselimi@hotmail.com Hysni.Shala@kosovopolice.com	E-mail
HadijeBinjaku	Forca e Sigurisë së Kosovës	044357 096 diya_binaku@hotmail.com	E-mail
Arbena Kuriu	OHCHR	038 249 176 akuriu@ohchr.org	07.11.2012/10
Rudina Ademi	Save the Children	Rudina.Ademi-Shala@eur.savethechildren.se	E-mail
Brikena Sylejmani	UNDP	044 199 750, brikena.sylejmani@undp.org	07.11.2012/14.00
Berenika Gashi	UNDP-WSSI	berenika.gashi@undp.org	20.11.2012/10.00

Visare Nimani	UNFPA	nimani@unfpa.org	08.11.2012/10:30
Vjollca Gjonbalaj	UNHCR	gjonbala@unhcr.org	e-mail
Pia Hangaslahti	UNICEF	049 351822, phangaslahti@unicef.org	14.11.2012/09.00
Flora Macula Nita Gojani	UN Women	049 194 189 flora.macula@unwomen.org nita.gojani@unwomen.org	23.11.2012/08:45
Skender Syla	OBSH	044 504 311/ssy@whopr.org	09.11.2012/13.00

UNDP Kosovo Office, Payton Place No. 14, 10000
Pristina, Kosovo
Phone: +381 (0) 38 249066
Fax: +381 (0) 38 249065
E-mail: registry.ks@undp.org

